VENDIM
Nr. 685, datë 22.11.2017

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES ME NDARJE PRODHIMI, PËR KËRKIMIN, ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE NË TOKË, NË SHQIPËRI, BLLOKU I VELÇËS, NDËRMJET "ALBPETROL" SHA DHE "*PENNINE PETROLEUM CORPORATION*"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13, të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993, "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes me ndarje prodhimi, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në tokë, në Shqipëri, blloku i Velçës, ndërmjet Albpetrol sh.a. dhe "*Pennine Petroleum Corporation*", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDARJE PRODHIMI PËR KËRKIMIN, ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE NË TOKË NË SHQIPËRI
BLLOKU I VELÇËS, NDËRMJET ALBPETROL SHA DHE
PENNINE PETROLEUM CORPORATION"

- Kjo Kontratë nënshkruhet sot më _____, 2017, nga dhe midis:

(1) **Albpetrol SH.A.**, shoqëri tregtare e regjistruar dhe që funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë (më poshtë "**Albpetrol**") me seli në Rruga Fier-Patos, km i 7-të, me NUIS J82916500U përfaqësuar nga Z. Endri Puka, në cilësinë e Administratorit të shoqërisë;

dhe

(2) **Pennine Petroleum Corporation**, shoqëri tregtare e regjistruar dhe që funksionon në bazë të ligjeve të Rajonit të Albertas, Kanada me seli në Calgary Alberta, 315-39 Ave.S.W, kati 2-të, (më poshtë "**Kontraktori**") e përfaqësuar nga Z. Desmond Smith, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Kontraktorit.

Secila prej tyre mund të referohet individualisht si "**Pala**" dhe bashkarisht si "**Palët**"

MEQENËSE:

(A) Të gjitha burimet natyrore, përfshirë mineralet dhe hidrokarburet në Shqipëri janë pronë e Shqipërisë;

(B) Operacionet Hidrokarbure në Shqipëri rregullohen prej ligjeve të Republikës së Shqipërisë, dhe nëse nuk përmendet ndryshe në këtë Kontratë, kryesisht nga, por pa u kufizuar këtu, tek ligjet dhe aktet e mëposhtme:

- Ligjit Nr. 7746 datë 28.07.1993, i ndryshuar, "Ligji mbi Hidrokarburet (Kërkim dhe Prodhim)", i ndryshuar (më poshtë "**Ligji për Hidrokarburet**");
- Ligji Nr. 7811, datë 12.04.1994 "Mbi miratimin me ndryshime të Dekretit nr. 782 datë 22.02.1994 "Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (Kërkim-Prodhim)", i ndryshuar;

- Ligji Nr. 92/2014, datë 24.07.2014, "Mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (më poshtë "**Ligji për TVSH**");
- Ligji nr.9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar
- Ligji Nr. 61/2012 datë 24.05.2012 "Për Akcizën në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar (më poshtë "**Ligji për Akcizën**");
- Ligjit Nr. 102/2015, datë 23.09.2015 "Për sektorin e gazit natyror";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 547, datë 09.08.2006 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare për Burimet Natyrore" i ndryshuar, dhe
- Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjisë dhe Albpetrolit, datë 26.07.1993 (më poshtë "**Marrëveshja Albpetrol**"), e ndryshuar.

Në këtë Kontratë, referimi në "ligj" apo në cdo akt ligjor tjetër do të përfshijë të gjitha amendimet, ndryshimet ose ligjet apo aktet e tjera ligjore zëvendësuese që kanë hyrë në fuqi përpara apo pas datës së kësaj Kontrate dhe të gjitha aktet ligjore, rregulloret, rregullat, urdhrat apo të drejtat e deleguara apo që dalin në zbatim të apo në bazë të një ligji apo akti ligjor të tillë. Ky përcaktim nuk do të interpretohet në ndonjë mënyrë si heqje dorë nga e drejta e Kontraktorit në bazë të Nenit 9.4 dhe 18.4 të kësaj Kontrate.

(C) Bazuar në Marrëveshjen Albpetrol, vetëm Albpetrol ka të drejtën të kryejë operacione hidrokarbure në Zonën e Kontratës të përcaktuar më poshtë dhe sipas Licencë Marrëveshjes të përcaktuar më poshtë, Ministria e Energjisë dhe Industrisë ("**MEI**" ose "**Ministria**") i ka dhënë Albpetrol-it të drejtën ekskluzive të kryejë Operacione Hidrokarbure në Zonën e Kontrates dhe të hyjë në këtë Kontratë me Kontraktorin;

(D) Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 547, datë 9 Gusht 2006, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ("AKBN") do të veprojë në emër të Ministrisë dhe do të sigurojë miratimet dhe autorizimet e nevojshme për realizimin e Operacioneve Hidrokarbure brenda Zonës së Kontratës;

(E) Kontraktori bie dakord të marrë përsipër të gjitha detyrimet dhe të gëzojë të drejtat e parashikuara në këtë Kontratë në lidhje me Operacionet Hidrokarbure që do të kryhen në dhe përgjatë Zonës së Kontratës (përshkruar në Anekset "A" dhe "B" të kësaj Kontrate);

(F) Në bazë të një Instrumenti Transferimi sipas formatit bashkëngjitur si Aneksi "F", të ekzekutuar nga Palët në datën e këtij dokumenti, ku MEI vepron nëpërmjet AKBN, Albpetrol i ka transferuar Kontraktorit të drejtën e tij për të kryer Operacione Hidrokarbure në Zonën e Kontratës dhe AKBN e ka miratuar këtë transferim për llogari të MEI.

(G) Palët janë të angazhuara të garantojnë që Operacionet Hidrokarbure do të drejtohen në përputhje me Ligjin dhe në një mënyrë etike, efiçente, të sigurtë, transparente dhe të përgjegjshme, bazuar në parimet më të mira ndërkombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor, social dhe ekonomik, në mënyrë që të arrihet një shfrytëzimin optimal dhe afatgjatë i burimeve Hidrokarbure për krijimin e vlerave maksimale për një përfitim të drejtë dhe në dobi të mirëqënies së popullit të Republikës së Shqipërisë.

(H) Kontraktori synon që, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë, si dhe ka bërë të ditur faktin që ai/ajo ka ose mund të sigurojë, burimet e nevojshme për zhvillimin e Operacioneve Hidrokarbure në Zonën e Kontratës siç përcaktohet më poshtë, dhe për këtë qëllim, posedon kapacitetin e nevojshëm financiar, kompetencën teknike, eksperiencën e mjaftueshme dhe aftësitë profesionale për t'i kryer këto Operacione.

PALËT BIEN DAKORD SE:

1. PËRKUFIZIME

1.1 "**Procedura e Kontabilitetit**" janë procedurat dhe kërkesat e raportimit të përcaktuara në Aneksin "C" të kësaj Kontrate dhe që është pjesë integrale dhe e pandashme e kësaj Kontrate;

1.2 "**Shoqëri e lidhur**" është çdo shoqëri e kontrolluar, çdo shoqëri mëmë apo motër e njërës prej Palëve apo çdo subjekt që bën pjesë në njërën prej Palëve. Për qëllim të përcaktimit më sipër:

1.2.1 një shoqëri e kontrolluar është një shoqëri që kontrollohet nga njëra prej Palëve apo një subjekt që përbën këtë Palë;

1.2.2 një shoqëri mëmë është një shoqëri e cila kontrollon njërën Palë apo një subjekt që përbën këtë Palë;

1.2.3 një shoqëri motër është një shoqëri e cila kontrollohet prej të njëjtës shoqëri sikurse njëra Palë apo një subjekt që përbën këtë Palë.

për qëllimet të së cilës "**kontroll**", "**kontrollon**" apo "**e kontrolluar**" do të thotë se një shoqëri zotëron kapital aksionar, si drejtpërsëdrejti ashtu edhe përmes shoqërive të tjera, i cili i jep asaj shumicën e votave në asambletë e ortakëve apo kontrollin ligjor të menaxhimit me qëllim të marrjes së vendimeve materiale të shoqërisë së kontrolluar;

1.3 "**Shqipëri**" është Republika e Shqipërisë;

1.4 "**Qeveria Shqiptare**" do të thotë Qeveria e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë çdo ministri, departament, agjenci, nën-ndarje politike apo instrumentale e saj ose çdo autoritet tjetër qeveritar shqiptar. Për sqarime të mëtejshme, përkufizimi i mësipërm "Qeveria Shqiptare" nuk përfshin Albpetrol-in;

1.5 **"Pjesa e Albpetrolit"** do të thotë pjesa e prodhimit e përcaktuar sipas Nenit 7.7 të kësaj Kontrate.

1.6 "**Vlerësime**" janë punimet e kryera nga Kontraktori, që sipas mendimit të Kontraktorit janë të nevojshme të kryhen në vazhdim të një Zbulimi në mënyrë që të përcaktohet nëse ky Zbulim është një Zbulim Tregtar, dhe/ose që të përcaktohen limitet e një Zbulimi Tregtar të mundshëm;

1.7 **"Periudhë Vlerësimi"** është periudha pas përfundimit të Periudhës së Kërkimit, e nevojshme për të përfunduar shpimin dhe testimin e një Pusi Vlerësimi për të cilin është nisur kryerja e operacioneve përpara përfundimit të Periudhës së Kërkimit, sikurse përshkruhet më tej në Nenin 4.3;

1.8 "**Program Vlerësimi** " është programi i paraqitur nga Kontraktori në përputhje me Nenin 6, nën të cilin Kontraktori do të vlerësojë dhe përvijojë një apo më shumë Zbulime;

1.9 "**Kostot e Aprovuara**" janë kostot e përcaktuara në përputhje me Paragrafin I.4 të Procedurës së Kontabilitetit;

1.10 "**Gaz Shoqërues**" është Gazi i gjetur që shoqëron Naftën Bruto nëse kjo Naftë Bruto mund të prodhohet vetë në mënyrë tregtare;

1.11 "**Prodhimi i Disponueshëm**" është sasia e prodhimit ditor të Hidrokarbureve (duke zbritur çdo sasi të humbur, të përdorur në operacione, të ndezur ose të ri-injektuar), të prodhuar, ruajtur dhe matur nga Zona e Kontratës deri tek Pika e Matjes;

1.12 **"Hidrokarbure të Disponueshme"** është Prodhimi i Disponueshëm pasi është zbritur Pjesa e Albpetrol dhe Taksa e Rentës.

1.13 "**Prodhimi Mesatar Ditor**" është prodhimi mesatar ditor i Prodhimit të Disponueshëm për çdo Ditë gjatë një Muaji, i përllogaritur duke ndarë sasinë totale të Prodhimit të Disponueshëm të matur nga Zona e Kontratës tek Pika e Matjes gjatë Muajit, me numrin e Ditëve në atë Muaj. Për Muajin në të cilin nis Data e Fillimit të Prodhimit Tregtar, Prodhimi i Disponueshëm i sipërpërmendur do të ndahet sipas numrit të Ditëve në atë Muaj që pason dhe duke përfshirë Datën e Fillimit të Prodhimit Tregtar;

1.14 "**Fuçi**" është një sasi Naftë Bruto, ekuivalente me dyzet e dy (42) galonë të Shteteve të Bashkuara (përafërsisht e barabartë me 158,987 litra), masë e lëngshme, e korrektuar në temperaturën 60 gradë Fahrenheit, me presion në nivelin detar prej 1,01325 bar;

1.15 "**Blok**" është Blloku i Velçës i përshkruar në Aneksin "A" dhe prezantuar grafikisht në Aneksin "B";

1.16 "**BPD**" janë Fuçitë në Ditë dhe përfshin BOPD, si edhe BOE;

1.17 "**BTU**" do të thotë 1.055,056 Joules;

1.18 "**Buxhet**" është vlerësimi i shpenzimeve të nevojshme për kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure sipas një Plani Pune të miratuar;

1.19 "**Vit Kalendarik**" është një periudhë prej dymbëdhjetë (12) Muajsh të njëpasnjëshëm në përputhje me kalendarin Gregorian duke filluar që nga 1 Janari e që përfundon në 31 Dhjetor, përfshirë edhe këto dy data;

1.20 "**Zbulim Tregtar**" është një Zbulim akumulimi Hidrokarburesh, i cili sipas mendimit të Kontraktorit, mund të shfrytëzohet ekonomikisht në përputhje me këtë Kontratë;

1.21 "**Kontrata**" është kjo Marrëveshje për Ndarjen e Prodhimit përfshirë Anekset e saj, sikurse mund të pësojnë ndryshime herë pas here me marrëveshje të përbashkët të Palëve;

1.22 "**Zonë e Kontratës**" është zona e përshkruar në Aneksin A dhe detajuar në hartat e bashkëlidhura në Aneksin B në Datën e Hyrjes në Fuqi dhe më pas, ajo pjesë e kësaj zone, me ndryshimet që mund të pësojë si pasojë e dorëheqjeve që mund të japë Kontraktori;

1.23 "**Viti Kontraktor**" është një periudhë prej dymbëdhjetë (12) Muajsh (që normalisht konsiston në treqind e gjashtëdhjetë e pesë (365) ditë të njëpasnjëshme), duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi;

1.24 "**Kontraktor**" është Pennine Petroleum Corporation apo pasardhësit e tij, si dhe çdo cesionar (përfitues) i çdo Interesi Pjesëmarrës sipas Nenit 19;

1.25 "**Hidrokarbure Për Mbulim Kostoje**" është ajo pjesë e Hidrokarbureve nga e cila Kontraktori ka të drejtë të rikuperojë kostot dhe shpenzimet për Operacionet Hidrokarbure, sikurse përcaktuar në Nenin 7 të kësaj Kontrate;

1.26 "**Naftë Bruto**" ka të njëjtin kuptim me kuptimin që i jep këtij termi ligji hidrokarbur;

1.27 "**Detyrime Doganore**", sikurse përdorur këtu, përfshijnë të gjitha kontributet, detyrimet, taksat, tarifat, të drejtat apo tatimet e llojeve të tjera financiare, që mund të jenë të detyrueshme të paguhen si pasojë e importit të artikullit ose artikujve, sikurse është përcaktuar në Nenin 12 të kësaj Kontrate;

1.28 "**Data e Zbulimit Tregtar**" është data kur Kontraktori njofton AKBN me shkrim mbi një Zbulim Tregtar në bazë të Nenit 6.4.1 të kësaj Kontrate;

1.29 "**Data e Zbulimit**" të një pusi është data në të cilën një Zbulim është kryer dhe testuar;

1.30 "**Data e Prodhimit Fillestar Tregtar**" është, në lidhje me çdo Zonë Zbulimi, e para prej: (a) dita e fundit e tridhjetë (30) ditëve të para përgjatë se cilave, është kryer prodhim i rregullt dhe i vazhdueshëm i Naftës Bruto ose (b) dita e fundit e tridhjetë (30) ditëve të para përgjatë së cilave kryhet transport i rregullt dhe i vazhdueshëm i

(30) ditëve të para përgjatë së cilave kryhet transport i rregullt dhe i vazhdueshëm i Hidrokarbureve për shitje nga një Zbulim Tregtar tek Pika e Matjes në bazë të një Plani Zhvillimi, dhe nuk duhet të përfshijë transport të prodhimit të testuar apo të prodhimit në testim të zgjeruar;

1.31 "**Ditë**" ose "**ditë**" është një periudhë prej njëzet e katër (24) orësh duke filluar në orën 00:00 dhe përfunduar në orën 24:00, sipas orës shqiptare;

1.32 "**Pikë Lëvrimi**" është çdo pikë e rënë dakord mes palëve dhe e miratuar nga AKBN, ku secila palë merr pjesën e saj të Prodhimit të Disponueshëm. Një Pikë Lëvrimi mund të jetë ose jo e njëjtë me Pikën e Matjes;

1.33 "**Zhvillim**" do të thotë dhe përfshin, por pa u kufizuar në, të gjitha operacionet dhe aktivitetet në përputhje me këtë Kontratë sipas një Plani të miratuar Zhvillimi, Plani Pune dhe Buxheti në lidhje me:

1.33.1 shpimin, mbylljen, gjurmimet anësore dhe rishpimet, thellimin dhe përfundimin dhe pajisjen e puseve për qëllim Prodhimi dhe ndryshimin e statusit të çdo pusi të tillë, dhe

1.33.2 dizenjimin, ndërtimin, instalimin dhe operimin (në apo jashtë Zonës se Kontratës) të pajisjeve; platformave; tubacioneve; sistemit të ujit, elektricitetit dhe sisteme të tjera; objektet (përfshirë magazinimin portual dhe objektet e ngarkimit); dhe impiantet, sikurse nevojitet për të prodhuar nga puset, për të marrë, ruajtur, trajtuar, punuar, magazinuar, djegur, transportuar dhe dorëzuar Hidrokarburet për eksport dhe për tregjet lokale dhe për të ndërmarrë injektime dhe ri-injektime dhe projekte të tjera të zgjeruara rimëkëmbje;

Përdorimi i termit Zhvillim në këtë Kontratë përfshin Prodhimin siç përkufizohet në këtë Kontratë, kur del nga konteksti dhe rrethanat;

Folja "**Zhvilloj**" i referohet kryerjes së aktiviteteve të Zhvillimit;

1.34 "**Zonë Zhvillimi dhe Prodhimi**" do të thotë zona e përcaktuar nga Kontraktori, siç përvijohet në një Plan Zhvillimi në përputhje me nenin 6, duke njoftuar Albpetrol dhe AKBN me shkrim se Kontraktori ka bërë një Zbulim Tregtar dhe ka pajisur Albpetrol dhe AKBN me një hartë përshkruese të një zone e cila përmban tërësisht apo pjesërisht Zonën e Zbulimit. Një Zonë Zhvillimi dhe Prodhimi mund të përbëhet nga më shumë se një zona jo-të ngjitura dhe pasi kjo përcaktohet, shtrihet në të gjitha thellësitë e kufijeve të saj anësorë;

1.35 "**Periudhë Zhvillimi dhe Prodhimi**" do të thotë periudha e përcaktuar në përputhje me nenin 6.10 për çdo Zbulim për të cilin është miratuar një Plan Zhvillimi;

1.36 "**Shpenzime Zhvillimi**" do të thotë të gjitha kostot dhe shpenzimet direkte dhe indirekte për Zhvillimin dhe Prodhimin, me përjashtim të Shpenzimeve Operacionale;

1.37 "**Plan Zhvillimi**" do të thotë një plan i paraqitur nga Kontraktori dhe i miratuar nga AKBN, siç parashikohet nga neni 6.4.1 për zhvillimin e një Zbulimi pas Vlerësimit të Zbulimit, përmbajtja e të cilit duhet të përfshijë, por pa u kufizuar tek sa më poshtë:

1.37.1 të dhëna mbi të gjithë aktivitetet e kërkimit të ndërmarra në lidhje me Zbulimin përkatës dhe të gjithë informacionin e përdorur për një Vlerësim, të dhëna mbi strukturën gjeografike dhe dukuritë e stratigrafitë hidrokarbone dhe të dhëna për çdo Zbulim tjetër pasues sikurse mund të kërkohet sipas mendimit të Kontraktorit;

1.37.2 vëllime të parashikuara të naftës dhe/ose gazit fillimisht në vend dhe sasia e parashikuar për t'u nxjerrë, mekanizmi i pritshëm i drejtimit dhe efiçenca e nxjerrjes, hapërisat e kullimit, politikat e operimit të rezervuarëve të synuar dhe synimet për nxjerrjet dytësore;

1.37.3 të dhëna të plota mbi objektet ose strukturat dhe të gjitha punimet e tjera që Kontraktori propozon të ndërtojë ose të ndërmarrë gjatë Periudhës së Zhvillimit dhe Prodhimit për Zbulimin përkatës me qëllim prodhimin e Naftës Bruto dhe/ose Gazit nga ky Zbulim, si edhe minimizimin e ndezjeve të Gazit dhe parandalimin e ndotjes së mjedisit;

1.37.4 vendodhjen dhe qëllimet për të cilat objektet, strukturat ose punimet e tjera do të përdoren dhe periudhat gjatë të cilave çdo objekt, strukturë ose punim tjetër do të fillojë dhe përfundojë;

1.37.5 vlerësimin e Kontraktorit mbi tregtueshëmrinë e Hidrokarbureve, sasinë maksimale dhe minimale të Hidrokarbureve që Kontraktori pret të nxjerrë nga Zbulimi përkatës gjatë çdo viti të periudhës së Prodhimit që lidhet me të, normën e nxjerrjeve të pritshme dhe të dhëna mbi çdo problem që pritet të haset në lidhje me Prodhimin dhe tregtueshmërinë;

1.37.6 të dhëna mbi parashikimet vjetore të shpenzimeve dhe të lëvizjeve monetare të kapitalit dhe Shpenzimeve Operacionale, duke kuptuar se këto janë vlerësime të bëra në mirëbesim, të bazuara në të dhëna paraprake të cilat nuk duhen të merren si detyruese ose si parashikime garantuese për çfarëdo synimi;

1.37.7 kontingjentët për minimizimin e humbjeve të Gazit, programe të ruajtjes së presionit për të optimizuar nxjerrjet Hidrokarbure dhe Zhvillimin shtesë;

1.37.8 një vlerësim të arsyeshëm të kohës së nevojshme për të ndërmarrë Planin e Zhvillimit;

1.37.9 Pikat e Matjes dhe Pikat e Lëvrimit të ardhshme;

1.37.10 Të dhëna mbi Zonën e Zhvillimit dhe Prodhimit dhe shtrirjen e Zonës së Prodhimit dhe Zhvillimit të propozuar në lidhje me Zbulimin Tregtar, zonë

e cila duhet t'i korrespondojë shtrirjes gjeografike të projektuar të Zbulimit Tregtar mbi zona të lidhura në mënyrë të arsyeshme dhe që përcaktohen si Zona Prodhimi dhe Zhvillimi për Zbulimin Tregtar në fjalë;

1.38 "**Zbulim**" do të thotë një akumulim i rekuperuar Hidrokarburesh në në çdo strukturë të shpuar, e cila më parë nuk dihej se ekzistonte dhe që është e matshme me metodat konvencionale të industrisë së hidrokarbureve;

1.39 "**Zonë Zbulimi**" do të thotë një zonë ose zona që mund të vendosë Kontraktori në çdo kohë përpara mbarimit të Periudhës së Kërkimit, duke njoftuar me shkrim AKBN që Kontraktori ka bërë një Zbulim dhe e pajis Albpetrolin dhe AKBN me një skicë të kufijve të çdo pjese të Zonës se Kontratës ku Kontraktori beson se ka një Zbulim. Pas përcaktimit sipas nenit 6, një Zonë Zbulimi do te shtrihet në të gjitha thellësitë brenda kufijve të saj anësorë.

1.40 "**Dollarë**" ose simboli "**$**" do të thotë Dollarët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës;

1.41 "**Datë e Hyrjes në Fuqi**" do të thotë data kur nxirret vendimi i Këshillit të Ministrave të Qeverisë së Shqipërisë i cili miraton këtë Kontratë në përputhje me Ligjin për Hidrokarburet;

1.42 "**Ekspert**" do të thotë një individ i cili nuk është rezident dhe shtetas shqiptar apo kanadez, as nuk ka qenë i punësuar nga Kontraktori apo Albpetroli, i cili me anë të trajnimeve dhe një eksperience të gjerë ka njohuri të zhvilluara në fushën teknike ku shtrihen mosmarrëveshjet apo konfliktet të adresuara për zgjidhje këtij individi, dhe i cili emërohet sipas parashikimeve të nenit 21.8;

1.43 "**Kërkim**" do të thotë Operacionet Hidrokarbure që kryhen sipas kësaj Kontrate gjatë Periudhës Kërkimore dhe çdo Periudhe Vlerësimi (siç mund të zgjatet), për ose në lidhje me kërkimin për ose Vlerësimin Hidrokarbur, që përfshin por pa u limituar në, studime dhe sondazhe gjeologjike, gjeofizike dhe teknike të tjera, rishikimin, përpunimin dhe analizën e të dhënave, shpimin e puseve kërkimore, planifikimin, dizenjimin, administrimin, inxhinierinë, ndërtimin dhe kryerjen e operacioneve të mirëmbajtjtes përkatëse, si edhe të gjitha operacionet dhe aktivitetet e tjera të lidhura e të referuara në Aneksin "C" ose të rëna dakort ndryshe sipas dispozitave të kësaj Kontrate;

Folja **"Kërkoj"** do të thotë të kryesisht kërkim

1.44 "**Komitet Këshillues**" do të thotë komiteti i krijuar sipas nenit 4.6 për rishikimin dhe miratimin e çështjeve të caktuara sipas kësaj Kontrate;

1.45 "**Shpenzime Kërkimi**" do të thotë të gjitha kostot dhe shpenzimet direkte dhe indireke për Kërkim;

1.46 "**Periudhë Kërkimore**" do të thotë Faza e Parë e Kërkimit, Faza e Dytë e Kërkimit dhe Faza e Tretë e Kërkimit, siç përcaktohet përkatësisht në nenet 4.1.1, 4.1.2 dhe 4.1.3;

1.47 "**Pus Kërkimor**" do të thotë qoftë një Pus Prove ose një Pus Vlerësimi;

1.47.1 "**Pus Prove**" do të thotë një pus i përcaktuar për të eksploruar një strukturë gjeologjike, nga e cila nuk janë zbuluar më parë sasi të tregëtueshme hidrokarburesh; dhe

1.47.2 "**Pus Vlerësimi**" do të thotë një pus, qëllimi i shpimit të të cilit është përcaktimi i shtrirjes ose vëllimit të rezervave hidrokarbure që përmban një zbulim,

1.48 "**Anëtar i Familjes**" do të thotë një Person i lidhur me një tjetër deri në shkallë të tretë gjaku, krushqie ose birësimi;

1.49 "**Faza e Parë e Kërkimit** " do të thotë periudha prej dy vjet kontraktorë nga Data e Hyrjes në Fuqi, plus çdo zgjatje sipas nenit 4.1.1;

1.50 "**Forcë Madhore**" do të thotë çdo ndodhi e cila shkakton për një Palë vonesë në kryerjen ose mos-kryerjen e detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate të ardhur nga rrethana që nuk mund të parashikohen, shmangen apo parandalohen, përtej kontrollit të arsyeshëm dhe pa fajin apo neglizhencën e Palës në fjalë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, veprime të Zotit ose trazirat publike, veprime apo mosveprime të Autoriteteve Qeveritare, kushte ekstreme të motit, mosfunksionime mekanike, rreziqe lundrimi, zjarr, veprime ushtarake, luftë (të deklarauar apo jo), bllokada, trazira në punë, greva, rebelime, kryengritje, kufizime karantinë, epidemi, tërmete apo fatkeqësi të tjera natyrore ose aksidente, me përjashtim të mungesës së fondeve apo çdo paqëndrushmërie tjetër financiare nga ana e Kontraktorit;

1.51 "**Gaz**" janë hidrokarburet e gazit, si shoqëruese ashtu edhe jo shoqëruese, si dhe të gjithë elementët përbërës së tij, prodhuar nga cilido pus në Zonën e Kontraktore, përfshirë gazin natyror të lëngshëm dhe Gazin e Kondensuar, siç përcaktohet në ligjin nr. 102/2015 datë 23.09.2015 "Për sektorin e gazit natyror", ose cilido ligj që do të aplikohet në të ardhmen për sektorin e gazit natyror në Shqipëri;

1.52 "**Gazi i Kondensuar**" janë ato Hidrokarbure që në mënyrë natyrale ekzistojnë në një fazë të vetme gazi në rezervuarë dhe që bëhen të lëngshëm në kushte standarde temperature dhe presioni;

1.53 "**Zonë Pezullimi e Gazit**" ka kuptimin sipas nenit 8.2;

1.54 "**Periudhë Pezullimi e Gazit**" ka kuptimin sipas nenit 8.2;

1.55 "**G&G**" ka kuptimin e përcaktuar në Nenet 4.1.1, 4.1.2 ose 4.1.3, sipas kontekstit;

1.56 "**Praktikat e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure**" janë ato praktika, metoda, standarde, dhe procedura përgjithësisht të pranuara dhe të ndjekura ndërkombëtarisht nga operatorë Hidrokarburë të kujdesshëm, të zellshëm, të aftë, dhe me eksperiencë në kërkimin e Hidrokarbureve, zhvillimin, dhe operacionet e prodhimit e të cilat, në një kohë të caktuar, në ushtrimin e gjykimit me mirëbesim

dhe në dritën e fakteve të njohura në kohën e marrjes së një vendimi, janë të pritshme për të arritur rezultatet e dëshiruara dhe qëllimet e përcaktuara në lidhje me të cilat praktikat, metodat, standardet, procedurat dhe rregulloret e sigurisë, sipas rastit, janë ndjekur; me kusht që, sidoqoftë, termi "**Praktikat e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure**" nuk ka qëllim të jetë i kufizuar në praktikat optimale duke përjashtuar të gjitha të tjerat, por më tepër për të qenë një spektër i praktikave të arsyeshme dhe të dobishme, metodave, standardeve, procedurave dhe rregulloreve të sigurisë të përcaktuara në bazë të gjykimit në mirëbesim të Operatorit. Zbatimi i tyre bëhet për aq kohë sa nuk janë në kundërshtim me parashikimet e kësaj Kontrate dhe me ligjin shqiptar të zbatueshëm.

1.57 "**Autoriteti qeveritar**" është (i) çdo organ qeverisës kombëtar, vendor apo krahinor dhe çdo ministri apo departament i tyre, ose (ii) çdo Person që ushtron funksione ekzekutive, rregulluese apo administrative apo që i përkasin njërës prej tyre (përfshirë çdo rregullator të pavarur) ose (iii) çdo entitet qeveritar, instrument përkatës, agjenci, autoritet ose (iv) çdo entitet tjetër, komitet apo komision nën kontrollin e drejtëpërdrejtë ose indirekt të qeverisë. Për sqarime të mëtejshme, përcaktimi i "Autoritetit Qeveritar" nuk përfshin Albpetrolin;

1.58 "**Licencë Marrëveshje**" është Licencë Marrëveshja e hyrë në fuqi më _____, 2017, një kopje e plotë e së ciles i është dhënë Kontraktorit, ku MEI i ka garantuar Albpetrolit të drejtën ekskluzive të kryejë Operacione Hidrokarbure ne Zonën E Kontratës dhe të lidhë këtë Kotnratë;

1.59 "**Autoritet Qeveritar i Shtetit Mëmë**" është çdo Autoritet Qeveritar në të cilin njëra Palë apo cilado prej shoqërive të veta të lidhura është e regjistruar apo ka si vend parësor ushtrimin e aktivitetit të vet tregtar;

1.60 "**Pika e Matjes**" vendi apo vendet, të përshkruara në një Plan Zhvillimi ku Hidrokarburet maten në mënyrë që të përcaktohen volumet e Prodhimit të Disponueshëm. Në çdo rast, Pika e Matjes do të thote pika e përcaktuar bashkarisht mes AKBN dhe Palëve, ku do të vendosen instalimet dhe pajisjet përkatëse me qëllim kryerjen e matjeve volumetrike dhe të tjera të ngjashme, temperaturës dhe të ngjashme, përcaktimi i përmbajtjes së ujit dhe sendimenteve e te ngjashme, për përcaktimin e volumeve të hidrokarbureve me qëllim realizimin e kërkesave të Licencë Marrëveshjes dhe kësaj Kontrate. Pika e Matjes mundo të jetë ose jo e njëjtë me Pikën e Lëvrimit.

1.61 "**Muaj**" është muaji kalendarik;

1.62 "**Gaz jo-shoqërues**" do të thotë Gazi përveç Gazit Shoqërues;

1.63 "**Shpenzime Operacionale**" janë të gjitha kostot direkte dhe indirekte, shpenzimet operacionale dhe ato kapitale të lindura apo të shkaktuara nga Kontraktori, për ose në lidhje me kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure, duke përfshirë, pa kufizim, shëndetin e njeriut, sigurinë dhe shpenzimet e mbrojtjes së mjedisit dhe të

Kontrate. Shpenzimet Operacionale duhet përfshijnë riparimin dhe mirëmbajtjen e aseteve, por nuk përfshin asnjë nga këto: gjurmim anësor; ri-shpimi dhe ndryshimi i statusit të një pusi, zëvendësimi i aseteve ose pjesëve të një aseti; shtesat, përmirësimet, apo ripërtëritjet që zgjasin jetën e aktivit; të gjitha prej të cilave do të jenë Shpenzime Kërkimore ose Shpenzime Zhvillimi, sipas rastit;

1.64 "**Operator**" është një entitet i emëruar nga Kontraktori në pëputhje me Nenin 4.11, që mund ose mund të mos jetë një Shoqëri e Lidhur, i cili është pëgjegjës për të kryer Operacionet Hidrokarbure në Zonën e Kontratës apo në çdo pjesë tjetër në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate, dhe çdo pasardhës i këtij Operatori i emëruar dhe miratuar në bazë të Nenit 4.11. Emërimi i një Operatori tjetër duhet paraprakisht të miratohet nga Albpetroli, miratim ky që nuk do të mbahet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme.

1.65 "**Interes Pjesëmarrës**" do të thotë interesi përkatës i pandarë për çdo subjekt që mund të përbëjë Kontraktorin në një kohë të dhënë mbi çdo të drejtë, detyrim dhe përgjegjësi sipas kësaj Kontrate;

1.66 "**Palët**" do të thotë Albpetroli dhe Kontraktori, dhe "**Pala**" do të thotë secila nga Palët, duke përfshirë pasardhësit apo cesionarët (përfituesit) e tyre përkatës;

1.67 "**Person**" do të thotë një individ, korporatë, shoqëri, ortakëri, ortakëri e kufizuar, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, trust, pasuri, agjenci qeveritare ose çdo njësi tjetër, përfshirë bashkime tregtare të paregjistrueshme;

1.68 "**Hidrokarbure**" do të thotë bashkërisht apo individualisht, sipas konteksit, Naftë Bruto dhe Gaz;

1.69 "**Operacione Hidrokarbure**" do të thotë të gjitha apo secila nga operacionet e drejtuara nga Operatori, që lidhen me kërkimin, zhvillimin, nxjerrjen, prodhimin, ndarjen dhe trajtimin, magazimin, transportimin, shitjen ose heqjen e hidrokarbureve deri në Pikën e Lëvrimit, duke përfshirë operacionet e procesimit të gazit natyror, por nuk përfshin operacionet e rafinimit të hidrokarbureve.

1.70 "**Prodhim**" do të thotë çdo lloji operacioni të ndërmarrë nga Kontraktori sipas kësaj Kontrate në Zonën e Kontratës deri në Pikën e Lëvrimit për të prodhuar Hidrokarbure dhe operuar puse prodhimi, pas fillimit të prodhimit nga një Zbulim Tregtar, dhe marrja, ruajtja, trajtimi, punimi, magazinimi, transportimi, matja dhe dorëzimi i Hidrokarbureve, injektimi apo ri-injektimi ose çdo lloj tjetër operimi për të përftuar nxjerrje parësore dhe të intensifikuar të Hidrokarbureve, si edhe transportimi, magazinimi dhe çdo punim apo aktivitet tjetër i nevojshëm ose plotësues i këtyre operacioneve;

Folja "**Prodhoj**" do të thotë kryerja e Prodhimit;

1.71 **"Kosto të Refuzuara"** janë të gjitha ato kosto që përcaktohen sipas Nenit 4.10 të kësaj Kontrate.

1.72 "**Hidrokarbure Fitim**" ka kuptimin sipas nenit 7.6 të kësaj Kontrate;

1.73 "**Cesionarë (Përfitues) të Ndaluar**" do të thotë (i) çdo Zyrtar Publik; ose (ii) çdo njësi tek e cila një apo disa Persona sipas pikës (i) të këtij paragrafi kanë një interes, përjashtuar interesin si pasojë e pronësisë së këtyrë Personave mbi titujt e tregtuara publikut;

1.74 "**Persona të Ndaluar**" do të thotë çdo Person: (a) emri i të cilit është i specifikuar në, apo gjëndet në udhëzime apo vendime të, ose është i listuar pranë çdo Autoriteti Qeveritar të çdo Shteti Mëmë apo Kombeve të Bashkuara që e përcakton këtë person si terrorist apo anëtar të një organizate terroriste apo bllokon pasuritë e këtij personi apo organizate; (b) në lidhje me të cilin çdo Autoritet Qeveritar i çdo Shteti Mëmë ose Kombet e Bashkuara kanë shpallur publikisht se të gjitha transaksionet financiare që përfshijnë pasuritë e këtij Personi apo organizate kanë qënë, apo do të bllokohen; ose (c) që përcaktohet kohë pas kohe nga çdo Autoritet Qeveritar içdo Shteti Mëmë ose Kombet e Bashkuara si terrorist apo organizatë terroriste ose një organizatë që mbështet apo i siguron mbështetje një personi terrorist apo organizate terroriste;

1.75 "**Zyrtar Publik**" do të thotë (i) çdo zyrtar, zyrtar i punësuar apo përfaqësues i një Autoriteti Qeveritar ose çdo agjencie publike, ndërmarrje publike apo organizate ndërkombëtare publike; ose (ii) çdo Person i cili vepron për apo për llogari të Autoritetit Qeveritar ose çdo agjencie publike, ndërmarrje publike apo organizate ndërkombëtare publike; ose (iii) çdo njësi e jashtme këshilluese apo Person i punësuar nga një Autoritet Qeveritar ose çdo agjencie publike, ndërmarrje publike apo organizate ndërkombëtare publike; ose (iv) çdo parti politike apo zyrtar i partisë politike; ose (v) çdo kandidat për një pozitë politike. Për sqarime të mëtejshme, përkufizimi i **"Zyrtarit Publik"** nuk përfshin Albpetrolin;

1.76 "**Tremujor**" do të thotë nje periudhë prej tre (3) Muajsh të njëpasnjëshëm që filiojnë në ditën e parë të janarit, prillit, korrikut ose tetorin të çdo Viti Kalendarik;

1.77 **"Naftë Bruto Referencë"** do të thotë naftë bruto e një rëndese dhe sasie të krahasueshme me vlerat e Naftës Bruto të kësaj Kontrate. Nafta bruto do të zgjidhet dhe miratohet nga AKBN përpara Datës së Fillimit të Prodhimit Tregtar nga çdo Zonë Zhvillimi dhe Prodhimi;

1.78 **"Çmim Bruto Referencë"** do të thotë pika-e-eksportit FOB mesatare ose CIF; sipas rastit çmimi spot për Naftën Bruto Referencë gjatë periudhës përkatëse, i kuotuar në Platt's Oilgram Price Report, i përshtatur kur nevojitet për të pasqyruar diferencat e rëndesës, sasitë dhe cilësitë ndërmjet Naftës Bruto Referencë dhe Naftës Bruto që vlerësohet këtu, në termat e pagesave tridhjetë (30) ditore;

1.79 "**Përfaqësues**" do të thotë secili nga pronarët, zyrtarët, drejtorët, punëtorët, agjentët apo këshilluesit e secilës Palë ose Shoqërive të Lidhura të tyre;

1.80 "**Rentë Minerare**" do të thotë taksa në përputhje me Ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008, "Për taksat kombëtare";

1.81 "**Faza e Dytë e Kërkimit**" do të thotë periudha prej dy Vjet e gjysëm (2.5) Kontraktorë nga përfundimi i Fazës së Parë e Kërkimit, së bashku me çdo zgjatje sipas nenit 4.1.2;

1.82 "**Deklarata e Kostove të Rikuperueshme**" do të thotë deklarata referuar nga paragrafi 3 i Kapitullit 1 të Procedurave të Kontabilitetit;

1.83 "**Deklaratë e Aktivitetit të Kërkimit**" do të thotë deklarata referuar nga paragrafi 3.1 i Kapitullit 1 të Procedurave të Kontabilitetit që paraqet Shpenzimet Kërkimore për Tremujorin në fjalë dhe që i paraqitet Albpetrolit dhe AKBN në përputhje me nenin 4.8;

1.84 "**Deklaratë e Aktivitetit të Zhvillimit**" do të thotë deklarata referuar nga paragrafi 3.2 i Kapitullit 1 të Procedurave të Kontabiliteti që paraqet Shpenzimet e Zhvillimit për Tremujorin në fjalë dhe që i paraqitet Albpetrolit dhe AKBN në përputhje me nenin 6.13;

1.85 **"Kostot e Pezulluara"** janë kostot e përcaktuara në Nenin 4.10 të kësaj Kontrate;

1.86 "**Zgjidhje**" do të thotë përfundimi i kësaj Kontrate nëpërmjet zbatimit të parashikimeve të nenit 24 ose nga një marrëveshje me shkrim mes Palëve;

1.87 "**Faza e Tretë e Kërkimit**" do të thotë periudha prej dy (2) Vjet Kontraktore nga përfundimi i Fazës së Dytë Kontraktore, së bashku me çdo zgjatje sipas nenit 4.1.3;

1.88 "**Programi (Plani) i Punës**" do të thotë një skedulë programi dhe kohe, e planifikuar për të kryer Operacione Hidrokarbure, në Zonën e Kontratës, Zonën e Zbulimit ose Zonën e Zhvillimit dhe Prodhimit, sikurse është rënë dakort në neni 4 dhe parashikimet e tjera përkatëse të kësaj Kontrate, dhe përveçse kur kërkohet ndryshe nga konteskti, i referohet të njejtit Plan, qoftë të ndryshuar apo shtuar.

2. ANEKSET E KONTRATËS

2.1 Aneksi "A" është një përshkrim i bllokut që përbën Zonën e Kontratës në Datën e Hyrjes në Fuqi.

2.2 Aneksi "B" është harta që tregon bllokun që përbën Zonën e Kontratës në Datën e Hyrjes në Fuqi.

2.3 Aneksi "C" është Procedurat e Kontabilitetit.

2.4 Aneksi "D" është procedura për përcaktimin e çmimit të Gazit.

2.5 Aneksi "E" është formati i garancisë bankare.

2.6 Aneksi "F" është Instrumenti i Transferimit.

2.7 Anekset "A", "B", "C", "D", "E" dhe "F" të kësaj Kontrate përbëjnë pjesë të kësaj Kontrate dhe konsiderohen të kenë të njejtën forcë dhe fuqi me dispozitat e kësaj

Kontrate. Megjithatë, në rast konflikti ndërmjet Anekseve dhe tekstit bazë të kësaj Kontrate, teksti bazë i Kontratës do të mbizotërojë.

2.8 Kjo Kontratë i mbizotëron dhe zëvendëson gjithë marrëveshjet dhe mirëkuptimet e mëparshme midis palëve, me gojë apo me shkrim, ne lidhje me objektin e këtushem, para Datës se Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate.

3 AFATET, DHËNIA E TË DREJTAVE DHE PAGESA E KOSTOVE

3.1 Përveçse kur Kontrata përfundon më herët në përputhje me kushtet e saj, ajo qëndron në fuqi gjatë Periudhës Kërkimore, çdo Periudhe Vlerësimi dhe çdo Periudhe Zhvillimi dhe Prodhimi.

3.2 Albpetrol i jep Kontraktorit të drejtën e vetme dhe ekskluzive për të kryer Operacione Hidrokarbure për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në Zonën eKontratës për periudhën e treguar këtu, duke zbatuar kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate.

3.3 Aktualisht Kontraktori përbëhet nga një (1) subjekt i vetëm. Në rast e transferimit të interesave në këtë Kontratë, në përputhje me nenin 19, Kontraktori njofton Albpetrolin dhe AKBN mbi Pjesëmarrjen në Interes të çdo subjekti që përbën Kontraktorin. Kontraktori paraqet gjithë dokumentacionin e nevojshëm me qëllim bërjen efektive të këtij trasnferimi brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, sipas kërkesave të përmendura në nenin 19 të kësaj Kontrate.

3.4 Kjo Kontraktë është një marrëveshje kërkimi, zhvillimi dhe ndarje prodhimi dhe mbulon Operacionet Hidrokarbure nw Zonën e Kontratës deri tek Pika e Lëvrimit. Të drejtat dhe detyrimet e Palëve sipas kësaj Kontrate do të kenë efekt që nga Data e Hyrjes në Fuqi.

3.5 Kontraktori kryen Operacionet Hidrokarbure sipas kësaj Kontrate duke marë përsipër i vetëm rrezikun dhe kostot, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga kjo Kontratë;

3.6 Kjo Kontratë nuk i jep Kontraktorit të drejta pronësie mbi Hidrokarburet *in situ* në Zonën e Kontratës. Megjithatë, Kontraktori do të ketë të drejtën të përftojë në natyrë, të disponojë dhe eksportojë lirisht pjesën e tij të Hidrokarbureve nga Zona e Kontratës në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate. Titulli dhe risku i pjesës së Kontraktorit mbi Hidrokarburet sipas kësaj Kontrate i kalojnë Kontraktorit në Pikën përkatëse të Lëvrimit;

3.7 Kontraktori ka të drejtë të përdorë tokën brenda Zonës e Kontratës për të kryer Operacionet Hidrokarbure, përfshirë ndërtimin e objekteve ose magazinimin e Hidorkarbureve, në të gjitha rastet duke respektuar ligjet shqiptare.

4 PERIUDHA E KËRKIMIT, PLANI I PUNËS DHE SHPENZIMET E PRITSHME

4.1 Brenda tre (3) muajsh pas datës së Datës së Hyrjes në Fuqi, Kontraktori duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për fillimin e zbatimit të Planit minimal të Punës si më poshtë, i cili mbulon atë përiudhë kohe të quajtur bashkërisht si "Periudhë Kërkimi":

4.1.1 Faza e Parë e Kërkimit (2 Vite nga Data e Hyrjes në Fuqi)

Kontraktori gjatë Fazës së Parë të Kërkimit, për një Detyrim Total prej **$500.000 US (pesëqind mijë dollarë amerikanë)** duhet të zbatojë Planin Minimal të Punës të mëposhtëm:

Plani Minimal i Punës

1. G&G (siç përcaktohet më poshtë)
2. Riprocesimi i 250 KM sizmikë 2D ekzistuese
3. Hartim sizmik i të dhënave të riprocesuara

Puna Gjeologjike dhe Gjeofizike ("**G&G**"): Përvetësimi dhe interpretimi i të dhënave gjeologjike, gjeofizike dhe të puseve në lidhje me Zonën e Kontratës, duke përfshirë studime rajonale gjeologjike dhe strukturore (hartimi, seksionet kryq të balancuara) të përcaktuara nga Kontraktori si të nevojshme për analizën gjeologjike të Zonës se Kontratës sipas Planit të Punës dhe Buxhetit.

Gjatë Fazës së Parë të Kërkimit, përveç përmbushjes së Planit Minimal të Punës të treguar në nenin 4.1.1, Kontraktori mund të zgjedhë të kryejë punë Kërkimi shtesë dukë përfshirë, pa u kufizuar, shpimin e Pusit(eve) Kërkimor/e, përvetësimi dhe përpunimi sizmik, punë gjeologjike në terren dhe studime mekanike shkëmbore, me kusht që puna kërkimore shtesë të miratohet paraprakisht nga Albpetrol dhe AKBN.

4.1.2 Faza e Dytë e Kërkimit (2 Vjet)

Me kusht që të jetë përfunduar Plani Minimal i Punës për Fazën e Parë të Kërkimit ose t'i jetë paguar AKBN-së shuma në USD e barabartë me Detyrimin Total sipas nenin 4.1.1 të kësaj Kontrate minus shumën e Shpenzimeve të Kërkimit të shpenzuar për Planin Minimal të Punës, Kontraktori do të ketë mundësinë të zgjasë Periudhën e Kërkimit me një periudhë shtesë prej Dy (2)vjetësh. Një opsion i tillë mund të ushtrohet nga Kontraktori duke i dhënë AKBN-së, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) Ditë përpara përfundimit të Fazës së Parë të Kërkimit, njoftim me shkrim mbi: (i) Zgjedhjen e tij për të hyrë në Fazën e Dytë të Kërkimit; dhe (ii) Angazhimin e tij për zbatuar gjatë Fazës së Dytë ~~të~~ Kërkimit Planin

Minimal të Punës të mëposhtëm për Detyrimin Total prej **$2.000.000 US (dy milionë dollarë amerikanë)**:

Plani Minimal i Punës

1. G&G (siç përcaktohet më poshtë)
2. Shpimi dhe Testimi i Një Pusi Kërkimor Vertikal deri në thellësinë 2500-3000m

("**G&G**"): Përvetësimi i të dhënave teknike dhe përpunimi dhe interpretimi i të dhënave gjeologjike, gjeofizike dhe të puseve në lidhje me Zonën e Kontratës, duke përfshirë studime rajonale gjeologjike dhe strukturore (hartimi, seksionet kryq të balancuara) të përcaktuara nga Kontraktori si të nevojshme për analizën gjeologjike të Zonës së Kontratës sipas Planit të Punës dhe Buxhetit.

Pus Kërkimor: Fillimi i shpimit të një Pusi Kërkimor të ndodhur në Zonën e Kontratës dhe kryerja e operacioneve të shpimit në përpjekje për të testuar formacionet e përcaktuara nga Kontraktori të cilat, sipas gjykimit të tij, janë të afta të rezultojnë në një Zbulim Tregtar.

Gjatë Fazës së Dytë të Kërkimit, përveç plotësimit të Planit Minimal të Punës të parashikuar në këtë nen, Kontraktori mund të zgjedhë të kryejë punë kërkimore shtesë dukë përfshirë, pa kufizim, shpimin e Pusit(eve) Kërkimor/e shtesë, përvetësimi dhe përpunimi sizmik, punë gjeologjike në terren dhe studime mekanike shkëmbore, me kusht që puna kërkimore shtesë të miratohet paraprakisht nga Albpetrol dhe AKBN.

4.1.3 Faza e Tretë e Kërkimit (2 Vjet)

Me kusht që të jetë përfunduar Plani Minimal i Punës për Fazën e Dytë të Kërkimit ose t'i jetë paguar AKBN-së shuma në USD e barabartë me Detyrimin Total sipas nenin 4.1.2 të kësaj Kontrate minus shumën e Shpenzimeve të Kërkimit të kryera për Planin Minimal të Punës së Fazës së Dytë të Kërkimit, Kontraktori do të ketë mundësinë të zgjasë Periudhën e Kërkimit me një Periudhë shtesë prej Dy Vjet. Një opsion i tillë mund të ushtrohet nga Kontraktori duke i dhënë Albpetrolit, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) Ditë përpara përfundimit të Fazës së Dytë të Kërkimit, njoftim me shkrim mbi: (i) Zgjedhjen e tij për të hyrë në Fazën e Tretë të Kërkimit; dhe (ii) Angazhimin e tij për zbatuar gjatë Fazës së Tretë të Kërkimit Planin Minimal të Punës vijuese per Detyrimin Total prej **$2.000.000 US (dy milionë dollarë amerikanë)**:

Plani minimal i Punës

1. G&G (siç përshkruhet me poshtë)

2. Vlerësimi i të dhënave të testimit

3. Shpimi i Një Pusi Eksplorimi Vertikal deri në thellësinë 2500m

"**G&G**": Përvetësimi i të dhënave teknike dhe përpunimi dhe interpretimi i të dhënave gjeologjike, gjeofizike dhe të puseve në lidhje me Zonën e Kontratës, duke përfshirë analizat e të dhënave të përftuara nga Pusi i parë Kërkimor dhe nga çdo Pus(e) Kërkimor ose çdo Pus(e) Vlerësues pasues i shpuar në Zonën e Kontratës, si edhe çdo studim rajonale gjeologjike dhe strukturor (hartimi, seksionet kryq të balancuara).

Pus Kërkimor: Fillimi i shpimit të një Pusi Kërkimi brenda në Zonën e Kontratës dhe kryerja e operacioneve të shpimit në përpjekje për të testuar formacionet e synuara për Pusin Kërkimor fillestar apo formacione të tjera përcaktuara nga Kontraktori të cilat, sipas gjykimit të tij, të afta për të pasur një Zbulim Tregtar.

Gjatë Fazës së Tretë të Kërkimit, përveç plotësimit të Planit Minimal të Punës të treguar në këtë nen, Kontraktori mund të zgjedhë të ndërmarrë punë kërkimore shtesë dukë përfshirë, pa u limituar në, shpimin e Pusit(eve) Kërkimor/e shtesë, përvetësimi dhe përpunimi sizmik, punë gjeologjike në terren dhe studime mekanike shkëmbore, me kusht që puna kërkimore shtesë të miratohet paraprakisht nga Albpetrol dhe AKBN.

4.1.4 Nëse Kontraktori nuk përmbush në kohë:

4.1.4.1 përpunimin e të dhënave sizmike ekzistuese siç kërkohet nga neni 4.1.1, atëherë Kontraktori duhet t'i paguajë AKBN një shumë prej dymijë dollarësh amerikanë ($2000) për çdo kilometër për çdo kilometër sizmikë 2D të papërpunuar nga të dhënat egzistuese (për shmangie dyshimi, deri në një maksimum prej 250km), nëse ka, dhe rrjedhimisht do të konsiderohet i shkarkuar nga detyrimi i realizimit dhe/ose ripërpunimit të të dhënave sizmike të sipërpërmendura, sipas rastit.

4.1.4.2 Fillimin e shpimit të një Pusi Kërkimor të detyrueshëm, ose pas fillimit të shpimit të një Pusi Kërkimor të detyrueshëm, Kontraktori braktis Pusin Kërkimor përpara se të realizojë Shpenzimet Minimale për atë Pus Kërkimor, atëherë Kontraktori duhet t'i paguajë AKBN Shpenzimet Minimale në rastin kur nuk realizon fillimin e shpimit, ose pjesën e mbetur të Shpenzimeve minimale në rastin kur braktis Pusin Kërkimor, dhe në secilin nga këto raste, shkarkohet nga detyrime të tjera. Megjithatë, një Pus Kërkimor i detyrueshëm do të quhet i përfunduar nëse:

4.1.4.2.1 vazhdimi i shpimit të Pusit Kërkimor përkatës përbën një rrezik për shkak të rrethanave të paparashikuara;

4.1.4.2.2 shfaqen probleme teknike të pakapërcyeshme që e bëjnë të parealizueshëm vazhdimin e shpimit me pajisjet standarte; ose

4.1.4.2.3 shfaqen formacione Hidrokarbure për penetrimin e të cilave kërkohet vendosje e kezingut mbrojtës që nuk lejon arritjen e thellësisë së detyrueshme.

4.2 Kontraktori ka të drejtën të rikuperojë çdo Shpenzim që përmbush Planin e Punës si Shpenzime Kërkimi në mënyrën e përcaktuar në nenin 7.

Periudha e Vlerësimit fillon pas miratimit të Programit të Vlerësimit të dorëzuar nga Kontraktori në përputhje me Nenin 6 të kësaj Kontrate dhe vazhdon për njëzet e katër (24) Muaj të njëpasnjëshëm. Në bazë të një kërkese me shkrim dhe me miratimin e AKBN-së, Periudha e Vlerësimit zgjatet për një periudhë shtesë prej gjashtë (6) Muajsh. Një kërkesë e tillë me shkrim duhet të dorëzohetnga Kontraktori të paktën dyzetë e pesë (45) ditë para përfundimit të Periudhës së Vlerësimit. Periudha për të kryer Planin e Vlerësimit mund të zgjatet nga Kontraktori nëse kërkohet sipas aspektit operacional dhe nëse justifikohet në mënyrë të arsyeshme nga një Program Vlerësimi i ndryshuar.

4.3 Nëse Kontraktori, në përputhje me nenin 4.1.2 ose 4.1.3 vendos të mos hyjë në asnjë Fazë të Dytë Kërkimi ose Fazë të Tretë Kërkimi, Kontraktori do të shkarkohet nga çdo detyrim punimi apo shpenzimi në lidhje me secilën nga këto periudha të pafilluara, por Kontraktori do të ketë të drejtën të vazhdojë me kryerjen e shpimit të një Pusi Vlerësimi sipas nenit 6.3 për të përcaktuar potencialin e Zbulimit Tregtar të ardhur nga një Pus Kërkimor i shpuar gjatë Periudhës së Kërkimit.

Kontraktori do të ketë një periudhë prej njëzet e katër (24) Muajsh të njëpasnjëshëm për të përcaktuar nëse Pusi i Vlerësimit ka rëzultuar me Zbulim Tregtar apo jo. Në bazë të një kërkese me shkrim dhe me miratimin e AKBN-së, kjo periudhë do të zgjatet për një periudhë shtesë prej gjashtë (6) Muajsh, me kusht që Kontraktori të ketë dërguar një kërkesë me shkrim të paktën dyzetë e pesë (45) ditë para përfundimit të periudhës fillestare.

Nëse gjatë Periudhës së Vlerësimit Kontraktori përcakton se është bërë një Zbulim në Pusin e Vlerësimit, Kontraktori mund të procedojë në përputhje me nenin 6.4. Nëse Kontraktori depoziton një Plan Zhvillimi sipas nenit 6.4(a), Periudha e Vlerësimit konsiderohet e zgjatur deri në më të hershmen mes:

4.3.1 refuzimin përfundimtar të Planit të Zhvillimit nga AKBN dhe vendimin e Kontraktorit për të mos vazhduar me zbatimin e nenit 6.4.2;ose

4.3.2 fillimin e Periudhës së Zhvillimit dhe Prodhimit sipas nenit 6.5.

4.4 Të gjitha puset e punuara nga Kontraktori sipas këtij neni 4 do të planifikohen për të arritur në mirëbesim objektivat dhe do të shpohen në mënyrë profesionale, në përputhje me Praktikat e Mira Nderkombëtare të Industrisë Hidorkarbure.

4.5 Programi i Punës dhe Buxheti vjetor

Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, të paktën tre (3) Muaj përpara fillimit të çdo Viti Kontraktor, për vitin e parë një (1) muaj pas Datës se Hyrjes në Fuqi , Kontraktori duhet të depozitojë pranë Albpetrol një Plan Pune Kërkimi dhe Buxheti, të detajuar në tre-mujorë, për Zonën e Kontratës që tregon Operacionet Hidrokarbure që Kontraktori planifikon të kryejë gjatë Vitit të ardhshëm Kontraktor. Programi i Punës dhe Buxheti vjetor duhet të përputhet minimalisht me Planin Minimal të Punës. Programi i Punës dhe Buxheti vjetor konsiderohet i miratuar kur është miratuar si nga Komiteti Këshillimor dhe nga AKBN, siç përcaktohet në këtë Kontratë.

Çdo Program Pune dhe Buxhet vjetor do të detajohet në nivel operacionesh kërkimi, nëse është rasti, Vlerësimi, në bazë të Zonës së Vlerësimit dhe operacione Zhvillimi dhe Prodhimi në Zonën e Kontratës. Programi vjetor i Punës dhe Buxheti duhet të jenë të shoqëruara me një plan të detajuar dhe buxhetor emergjence në rast emergjencash lidhur me dëmtime mjedisore.

Albpetroli brenda tridhjetë (30) ditësh pas marrjes së Planit të Punës dhe Buxhetit, mund të kërkojë sqarime ose propozojë amendime për t'u trajtuar në mbledhjen e Komitetit Këshillimor, në të cilin palët duhet të përpiqen me mirëkuptim të vendosin për formën përfundimtarë të Planit të Punës dhe Buxhetit. Në rasin kur Palët nuk arrijnë një marrëveshje në lidhje me modifikimet dhe amendimet e propozuara nga Albpetroli përpara përfundimit të vitit kalendarik kur Programi Vjetor i Punës dhe Buxheti u paraqitën, Kontraktori do të lejohet të procedojë sipas Planit vjetor të Punës dhe Buxhetit të propozuar prej tij qe minimalisht plotëson kompletimin e Detyrimeve Minimale të Punës të specifikuara në Nenin 4 dhe/ose të garantoje operacione të sigurta.

Nga ana e Albpetroli dhe Kontraktorit pranohet fakti që të dhenat e marra nga punët në proces ose disa ndryshime të rrethanave mund të justifikojnë modifikime të Planit vjetor të Punës, në përputhje me Praktikat më të Mira Ndërkombëtare. Në çdo rast, shpenzimet e nevojshme për qëlim të këtyre modifikimeve nuk duhet të kalojnë Buxhetin vjetor të miratuar me më shumë se pesë përqind (5%), apo dhjetë përqind (10%) të buxhetit të alokuar në Buxhetin Vjetor fillestar, për çdo njësi buxheti, pa marre më parë miratimin më shkrim të Albpetrolit, miratim ky që nuk do të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme. Ky miratim do të jepet jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita që këto modifikime paraqiten për miratim.

Në raste emergjencash, Kontraktori mund të kryejë shpenzime të nevojshme për sigurinë e operacioneve hidrokarbure, pa miratimin paraprak, të Albpetrolit.

Kontraktori duhet t'i raportojë këto shpenzime sa më shpejt të jetë e mundur. Përveç rasteve kur emergjenca është shkaktuar nga një Neglizhence e Madhe apo Veprime të Qëllimshme nga ana e Kontraktorit, këto shpenzime duhet të miratohen nga Albpetroli dhe duhet të futen menjëherë në Buxhetin e miratuar, ose Albpetroli do të percaktojë pjesën e shpenzimeve shtesë që nuk janë kosto e rekuperueshme.

4.6 Komiteti Këshillimor

4.6.1 Plani i Punës dhe Buxheti dhe çdo Plan Zhvillimi do të shqyrtohen nga një komitet i përbashkët i cili do të krijohet nga Albpetroli dhe Kontraktori brenda tridhjetë (30) ditëve nga Data e Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate. Ky komitet, i cili në vijim do të quhet "**Komiteti Këshillimor**", do të përbëhet nga gjashtë (6) anëtarë, tre (3) prej të cilëve emërohen nga AKBN dhe tre (3) nga Kontraktori. Secila nga Palët ka të drejtë të ndryshojë secilin nga anëtarët e tij të Komitetit Këshillues të Kërkimit duke njoftuar palën tjetër. Kryetari i Komitetit Këshillimor do të zgjidhet nga Albpetrol ndërmjet anëtarëve të zgjedhur nga ajo brenda tridhjetë (30) ditëve nga Data e Hyrjes në Fuqi. Për sa i përket mbledhjeve të Komitetit Këshillimor, Kontraktori do të ketë këto detyra:

4.6.1.1 përgatitja dhe shpërndarja në kohë e rendit të ditës;

4.6.1.2 organizimi i mbledhjes; dhe

4.6.1.3 përgatitja e procesverbaleve apo regjistrimeve me shkrim për çdo mbledhje.

Komitetit Këshillimor ngrihet brenda tridhjetë (30) ditësh nga Data e Hyrjes në Fuqi. Komiteti Këshillimor mblidhet të paktën dy herë në çdo Vit Kalendarik në Tiranë, Shqipëri, ose diku tjetër sipas vendimit të Komitetit Këshillues të Kërkimit, dhe do të mblidhet çdo herë tjetër që është e nevojshme për të shqyrtuar dhe dhënë çdo miratim sipas kësaj Kontrate të kërkuar nga Kontraktori përgjatë çdo periudhe ndërmjet mbledhjeve të zakonshme të planifikuara. Kontraktori duhet të njoftojë për çdo mbledhje të paktën pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara mbledhjes. Çdo njoftim duhet të përmbajë:

4.6.1.4.1 datën, orën dhe vendin e mbledhjes;

4.6.1.4.2 një rend dite të çështjeve dhe propozimeve që do të shqyrtohen dhe/ose votohen; dhe

4.6.1.6.3 kopje të të gjithë planeve që do të shqyrtohen në mbledhje (duke përfshirë të gjithë informacionin mbështetës përkatës që nuk i është shpërndarë më parë Palëve).

Mbledhjet mund të zhvillohen me anë të telefonit dhe Komiteti Këshillimor mund të heqë dorë nga çdo mbledhje dhe të japë çdo miratim që kërkohet sipas kësaj Kontrate, me anë të një procesverbali qarkullues që nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komitetit Këshillues të Kërkimit. Prania e të paktën dy (2) anëtarëve nga secila Palë formon kuorumin e Komitetit Këshillimor për qëllim të çdo mbledhje; megjithatë, nëse njëra nga Palët nuk siguron mjaftueshëm përfaqësues për të formuar kuromin në mbledhjen e tretë rradhazi pa një shkak të shkruar të arsyeshëm, kjo Palë konsiderohet që ka miratuar çdo akt që i është paraqitur Komitetit Këshillimor në këtë mbledhje lidhur me njoftimin rregullisht të kryer për mbledhjen.

4.6.2 Pa cënuar të drejtat dhe detyrimet e Kontraktorit në lidhje më drejtimin e operacioneve, Komiteti Këshillimor, sipas kësaj Kontrate, do të ketë funksionet dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

4.6.1.1 të sigurojë mundësinë dhe të nxisë shkëmbimin e informacionit, pikëpamjeve, ideve dhe sugjerimeve në lidhje me Planin e Punës dhe Buxhetin(et) dhe përfundimet e Kërkimit, dhe të shqyrtojë dhe miratojë Planin e Punës dhe Buxhetin;

4.6.1.2 të shqyrtojë dhe aprovojë Planet e Zhvillimit të depozituara nga Kontraktori për Zhvillimin e Zbulimeve dhe t'i paraqesë ato për miratim në AKBN;

4.6.1.3 të shqyrtojë dhe miratojë Planet e Braktisjes dhe çështjet që lidhen me to sipas nenit 23.5 dhe t'i paraqesë ato për miratim në AKBN;

4.6.1.4 të monitorojë Operacionet Hidrokarbure sipas raporteve që Komiteti Këshillimor do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme; dhe

4.6.1.5 të nxisë bashkëpunimin ndërmjet Albpetrolit dhe Kontaktorit me qëllim zbatimin e kësaj Kontrate në përputhje me kushtet e saj.

4.6.1.6 të shqyrtojë dhe t'i bëjë rekomandime Kontraktorit në lidhje me dorëzimin e ndonjë pjese brenda Zonës së Kontratës

4.6.1.7 përcaktimin e çdo Zbulimi si Zbulim Tregtar, duke marrë parasysh që deklarimi si tregtar (komercial) i zbulimit mbetet diskrecion i vetë Kontraktorit vetëm

4.6.2.7 të vendosë gjithë termat e referencës që duhen përgatitur dhe rënë dakord për qëllim të caktimit të ekspertit, sipas Nenit 21.8.

Kontraktori është përgjegjës për të marrë masat e nevojshme për zhvillimin e mbledhjeve të Komitetit Këshillimor. Kostot e

arsyeshme dhe të nevojshme për të zhvilluar mbledhjet e Komitetit Këshillimor (duke përfshirë, pa u kufizuar në, kostot e arsyeshme dhe të nevojshme për përfaqësuesit e autorizuar të Albpetrolit dhe Kontraktorit që marrin pjesë në mbledhje) i ngarkohen dhe paguhen nga Kontraktori si Shpenzime të rikuperueshme, Kërkimi apo Zhvillimi, sipas kësaj Kontrate.

4.6.2 Çdo akt i Komitetit Këshillimor do të konsiderohet i miratuar kur merret pëlqimi unanim i anëtarëve të pranishëm dhe votues të kuorumit të Komitetit Këshillues të Kërkimit. Nëse një Plan Zhvillimi i depozituar nga Kontraktori nuk merr pëlqim unanim, Kontraktori duhet që brenda tridhjetë (30) ditëve të dorëzojë një Plan Zhvillimi të rishikuar, i cili përmban kundërshtimet e arsyeshme të bëra nga Pala mos-miratuese, dhe në një rast të tillë, të gjitha afatet e përcaktuara nga kjo Kontratë do të konsiderohen të zgjatura përkatësisht. Nëse Plani i Zhvillimit nuk miratohet nga Komitetit Këshillimor brenda pesë (5) ditësh nga dorëzimi i tij pranë Komitetit Këshillimor, atëherë çdo mospërputhje në qëndimin e Palëve në lidhje me këtë Plan Zhvillimi mund t'i paraqitet një Eksperti për një mendim jo të detyrueshëm, dhe në një rast të tillë, të gjitha afatet e përcaktuara nga kjo Kontratë do të konsiderohen të zgjatura përkatësisht dhe në mungesë të çdo lloj marrëveshje tjetër të arritur nga Komiteti Këshillimor mbi bazën e mendimit jo detyrues të Ekspertit ose të Palëve më pas, Plani i Zhvillimit i rishikuar i Kontraktorit do të konsiderohet i miratuar siç është paraqitur nga Kontraktori brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga lëshimi i mendimit jo detyrues të Ekspertit, nëse i paraqitet Ekspertit, ose brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dorëzimi i tij pranë Komitetit Këshillues të Kërkimit.

4.7 Më tej, biet dakort se:

4.7.1 Plani minimal i Punës dhe Shpenzimet minimale të caktuara në nenin 4.1 do të konsiderohen të ndryshuara nga çdo Plan Pune dhe Buxheti të miratuar. Kontraktori duhet të kryejë Kërkimet në përputhje thelbësore me Planin e Punës dhe Buxhetit të miratuar. Kontraktori mund të rishikojë apo ndryshojë Planin e Punës dhe Buxhetin në fjalë sikurse mund të kërkohet për arsye operacionale ose si pasojë e veprimeve të Kërkimit. Këto rishikime dhe ndryshime të Planit të Punës dhe Buxhetit janë objekt i procedurave të vendosura në këtë nen 4 për aq sa ato pasqyrojnë ndryshime materiale të cilat për qëllime të kësaj Kontrate mendohet se do të kërkojnë Shpenzime Kërkimore që tejkalojnë në masën dhjetë për qind (10%) shpenzimet e rëna dakort në Planin e Punës dhe Buxhetin e miratuar.

4.7.2 Sipas gjykimit të Kontraktorit, në rast të emergjencave të tilla si rreziku apo mundësia potenciale për plagosje apo humbje të jetëve ose kërcënim për dëmtime të konsiderueshme të pronës apo mjedisit, Kontraktori

mund të përdorë këto shuma shtesë të pabuxhetuara, sikurse mund të nevojitet sipas gjykimit të tij për të lehtësuar këtë rrezik dhe duhet të njoftojë menjëherë AKBN dhe Albpetrolin mbi këto rrethana. Këto shpenzime objekt miratimi nga Albpetroli në përputhje me nenin 4.8 (i cili nuk do të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme), do të konsiderohen Shpenzime Kërkimi dhe janë të rikuperueshme sipas nenit 7.

4.8 Kontraktori duhet t'i dorëzojë Albpetrol, sa më shpejtë të jetë e mundur por jo më vonë se dyzet e pesë (45) Ditë nga përfundimi i çdo Tremujori, një Deklaratë të Aktivitetit të Kërkimit, e cila tregon Shpenzimet e Kërkimit të kryera dhe të ndeshura nga Kontraktori gjatë këtij Tremujori. Të dhënat e Kontraktorit dhe dokumentat shoqëruese duhet të jenë të gatshme për inspektim nga Albpetroli në çdo kohë në zyrën e Kontraktorit në Shqipëri gjatë orareve të zakonshme të punës për njëzet e katër (24) Muaj nga data e marrjes së çdo deklarate për të llogaritur kostot e rikuperueshme në fuksion të faktorit "R" dhe tatim fitimit.

Brenda tre (3) muajve nga data e marrjes së kësaj Deklarate, Albpetroli mund të këshillojë Kontraktorin, me shkrim, duke shoqëruar edhe me arsyetimin përkatës, nëse gjykon se:

4.8.1 në aspektin material, të dhënat e kostove janë të pasakta;

4.8.2 kostot e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve nuk janë materialisht në përputhje me çmimet ndërkombëtare të mallrave dhe shërbimeve të cilësisë së ngjashme, të gatshme për furnizimim sipas kushteve të zbatueshme në kohën kur është kryer porosia;

4.8.3 gjendja e materialeve me të cilat është pajisur Kontraktori nuk përputhen materialisht me çmimet e tyre.

Çdo kundërshtim i bërë nga Albpetroli mbi kostot e treguara në Deklaratën e Aktivitetit të Kërkimit duhet bërë në përputhje me standardet gjerësisht të pranuara kontabile të aplikueshme ndaj operacioneve ndërkombëtare hidrokarbure.

4.9 Kontraktori duhet të këshillohet me Albpetrolin në lidhje me kundërshtimet e bëra sipas nenit 4.8, dhe Palët duhet të përpiqen të arrijnë një marrëveshje pajtimi, reciprokisht të kënaqshme, me kusht që Komiteti Këshillimor të bëjë përpjekje për të përfshirë, sipas gjykimit, kundërshtime të arsyeshme nga ana tregtare që ngrihen nga Albpetrol në përputhje me Praktikat e Mira të Industrisë Ndërkombëtare të Hidrokarbureve. Nëse, brenda një periudhe njëzet e katër (24) Mujore të treguar në nenin 4.8 më lart, Albpetroi nuk kundërshton asnjë pjesë të deklaratës, kjo deklaratë konsiderohet e miratuar. Çdo pjesë e cila nuk kundërshtohet brenda afatit në fjalë njëzet e katër (24) mujor, do të konsiderohet e miratuar.

4.10 Në ose sa më shpejt pas Datës së Hyrjes në Fuqi, (dhe në çdo rast jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga kjo datë) AKBN dhe Albpetrol duhet të vendosë falas në

dispozicion të Kontraktorit kopje të të dhënave sizmike dhe të dhëna të tjera kërkimore që zotëron AKBN dhe Albpetroli në lidhje me Zonën e Kontratës, me përjashtim te kostove të mbledhjes, përgatitjes dhe perpunimit dhe, më pas duhet, herë pas herë, t'i sigurojë Kontraktorit të dhëna të tjera të ngjashme, kur dhe sapo të përftohen nga AKBN dhe Albpetroli. Këto të dhëna nuk mund te shpërndahen nga Kontraktori pervecse në përputhje me nenin 15, *mutatis mutandis.*

- Kostot për të cilat Albpetroli ka bërë përjashtimin sipas paragrafit 4.8 ("**Kostot e Pezulluara**") do të përfshihen në Deklaratën për Kostot e Rikuperueshme dhe do të jenë të rikuperueshme, deri në zgjidhjen e mosmarrëveshjes me pajtim ose derisa çështja të zgjidhet sipas procedurave të arbitrazhit përcaktuar në nenin 21 të kësaj Kontrate.

- Kostot e Pezulluara për të cilat Albpetroli dhe Kontraktori bien dakort (ose përcaktohen nga arbitrazhi sipas nenit 21 të kësaj Kontrate) do të përjashtohen përkatësisht nga rikuperimi sipas kësaj Kontrate ("**Kostot e Refuzuara**") do t'i ngarkohen dhe do të paguhen tërësisht nga Kontraktori dhe nuk do të jenë kosto të rikuperueshme.

- Çdo detyrim ndaj Albpetroli përtej Hidrokarbure per Mbulim Kostoje të ardhura si rezultat i një vendimi arbitrazhi ose marrëveshje pajtimi pas kontrollit, duhet t'i paguhet Albpetrolit në para brenda tridhjetë (30) Ditësh nga data e vendimit apo marrëveshjes së pajtimit.

- Kontraktori duhet të paguajë interes LIBOR +5% për çdo shumë të detyrueshme gjatë periudhës së vonesës.

- E njëjta procedurë sic përshkruhet në Nenin 4.8, 4.9 dhe 4.10 të kësaj Kontrate, do të zbatohet edhe në lidhje me të gjithë dhe secilin prej Deklaratave të Aktivitetit të Zhvillimit të dorëzuara nga Kontraktori në përputhje me Nenin 6.13 të kësaj Kontrate.

4.11 Operatori

4.11.1 Kontraktori zgjedh një nga subjektet, duke perfshire edhe Kontraktorin, të veprojë si Operator i cili do të kryejë Operacionet Hidrokarbure në Zonën e Kontratës në përputhje me afatet dhe kushtet e kësaj Kontrate, me legjislacionin shqiptar dhe praktikat e mira ndërkombëtare hidrokarbure.

4.11.2 Emërimi i një Operatori pasardhës miratohet paraprakisht nga Albpetrol kur ky miratim është i detyrueshëm dhe nëse Operatori pasues është një Shoqëri e Lidhur, atëherë Albpetroli njoftohet vetëm me shkrim; ndersa miratimi nga AKBN i një Operatori pasardhës i cili nuk është Shoqëri e Lidhur, nuk do të refuzohet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme dhe do të jepet nëse, sipas mendimit të Kontraktorit, ky Operator pasardhës ka eksperiencë në kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure të llojit të parashikuar nga kjo Kontratë

4.11.3 Pennine Petroleum Corporation emërohet si Operator që nga Data e Hyrjes në Fuqi.

5 DORËHEQJA

5.1 Dorëheqja e Detyrueshme:

5.1.1 Nëse Kontraktori hyn në Fazën e Dytë të Kërkimit, ose në Fazën e Tretë të Kërkimit, atëherë brenda njëqind e tetëdhjetë (180) ditësh pas përfundimit të Periudhës paraardhëse të Kërkimit, Kontraktori duhet të heqë dorë nga dhjetë përqind(10%) e Zonës se Kontratës minus çdo sipërfaqe të dorëhequr më parë, në favor të Albpetrolit, sipas Paragrafit 5.1.1.2 të kësaj Kontrate.

5.1.1.1 Në përfundim të gjithë Periudhës së Kërkimit, Kontraktori duhet të heqë dorë në favor të Albpetrolit nga të gjithë sipërfaqet e mbetura të Zonës se Kontratës që nuk janë objekt i një Zone Zbulimi ose Zone Zhvillimi dhe Prodhimi.

5.1.1.2 Pavarësisht nga çdo dispozite tjetër e kësaj Kontrate, Kontraktori nuk do të jetë i detyuar të heqë dorë nga asnjë zonë që përfshihet në një Zonë Zbulimi ose Zonë Zhvillimi dhe Prodhimi.

5.2 Kontraktori, me vullnetin e tij, në çdo kohë, mund të heqë dorë tërësisht apo pjesërisht nga Zona e Kontratës, me kusht që në kohën e kësaj dorëheqje të vullnetshme, detyrimet e tij të Kërkimore për periudhën e atëhershme aktuale të jenë plotësuar.

5.3 Çdo dorëheqje e tillë e vullnetshme, sipas gjykimit të Kontraktorit, duhet të zbritet nga dorëheqjet e ardhshme të detyrueshme.

5.4 Zonat prej të cilave hiqet dorë nga Kontraktori sipas nenit 5 i kthehen automatikisht Albpetrolit dhe mund të përdoren dhe disponohen lirisht nga Albpetroli.

5.5 Dimensionet dhe forma e zonave nga të cilat është hequr dorë nga ana e Kontraktorit, do të jenë të tilla që në menyrë të arsyeshme të mundësojnë kryerjen e operacioneve hidrokarbure nga Albpetroli apo Palët e Treta, duke siguruar që kjo nuk do të ndërhyje në operacionet e Kontraktorit sipas kësaj Kontrate.

5.6 Çdo dorëheqje sipas nenit 5 është e lirë nga çdo fitim, transferim ose taksë, detyrim apo tarifë tjetër e çdo lloji.

5.7 Përpara heqjes dorë nga çdo pjesë e Zonës së Kontratës në të cilën janë kryer operacione hidrokarbure, Kontraktori do të ndërmarrë gjithë hapat e nevojshëm për të rregulluar çdo dëm mjedisor të shkaktuar direkt nga operacionet hidrokarbure, deri në masën që përcaktohet nga ligjet shqiptare, dhe ta braktisë Zonën e Kontratës në përputhje me Planin e Braktisjes (Abandonimit) të paraqitur dhe detyrimisht të

miratuar nga Albpetroli dhe AKBN-ja, miratim ky që nuk do të refuzohet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme.

5.8 Në datën kur dorëheqja duhet të kryhet ose hyn në fuqi ose me përfundimin e kësaj Kontrate, Kontraktori nuk do të ketë më asnjë të drejtë apo detyrim në lidhje me zonën prej të cilës hiqet dorë; megjithatë çdo detyrim i Kontraktorit i lindur përpara datave të mësipërme në lidhje me zonën nga e cila hiqet dorë, nuk do të shuhet me kalimin e datës së dorëheqjes ose zgjidhjes së kësaj Kontrate, sipas rastit, derisa Albpetroli dhe AKBN-ja të çlirojë Kontraktorin nga ky detyrim me shkrim, çlirim i cili nuk do të vonohet apo refuzohet në mënyrë të parasyeshme.

5.9 Heqja dorë nuk do ta çlirojë Kontraktorin nga angazhimet minimale të papërmbushura sipas nenit 4 ose çdo detyrimi tjetër të marrë përsipër përpara kësaj dorëheqje lidhur me zonën nga e cila hiqet dorë.

5.10 Pavarësisht sa më sipër, Kontraktori mund të rimarrë ndonjë pjesë të Zonave në të cilat është dorëhequr më parë, gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, duke nënshkruar një marrëveshje të përbashkët me Albpetrolin, e cila është miratuar dhe nga AKBN.

6 OPERACIONET PAS ZBULIMIT

6.1 Brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditësh nga përcaktimi i një Date Zbulimi nga Kontraktori, Kontraktori duhet të njoftojë me shkrim Albpetrollin dhe AKBN-në mbi Zbulimin dhe duhet t'i japë Albpetrolit dhe AKBN rezultatet e testimit. Pas një Zbulimi, Kontraktori mund të prodhojë, transportojë dhe shesë Hidrokarbure në testim, veprime qe mund te kufizohen ne menyre te arsyeshme nga Albpetroli dhe/ose AKBN për të siguar pajtueshmërinë me kontabilitetin dhe dispozitat e tjera të zbatueshme të kësaj Kontrate siç lejohet nga AKBN. Ky prodhim është subjekt i nenit 7.

6.2 Brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas njoftimit të Zbulimit sipas nenit 6.1, Kontraktori duhet të njoftojë më shkrim Albpetrolin dhe AKBN nëse Kontraktori e konsideron Zbulimin të denjë për Vlerësim si Zbulim i mundshëm Tregtar.

6.3 Nëse Kontraktori njofton Albpetrolin dhe AKBN sipas nenit 6.1 që e konsideron Zbulimin të denjë për Vlerësim si Zbulim i mundshëm Tregtar, Kontraktori duhet menjëherë në vijim të njoftojë Albpetrolin dhe AKBN për planet e tij të Vlerësimit lidhur me Zbulimin në fjalë dhe ka të drejtë të ndërmarrë Vlerësimin e Zbulimit duke kryer ato punime që, sipas mendimit të Kontraktorit, janë të nevojshme për të përcaktuar nëse ky Zbulim është i denjë për të qënë një Zbulim Tregtar, duke marrë parasysh të gjithë faktorët teknikë dhe ekonomikë.

6.4 Brenda gjashtë (6) muajsh pas përfundimit të Vlerësimit, që do të thotë përfundimin e shpimit dhe testimit të një Pusi Vlerësimi, nëse shpohet, dhe përfundimin dhe vlerësimin, në gjykimin e Kontraktorit, të të gjitha aktiviteteve të tjera të përshkruara në Planin e Vlerësimit paraqitur Albpetrolit dhe AKBN-së, Kontraktori duhet:

6.4.1 Të dorëzojë pranë Albpetroit dhe AKBN një Plan Zhvillimi me qëllim të deklarimit të një Zbulimi Tregtar; ose

6.4.2 Të njoftojë Albpetroin dhe AKBN që Zbulimi mund të jetë Tregtar nëse Zbulime të tjera kryhen dhe Zhvillohen bashkërisht dhe shfrytëzohen me të, ose që Kontraktori propozon të bëjë punime shtesë në Zonën e Kontratës me këtë qëllim; ose

6.4.3 Të njoftojë Albpetrolin dhe AKBN që Kontraktori nuk e konsideron Zbulimin potencialisht Tregtar.

6.5 Një Plan Zhvillimi të kryer sipas nenit 6.4.1 më lart dhe dorëzuar Albpetrolit dhe AKBN, është objekt miratimi nga AKBN dhe MEI në përputhje me nenin 6.11. Më pas, Kontraktori do të ketë të drejtën të vazhdojë me Zhvillimin e Zbulimit thelbësisht në përputhje me Planin e Punës dhe Buxhetit të miratuar; objekt i miratimeve vjetore të Planeve pasuese të Punës dhe Buxhetit sipas nenit 6.11, dhe kjo Kontratë do të konsiderohet e zgjatur për Periudhën e Zhvillimit dhe Prodhimit për sa i përket Zonës së Zhvillimit dhe Prodhimit të këtij Zbulimi.

Për aq sa Plani i Zhvillimit përmban një parashikim të sasive Hidrokarbure që Kontraktori parashikon të nxjerrë nga ky Zbulim në çdo vit të Periudhës së Zhvillimit dhe Prodhimit në fjalë, ose për shkallën e nxjerrjeve të pritshme, ose parashikime të shpenzimeve vjetore dhe hyrjet nga Shpenzimet Operacionale dhe kapitale, ose vlerësim të kohës së nevojshme për të kryer Planin e Zhvillimit, këto do të trajtohen vetëm si parashikime, dhe nëse këto parashikime nuk dalin të sakta, Kontraktori gjithsesi do të vazhdojë të zhvillojë dhe operojë Zonën e Zhvillimit dhe Prodhimit në përputhje me Planin e Zhvillimit, me përjashtim kur, sipas mendimit të Kontraktorit:

6.5.1 vazhdimi i Zhvillimit dhe Prodhimit paraqet një rrezik për shkak të pranisë së kushteve te paparashikuara; ose

6.5.2 hasen probleme teknike të pakapërcyeshme që e bëjnë jo praktike vazhdimin e Zhvillimi dhe Prodhimit; ose

6.5.3 vazhdimi i Zhvillimit dhe Prodhimit nuk do të ishte me përfitim tregtar.

6.6 Në rastet kur Kontraktori njofton sipas nenit 6.4.2 më lart, Kontraktori duhet të paraqesë para Komitetit Këshillimor dhe te paraqesë tek AKBN për miratim, miratim ky i cili nuk do të vonohet ose refuzohet në mënyrë të paarsyeshme, një plan i cili përmban një përshkrim të punimeve shtesë dhe një programim të punimeve në fjalë që Kontraktori i konsideron të nevojshme në përputhje me Praktikat e Mira të Industrisë Ndërkombëtarë të Hidrokarbureve. Kontraktori ka të drejtën të

ndërmarrë, si pjesë e programit të tij të Kërkimit, kryerjen e punimeve shtesë në fjalë në përputhje me planin dhe programin e paraqitur pranë dhe miratuar nga AKBN, sipas procedurës së treguar në nenin 4.6. Në këtë rast, Periudha e Vlerësimit do të zgjatet deri në njëzet e katër (24) Muaj, të cilët do të jenë të nevojshëm për të përfunduar dhe vlerësuar punimet shtesë, e ku në vijim Kontraktori duhet të njoftojë Albpetrol dhe AKBN sipas nenit 6.4 në lidhje me rezultatet dhe planet për këtë Zbulim. Në bazë të një kërkese më shkrim dhe me miratim të AKBN-së, kjo periudhë do të zgjatet për një periudhë shtesë prej deri gjashtë (6) Muajsh, me kusht që kjo kërkesë me shkrim të dorëzohet nga Kontraktori të paktën dyzetë e pesë (45) ditë para përfundimit të periudhës fillestare.

6.7 Në rastet kur Kontraktori njofton sipas nenit 6.4.3 më lart, Albpetrol do të ketë të drejtën të Zbulojë dhe shfrytëzojë Zbulimin në përfitim të saj dhe me kostot dhe riskun e saj, dhe Kontraktori nuk do të ketë asnjë të drejtë mbi këtë Zbulim dhe duhet të heqë dorë, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Praktikat e Mira të Industrisë Ndërkombëtarë të Hidrokarbureve, nga Zona e Zbulimit; megjithatë nga kjo situatë nuk do të cënohen të drejtat e Kontraktorit mbi pjesën e mbetur të Zonës se Kontratës.

6.8 Çdo Zbulim Tregtar mund të përbëhet nga një rezervuar ose një grup rezervuarësh të cilat, pas Vlerësimit, konsiderohen nga Kontraktori të denja për t'u Zhvilluar komercialisht.

6.9 Brenda tre (3) Muajsh pas dorëzimit në përputhje me nenin 6.4.1 të kësaj Kontrate, Kontraktori duhet të sigurojë për Albpetrolin dhe AKBN një raport mbi faktorët teknikë dhe ekonomikë të marrë parasysh në përcaktimin se Zbulimi është i denjë për t'u Zhvilluar komercialisht.

6.10 Periudha e Zhvillimit dhe Prodhimit është njëzet e pesë (25) Vjet nga e para Datë e Fillimit të Prodhimit Tregtar dhe mund të zgjatet në bazë të Ligjit ekzistues për Hidrokarburet në Datën e Hyrjes në Fuqi, sipas zgjedhjes së Kontraktorit, me periudha shtesë të mëpasshme prej pesë (5) vjetësh secila me të njëjtat kushte të përcaktuara këtu, me miratimin e AKBN, miratim i cili, nuk do të vonohet apo refuzohet në mënyrë të paarsyeshme dhe do të lëshohet nëse Kontraktori demonstron se ky miratim është i nevojshëm në mënyrë të arsyeshme për Prodhimin e Hidrokarbureve të mbetura që mund të nxirren në sasi ekonomike në Zonën e Zhvillimit.

6.11 Në lidhje me Planin e Zhvillimit të paraqitur sipas paragrafit 6.4.1:

6.11.1 Kontraktori duhet të përgatisë një Plan Pune dhe Buxheti për pjesën e mbetur të Vitit Kontraktor të cilin Kontraktori bën dorëzimin sipas nenit 6.4.1 të kësaj Kontrate, dhe duhet t'ia paraqesë për miratim AKBN jo më vonë se nëntëdhjetë (90) Ditë nga data e këtij dorëzimi. Më pas, në ose përpara Ditës së pesëmbëdhjetë (15) të Tetorit të çdo Viti Kontraktor, Kontraktori duhet të përgatisë dhe dorëzojë për miratim pranë Albpetrol

dhe AKBN një Plan Pune dhe Buxheti për Vitin Kontraktor vijues. Cdo Plan Pune dhe Buxhet duhet të jetë thelbësisht në pajtim me dispozitat materiale të Planit të Zhvillimit të miratuar dhe në fuqi në atë kohë. Kontraktori duhet gjithashtu të depozitojë pranë Albpetrol dhe AKBN një program Prodhimi vjetor në bazë të parashikimeve të nenit 7.15.

6.11.2 Kontraktori mund të rishikojë apo ndryshojë një Plan Pune dhe Buxheti të miratuar sikurse mund të nevojitet për shkaqe operacionale ose si rezultat i aktiviteteve të Zhvillimit. Rishikimet e propozuara të një Plani Pune dhe Buxheti janë objekt i procedurës së vendosur nga neni 6.11.1 për aq sa ato pasqyrojnë rishikime monetare, të cilat për qëllime të kësaj Kontrate mendohet se do të kërkojnë Shpenzime Kërkimore që tejkalojnë në masën dhjetë për qind (10%) shpenzimet e rëna dakort në Planin e Punës dhe Buxhetin e miratuar.

6.11.3 Nëse asnjë nga Planet e Punës dhe Buxhetit të paraqitura nga Kontraktori nuk marrin miratim, Kontraktori do të ketë në dispozicion tridhjetë (30) ditë për të dorëzuar një Plan Pune dhe Buxheti të Rishikuar i cili i përmbahet kundërshtimeve të arsyeshme të bëra nga Pala kundërshtuese. Nëse Plani Punës dhe Buxhetit i rishikuar nuk miratohet nga Albpetroli dhe AKBN brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e depozitimit pranë Albpetrolit dhe AKBN, çdo mospajtim ndërmjet Palëve në lidhje me këtë Plan Pune dhe Buxheti mundet, me marrëveshje të Palëve, t'i parashtrohet mendimit të detyrueshëm të një Eksperti.

6.12 Kontraktori regjistron të dhënat që lidhen me sasinë e Prodhimit të Disponueshëm dhe ujit të prodhuar çdo Muaj sipas kësaj Kontrate duke treguar pjesën e Hidrokarbureve Fitim korresponduese për secilën Palë sipas kësaj Kontrate. Këto të dhëna duhet t'i dorëzohen Albpetrolit dhe AKBN dhe autoriteteve fiskale kompetente shqiptare çdo Muaj. Statistika ditore ose javore në lidhje me Prodhimin nga Zona e Kontratës duhet të jenë të gatshme për shqyrtim në çdo moment të arsyeshëm nga përfaqësues të autorizuar të Albpetrolit dhe/ose AKBN.

6.13 Kontraktori duhet t'i dorëzojë Albpetrolit brenda dyzetë e pesë (45) Ditë nga përfundimi i çdo Tremujori, një Deklaratë të Aktivitetit të Zhvillimit, e cila tregon të gjitha detyrimet dhe kreditë lidhur me Zhvillimin dhe Prodhimin për atë Tremujor ("**Shpenzimet e Zhvillimit dhe Shpenzimet Operacionale**"), të përmbledhura me anë të një klasifikimi tregues së natyrës së tyre. Deklarata e Aktivitetit të Zhvillimit është objekt kontrolli nga AKBN, sikurse tregohet në paragrafin 4.2 të Kapitullit 1 të Procedurave të Kontabilitetit.

6.14 Nëse duket e arsyeshme nga të dhënat teknike që një Zonë Zbulimi ose një Zonë Zhvillimi dhe Prodhimi mund të shtrihet përtej Zonës së Kontratës, Palët dhe AKBN duhet të takohen për të diskutuar një bashkëpunim ndërmjet tyre dhe/ose me çdo palë të tretë e cila mund të përfshihet në shtrirjen e Kërkimit, Zhvillimit ose Prodhimit jashtë Zonës së Kontratës, por këto diskutime nuk duhet të ndërhyjnë tek Vlerësimi,

Zhvillimi dhe Prodhimi i Hidrokarbureve nga Kontraktori për pjesën e rezervuarit të ndodhur në Zonën Kontraktore.

AKBN duhet të bëjë përpjekjet më të mira për lehtësuar mbledhjet, diskutimet dhe shkëmbimet e informacionit ndërmjet Kontraktorit dhe këtyre palëve të treta, në mënyrë që të arrihet një marrëveshje në mënyrë që Operacionet Hidrokarbure në Zonën Kontraktore dhe në çdo zonë tjetër jashtë Zonës së Kontratës të kryhen për interesin e përbashkët të të dyja palëve dhe Qeverisë Shqiptare dhe në përputhje me Praktikat e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure.

6.14.1 Në rast se provohet, duke shpuar jashtë Zonës së Kontratës se, shtresat mbajtëse-Hidrokarbure në Zonën Kontraktore shtrihen në një zonë tjetër ose në zona për të cilat një marrëveshje apo licencë është në fuqi ose lëshuar nga autoritetet kompetente shqiptare dhe një palë paraqet një Skemë të Përbashkët Zhvillimi me anë të së cilës e gjithë fusha duhet të punohet dhe zhvillohet si një njësi, Kontraktori duhet të përpiqet të bashkëpunojë me të licensuarin në blloqet ngjitur në mënyrë që të arrihet zgjidhja optimale teknike dhe ekonomike për zhvillimin e të gjithë fushës, dhe AKBN do të sigurojë të gjitha miratimet e nevojshme të arsyeshme për të zbatuar dhe lehtësuar këtë bashkëpunim për zhvillim. Nëse Kontraktori dhe mbajtësi i licencës në lidhje me blloqet ngjitur nuk arrijnë një marrëveshje mbi një Skemë të Përbashkët Zhvillimi apo operacionale, ose nëse AKBN konsideron në mënyrë të arsyeshme Skemën e Përbashkët të Zhvillimit jo në pajtueshmëri me interestat kombëtare sipas Ligjt për Hidrokarburet dhe Praktikat e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure, atëherë asnjë nga palët nuk do të jetë i detyruar kryejë operacionet e parashtruara nga skema e përbashkët e Zhvillimit.

Kontraktori dhe pala e tretë mbajtëse e marrëveshjes apo licencës së lëshuar nga Shqipëria do të bien dakort ndërmjet tyre mbi skemën e përbashkët të Zhvillimit, të cilët bashkërisht duhet të paraqesin skemën për miratim pranë AKBN (miratim ky i cili nuk do të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme). Nëse Kontraktori dhe pala e tretë nuk bien dakort mbi skemën e përbashkët të Zhvillimit, ose nëse ajo nuk miratohet nga AKBN, çështja do t'i parashtrohet një Eksperti i cili do të përgatisë një rekomandim për skemën e përbashkët të Zhvillimit. Një skemë e tillë e rekomanduar nuk do të jetë përfundimtare apo e detyrueshme. Nëse Kontraktori e vlerëson skemën e rekomanduar të përgatitur nga Eksperti të papranueshme, Kontraktori do të ketë të drejtën të kërkojë ndryshime të saj të cilat lejojnë Kontraktorin të zhvillojë Zbulimin brenda Zonës së Kontratës me shtrirje maksimale të mundshme. Çdo mosmarrëveshje mbi skemën e rekomanduar të përgatitur nga Eksperti është subjekt arbitrazhi në përputhje me nenin 21.

6.14.2 Nëse shtresat mbajtëse-Hidrokarbure në Zonën Kontraktore, e cila konsiderohet nga Kontraktori si një Zonë e vetme Zbulimi apo Zonë e

vetme Zhvillimi dhe Prodhimi, shtrihet në një zonë tjetër apo zonë mbi të cilën shtrihet juridiksioni i Qeverisë Shqiptare dhe për të cilat nuk është në fuqi asnjë marrëveshje apo licencë, e kjo zonë nuk është objekt as i lëshimit të ndonjë të drejte nga Shqipëria, atëherë Kontraktori dhe AKBN duhet të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të negociuar një marrëveshje e cila do të zgjerojë përkatësisht Zonën Kontraktore dhe për të siguruar një Vlerësim dhe Zhvillim të duhur të Zbulimit. Kjo marrëveshje duhet të parashikojë që kjo Kontratë zbatohet mbi zonën e zgjeruar e cila do të konsiderohet pjesë e Zonës së Kontratës. Kontraktori duhet të lejohet të kryejë këtë Vlerësim në zonën në fjalë, sikurse mund t'i kërkohet të përcaktojë kufijtë e zgjerimit të Zonës së Kontratës. Përpara fillimit të diskutimeve për këtë marrëveshje, Kontraktori do të lejohet të rishikojë të gjitha të dhënat teknike lidhur me zonën që janë në dispozicion të AKBN.

6.15 Kontraktori mund të përdorë lirisht Hidrokarburet e prodhuara nga Zona e Kontratës për Operacionet Hidrokarbure, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Praktikat e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure.

Nëse Nafta Bruto ose Gazi Natyror i disponueshëm për Albpetroin sipas nenit 7.7 është i pamjaftueshëm për të përmbushur kërkesën e brendshme të Republikës së Shqipërisë, Kontraktori, nëse i kërkohet me shkrim nga Qeveria Shqiptare, është i detyruar t'i shesë Qeverisë Shqiptare nga Pjesa e Kontraktorit një pjesë të prodhimit deri në gjithë Pjesën e Kontraktorit, që nuk është e kontraktuar për shitje, për konsum të brendshëm të Republikës së Shqipërisë. Kontraktori do ta kryejë këtë shitje me terma komercialë dhe me kushte të rëna dakord paraprakisht me shkrim me entin përkatës të autorizuar nga MEI, duke përfshirë çmimin e tregut, i cili do të jetë në përputhje me parimet e përgjithshme të përcaktuara në nenin 7.9 dhe/ose Aneksin D të kësaj Kontrate.

6.16 Gazi Shoqërues i Zonës së Kontratës që nuk përdoret nga Kontraktori për Operacionet Hidrokarbure dhe që nuk është subjekt i nenit 8, mund të ndizet, ri-injektohet apo shitet sipas zgjedhjes se Kontraktorit, vetëm nëse Albpetroli i kërkon Kontraktorit me shkrim t'i dorëzohet Gazi Shoqërues që nuk përdoret nga Kontraktori, tek separatorët e fushës. Kjo dërgesë në favor të Albpetrolit nuk duhet të ndërhyjë me Operacionet Hidrokarbure normale të Kontraktorit dhe të planifikuara për Zhvillimin. Çdo kosto që ndesh Kontraktori për të përmbushur këtë kërkesë të Albpetrolit do të përballohet nga Albpetroli.

7 **RIKUPERIMI I KOSTOVE DHE SHPENZIMEVE, NDARJA E PRODHIMIT DHE HIDROKARBURE FITIM DHE KOSTOT E PARIKUPERUESHME**

Hidrokarbure per Mbulim Kostoje

7.1 Gjithë Prodhimi i Disponueshëm nga Zona e Kontratës do të matet në Pikën e Matjes. Vlera e Prodhimit të Disponueshëm do të alokohet siç përshkruhet në sekuencën dhe proporcionet më poshtë:

7.1.1 dhjetë përqind (10%) e vlerës së Prodhimit të Disponueshëm do t'i paguhen Republikës së Shqipërisë si Rentë Minerare siç parashikohet në nenin 9.1;

7.1.2 Pjesa e Albpetrolit do të paguhet siç parashikohet në nenin 7.7;

7.1.3 vlera e mbetur pas zbritjes nga gjithë Prodhimi i Disponueshëm i Pjesës së Albpetrolit dhe Rentës Minerare, do të nën-ndahet si më poshtë:

i. fillimisht për rikuperimin e Kostove të Rikuperueshme siç parashikohet në nenin 7.2, ku tavani i rikuperimit të kostove do të jetë nëntëdhjetë përqind (90%); dhe

ii. më pas si ndarje e Hidrokarbureve Fitim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kontraktorit siç parashikohet në këtë Kontratë.

7.2 Kontraktori ka të drejtë të rikuperojë Kostot Hidrokarbure nga shitjet e kryera ose nga mënyra të tjera përdorimi të Hidrokarbureve të Disponueshme, në kufijtë e lejuar sipas përcaktimeve të bëra në këtë Nen 7.2.

7.2.1 Për qëllime të rikuperimit të Kostove të tij të Rikuperueshme, Kontraktori mund të përdorë cdo Tremujor Hidrokarbure për Mbulim Kostoje deri në nëntëdhjetë përqind (90%) të Hidrokarbureve të Disponueshme, ose një përqindje më të vogël që do të ishte e nevojshme dhe e mjaftueshme.

Për cdo Tremujor, pjesa e mbetur e të gjithë Kostove të Rikuperueshme deri në dhjetë përqind (10%) të Hidrokarbureve të Disponueshme, do të quhen Hidrokarbure Fitim dhe do të ndahet midis Republikës së Shqipërisë dhe Kontraktorit në përputhje me Nenin 9.2.

7.2.2 Shpenzimet e Eksplorimit, duke përfshirë totalin e kostove të akumuluara përpara Datës së Fillimit të Prodhimit Tregtar (komercial), do të jenë të rekuperueshme, pa amortizim, subjekt i tavanit të kostove sipas Nenit 7.2.1, duke filluar që nga: (i) Muaji Kalendarik në të cilën këto kosto janë kryer, ose (ii) Muaji Kalendarik që ka filluar Prodhimi Tregtar; cilido nga muajt vjen më pas.

7.2.3 Shpenzimet e Zhvillimit, duke përfshirë totalin e kostove të akumuluara përpara Datës së Fillimit të Prodhimit Tregtar (komercial), do të jenë të

rekuperueshme, pa amortizim, subjekt i tavanit të kostove sipas Nenit 7.2.1, duke filluar që nga: (i) Muajin Kalendarik në të cilën këto kosto janë kryer, ose (ii) Muaji Kalendarik që ka filluar Prodhimi Tregtar; cilido nga muajt vjen më pas. Shpenzimet e Zhvillimit do të jenë të arsyeshme, që do të thotë, do të jenë në përputhje me praktikat e industrise së hidrokarbureve dhe me çmimet e tregut për shërbimet, pajisjet dhe materialet e ngjashme dhe me të njëjtën cilesi, që ekzistojnë në momentin e kërkuar, sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.

7.2.4 Shpenzimet Operative, duke përfshirë totalin e kostove të akumuluara përpara Datës së Fillimit të Prodhimit Tregtar (komercial), do të jenë të rekuperueshme, pa amortizim, subjekt i Tavanit të kostove sipas Nenit 7.2.1, duke filluar që nga: (i) Muajin Kalendarik në të cilën këto kosto janë kryer, ose (ii) Muaji Kalendarik që ka filluar Prodhimi Tregtar; cilido nga muajt vjen më pas. Shpenzimet Operative do të jenë të arsyeshme, që do të thotë, do të jenë në përputhje me praktikat e industrise së hidrokarbureve dhe me çmimet e tregut për shërbimet, pajisjet dhe materialet e ngjashme dhe me të njëjtën cilesi, që ekzistojnë në momentin e kërkuar, sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.

7.3 Duke pasur parasysh që, për çdo tremujor, Deklarata e Kostove të Rekuperueshme tregon kosto dhe shpenzime të parekuperuara, këto shuma të parekuperuara do të mbarten për më pas ,pa interes, ne Deklaratën e Kostove të Rekuperueshme të tremujorit/ëve të ardhshem derisa të rekuperohen komplet, ose derisa të mbarojë Kontrata kur kjo ndodh mëe parë, pavarësisht arsyes. Asnje kosto e parekuperueshme nuk do të rekuperohet pas mbarimit të Kontratës.

7.4 Në të njëjtën kohë me Aprovimin e Planit të Zhvillimit, Palët duhet të bien dakord nëse pjesa që i takon Albpetrolit nga Prodhimi i Disponueshëm do të merret në natyrë nga Albpetrol, si Pjesë e Albpetrolit në përputhje me nenin 7.7, apo do të shitet nga Kontraktori në vend të Albpetrolit dhe rrjedhimisht, pas arkëtimeve nga shitjet, do t'i paguhet në para Albpetrolit bazuar në vlerën e Hidrokarbureve sipas nenit 7 dhe ligjeve në fuqi.

7.5 Në rast se Palët bien dakord që Pjesa e Albetrolit do t'i jepet Albpetroit në natyrë, marrëveshja *inter alia* do të përmbajë parashikimet për llojet e ndryshme të Hidrokarbureve dhe procedurat për sasitë e shpërndara Albpetrolit si Pjesë e Albpetrolit, më tepër ose më pak, sipas rastit.

Ndarja e Prodhimit Hidrokarbur – Faktori "R"

7.6 Në çdo Tremujor Kalendarik, i gjitha Prodhimi i Disponueshëm që mbetet pasi zbriten Pjesa e Albpetrolit, Renta Minerare dhe Hidrokarbureve për Mbulim Kostoje (sipas përcaktimit më lart), do të quhen Hidrokarbure Fitim dhe do të ndahen midis Republikës së Shqipërisë dhe Kontraktorit në përputhje me këtë Nen 7.6. Pjesa apo

përqindja përkatëse e Prodhimit të Disponueshëm që secila nga Palët ka të drejtë të marrë gjatë një Muaji Kalendarik, përcaktohet sikurse tregohet në këtë nen.

7.6.1 Faktori "R" përdoret për qëllimin e përcaktimit të së drejtës së secilës Palë përkatësisht mbi Prodhimin e Disponueshëm të çdo Muaji. Faktori "R" do të thotë dhe llogaritet sipas raportit të të ardhurave progresive të Kontraktorit nga Zonat e Zhvillimit dhe Prodhimit brenda Bllokut dhe nga çdo zonë e njësuar që përmban pjesë të këtij Blloku ose nga çdo zonë tjetër që i nënshtrohet një skeme të përbashkët Zhvillimi, prej Vitit të Parë Kontraktor gjatë të cilit të ardhurat janë grumbulluar deri në fund të Vitit paraardhës Kontraktor, përmbi shpenzimeve progresive që Kontraktori ka kryer nga viti i parë në të cilin kryhen shpenzimet deri në fund të Vitit parardhës Kontraktor.

7.6.2 Përcaktuar sipas nenit 7 dhe Aneksin D, të ardhurat e akumuluara do të jenë vlera totale e:

7.6.1 Pjesës së Hidrokarbureve Fitim që i takojnë Kontraktorit; plus

7.6.2 Hidrokarburet për Mbulim Kostoje

Të ardhurat në fjalë rregullohen nga një koeficient inflacioni i bazuar në Indeksin e Çmimeve të Konsumatorit të publikuar nga Departamenti i Punës i Shteteve të Bashkuara (United States Department of Labor) dhe llogaritur në bazë vjetore.

7.6.3 Shpenzimet do të jenë shuma totale e të gjitha kostove, shpenzimeve, taksave të zbritshme dhe shpenzimeve të kryera më parë nga Kontraktori sipas kësaj Kontrate, subjekt i tavanit të kostove në nenin 7.2.1, qoftë si Shpenzime Zhvillimi, Shpenzime Kërkimore ose Shpenzime Operacionale, ose si pagesë e kryer sipas nenit 27, të atribuara Bllokut dhe çdo zone e njësuar që përmban pjesë të këtij Blloku ose nga çdo zonë tjetër që i nënshtrohet një skeme të përbashkët Zhvillimi.

Këto shpenzime rregullohen nga një koeficient inflacioni i bazuar në Indeksin e Çmimeve të Konsumatorit të publikuar nga Departamenti i Punës i Shteteve të Bashkuara (United States Department of Labor) dhe llogaritur në bazë mujore.

7.6.4 Faktori "R" llogaritet si vijon:

$$R_N = \frac{\sum_{i=1}^{N-2}\left[A_i \prod_{j=i+1}^{N-1}(1+z_j)\right] + A_{N-1}}{\sum_{K=1}^{N-2}\left[B_K \prod_{j=K+1}^{N-1}(1+z_j)\right] + B_{N-1}}$$

ku:

N = Viti Kontraktor për të cilin është llogaritur Faktori "R";

i=1 Viti i parë Kontraktor kur janë marrë të ardhurat;

K=1 Viti i parë Kontraktor kur janë kryer shpenzimet;

A_i = të ardhurat e Kontraktorit = sikurse përcaktohen në nenin 7.6.2;

B_k = shpenzimet e Kontraktorit = sikurse përcaktohen në nenin 7.6.3;

ε_j = Koeficienti vjetor i inflacionit për Vitin Kontraktor (j) i shprehur në shifra dhjetore (i rrumbullakosur në tre (3) shifra pas presjes dhjetore) bazuar në "Indeksin e Çmimit të Konsumatorit për të Gjithë Konsumatorët Urbanë) ("All Items", 1982-84 = 100), i publikuar çdo muaj nga US Department of Labor, Bureau of Labor Statistics në "Monthly Labor Revieë". Koeficienti i inflacionit vjetor i zbatueshëm do të llogaritet duke përdorur indeksin e dhjetorit për Vitin Kontraktor përkatës;

Σ do të thotë "shuma";

π do të thotë "shumëzim".

7.6.5 Faktori "R" i aplikuar për Vitin Kalendarik paraardhës, do të aplikohet për Vitin Kontraktor aktual për aq sa indeksi i çmimit të konsumatorit i treguar në paragrafin (iii) më lart nuk ka qënë i publikuar. Sapo publikohet shifra e re për indeksin e çmimeve të konsumatorit për Vitin kontraktor paraardhës, Faktori "R" do të zbatohet që nga muaji i publikimit.

Në rast se indeksi i çmimeve të konsumatorit të treguar në nenin 7.6.4 më lart nuk publikohet më ose metodologjia e llogaritjes së indeksit ndryshohet në mënyrë të ndjeshme, Albpetrol dhe Kontraktori do të bien dakort për një metodë zëvendësuese për llogaritjen e Faktorit R në mënyrë që të ruajnë një ekuilibër ekonomik të kësaj Kontrate siç është rënë dakort nga Palët që nga Data e Hyrjes në Fuqi.

7.6.6 Të gjitha të ardhurat e prodhuara nga Prodhimi i Zonës së Kontratës, ose çdo zone të njehsuar ose Zone të Përbashkët Zhvillimi që përmban këtë Bllok, nuk janë subjekt i tatimit mbi fitimin derisa të gjitha Kostot e Rikuperueshme për të cilat është i legjitimuar Kontraktori të jenë rikuperuar në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.

7.7 Albpetrol ka të drejtën e Pjesës së Albpetroit mbi prodhimin, e cila caktohet në çdo muaj kalendarik duke përdorur faktorin "R" të aplikueshëm për ate vit kalendarik (që llogarited sipas nenit 7.6), e cila do të jetë pjesë e Prodhimit të Disponueshëm dhe sikurse biet dakort me Kontraktorin dhe do të merret në natyrë ose në para të thatë, siç tregohet në tabelën vijuese:

FAKTORI R	Pjesa e Albpetrolit
0<R<1.5	2%
1.5≤R<2.0	5%
2.0≤R<2.5	10%
R≥2.5	15%

Përqindja e Prodhimit të Disponueshëm që i takon Albpetrolit dhe Kontraktorit, përfshin dhe Naftën Bruto dhe Gazin Natyror.

Përveçse në rastet kur parashikohet ndryshe nga kjo Kontratë, Prodhimi Mesatar Ditor nuk do të përcaktohet derisa të gjitha tubacionet, ose pjesët përbërëse, të nevojshme për lëvrimin e Hidrokarbureve si në upstream dhe në doënstream të Pikës së Matjes të jenë të mbushura në presion me sasitë e nevojshme të Hidrokarbureve (**Mbushja e Tubacioneve**). Kontraktori dhe Albpetroli, në kohën e duhur, do të bien dakord me shkrim për shkarkimin e Mbushjes së Tubacioneve dhe përfshirjen e saj në Prodhimi Mesatar Ditor.

7.8 Sipas kësaj Kontrate, shpenzimet e mëposhtme nuk janë të rikuperueshme:

7.8.1 shpenzimet e kryera përpara Datës së Hyrjes në Fuqi që lidhen me kryerjen e një punimi të detyrueshëm, me përjashtim kur miratohen nga AKBN dhe Albpetroli;

7.8.2 përvecse kur merret miratimi i Albpetrol, shpenzimet e kryera përtej Pikës së Lëvrimit;

7.8.3 donacione apo kontribute, me përjashtim kur miratohen nga AKBN dhe Albpetroli;

7.8.4 cdo bonus prodhimi të paguar nga AKBN sipas nenit 27;

7.8.5 gjoba apo sanksione të vendosura rregullisht nga një agjenci e Qeverisë Shqiptare dhe të paguara nga Kontraktori

7.8.6 gjoba apo sanksione të vendosura rregullisht nga një gjykatë Shqiptare apo ndërkombëtare apo arbitrazhi dhe të paguara nga Kontraktori.

7.8.7 shpenzimet e kryera si rezultat i mospërmbushjes nga ana e Kontraktorit të detyrimeve ligjore apo të detyrimeve sipas kësaj Kontrate, duke përfshirë shpenzimet që vijnë si pasojë e ndonjë veprimi apo mosveprimi

neglizhent apo shkelje të qëllimshme nga ana e Kontraktorit, agjentëve apo nënkontraktorëve të tij, duke përfshirë cdo shumë të paguar në procedurë pajtimi për cdo pretendim që ngrihet dhe që referon në një shkelje të qëllishme apo për shkak të neglizhencës, pavarësisht nëse shkelja apo neglizhenca është pranuar apo nëse kjo shumë deklarohet se do të paguhet si ex gratia apo për arsye të tjera të ngjashme;

7.8.8 pagesa për kompensimin e dëmeve sipas kësaj Kontrate;

7.8.9 interesat që Kontraktori detyrohet t'i paguajë një Insitucioni Financiar (apo të ngjashëm me to) në lidhje me një hua nga Institucioni Financiar për qëllime të financimit të Operacioneve Hidrokarbure;

7.8.10 humbjet në operacione të këmbimit valutor në lidhje me huatë apo transaksionet e tjera, qoftë ndërmjet Filialeve apo të ndryshme;

7.8.11 shpenzimet e kryera për të përfituar, furnizuar apo mbajtur garancitë që kërkohen sipas kësaj Kontrate apo cdo shumë tjetër e shpenzuar për efekt të dëmshpërblimeve që lidhen me mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale;

7.8.12 taksat e paguara sipas ligjeve të Kanadasë dhe të gjitha taksat e tjera mbi të ardhurat apo fitimin sipas rastit;

7.8.13 përvecse me miratim të Albpetrol/AKBN, shpenzimet, duke përfshirë këtu donacionet, që lidhen me marrëdhëniet me publikun apo përmirësimin e imazhit dhe interesave të Kontraktorit si korporatë;

7.8.14 shpenzimet që lidhen me zyrat dhe administrimin brenda vendit, duke përfshirë pagesat për personelin, apo cdo shpenzim tjetër i cili, referuar Praktikave më të Mira Ndërkombëtare të Industrisë së Naftës, rezulton të jetë i tepruar;

7.8.15 bonuset e paguara ndaj punonjësve apo drejtuesve;

7.8.16 pagesat e dividentëve apo shpenzimet për emetimin e aksioneve;

7.8.17 përvecse kur merret miratimi i Albpetrol, shpenzimet që nuk parashikohen në Buxhetin e Vitit përkatës; dhe

7.8.18 shpenzime të ndryshme nga ato të përmendura këtu më sipër por që përcaktohen si të parikuperushme diku tjetër në këtë Kontratë, apo shpenzime të kryera pa marrë miratimin e Albpetrol/AKBN (kur është e detyrueshme).

Çmimi i Naftës Bruto

7.9.1. Çmimi i referencës për të gjithë naftën e marrë në natyrë ose të lëvruar nga Kontraktori sipas kësaj Kontrate gjatë çdo muaji kalendarik, për të

gjitha qëllimet e përmendura në këtë Kontratë, do të llogariten në përputhje me parashikimet e Vendimit të KM Nr.947, datë 29.12.2014 "Për autorizimin e "Albpetrol" sh.a. për të marrë, në para, vlerën korresponduese të sasisë së Prodhimit të Gjykuar dhe të Pjesës së "Albpetrol", sh.a., që i takon në bazë të zbatimit të marrëveshjeve hidrokarbure, të lidhura me kontraktorët, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve nga vendburimet ekzistuese të naftës e të gazit" (siç mund të amendohet) dhe Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të MEI dhe Ministrit të Financave, Nr.1, datë 26.05.2015 "Mbi rregullat dhe procedurat e marrjes, në para, të vlerës korresponduese të sasisë së Prodhimit të Gjykuar dhe të Pjesës së Albpetrol, sh.a." (siç mund të amendohet). Në asnjë rast nuk do të zbritet asnjë komision apo tarifë marketingu.

7.9.2. Jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) Ditë përpara Datës së Fillimit të Prodhimit Tregtar dhe, më pas, në fillim të çdo Tremujori Kalendarik, Kontraktori duhet të përgatisë dhe t'i paraqesë AKBN një parashikim të prodhimit i cili do të tregojë sasinë totale të Prodhimit të Disponueshëm që pritet të prodhohet në Zonën e Kontratës gjatë çdo katër (4) Tremujorëve Kalendarikë vijues bazuar mbi normën e prodhimit të dizenjuar për të maksimizuar nxjerrjen totale të Hidrokarbureve (Norma Maksimale e Eficencës) nga Zona E Kontratës në përputhje me praktikat e pranuara gjerësisht në industrinë ndërkombëtare të hidrokarbureve. Kontraktori duhet të marrë në konsideratë çdo koment apo rekomandim të bërë nga përfaqësuesit e AKBN në lidhje me këtë parashikim. Kontraktori do të përpiqet të prodhojë gjatë çdo Tremujori Kalendarik sasinë e parashikuar. Për qëllim qartësimi, Palët deklarojnë se parashikimet nuk janë detyruese për asnjë qëllim dhe se një dështim i Kontraktorit për të prodhuar sipas këtij parashikimi nuk përbën shkelje të Kontratës.

7.9.3 Kontraktori ka të drejtën të marrë veçantë në natyrë dhe të eksportojë të gjithë Hidrokarburet Kosto dhe Hidrokarburin Fitimin për të cilin është i legjitimuar sipas kësaj Kontrate. Kontraktori ka të drejtën të çojë apo të mbajë lirisht jashtë Shqipërisë të gjithë të ardhurat e fituara prej kësaj, duke përfshirë të ardhurat nga shitja e pjesës së Hidrokarburet Kosto dhe Hidrokarbureve Fitim, qofshin këto shitje në Shqipëri ose Hidrokarbure të eksportuara nga Kontraktori.

7.9.4. Në një kohë të arsyeshme përpara Datës së Fillimit të Prodhimit Tregtar, dhe kohe pas kohe siç mund të kërkohet më pas, AKBN dhe Kontraktori duhet të takohen dhe të bien dakort mbi një procedurë për të programuar marrjen e Hidrokarbureve në Pikën e Shpërndarjes. Asnjë Palë nuk duhet të fitojë apo humbasë si rezultat i çdo marrje sipas këtij programi. Marrjet e Kontraktorit do të konsiderohen së pari të përfshijnë të drejtat e plota

që ai ka mbi Hidrokarburet Kosto në mënyrë që rikuperimi i kostove të procedojë në përputhje me këtë Kontratë, dhe pjesa e mbetur e këtyre marrjeve, konsiderohet se përbën Hidrokarbur Fitim.

8 GAZI

8.1 Nëse prodhohet Gaz ose ai bëhet i prodhueshëm për shitje nga Zona e Kontratës, AKBN dhe Kontraktori duhet të marrin parasysh të gjitha alternativat ekonomike të përdorimit të tij dhe të vendosin bashkërisht alternativën më të mirë për AKBN dhe Kontraktorin. Në këtë rast, parashikimet e këtij neni 8, Aneksit D, dhe Ligjit nr. 102/2015, datë 23.09.2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror" i ndryshuar, do të zbatohen për aq sa pajtohen me dispozitat e kësaj Kontrate.

8.2 Nëse Kontraktori bën një Zbulim Gazi, zbatohen procedurat e nenit 6 dhe pasohen nga sa vijon këtu. Nëse bëhet një Zbulim Gazi të cilin Kontraktori e konsideron se mund të jetë një Zbulim Tregtar, dhe nëse, mungon apo ka një papërshtatshmëri të një tregu të disponueshëm ekonomikisht të qëndrueshëm për këto rezerva Gazi, kjo Kontratë do të pezullohet për këtë Zbulim Gazi për një periudhë kohe në të cilën Zhvillimi i rezervave të Gazit nuk ka filluar, me kusht që kjo periudhë të mos tejkalojë tre (3) Vite Kontraktore nga data përkatëse e Zbulimit të Gazit ("**Periudha e Pezullimit të Gazit**"). Gjatë Periudhës së Pezullimit të Gazit për këtë Zbulim, Palët duhet të bëjnë përpjekje të arsyeshme dhe në mirëbesim për të hetuar dhe konsideruar tregje që mund të Zhvillohen komercialisht për këto rezerva Gazi dhe të konsiderojnë ato ndryshime apo veprime për të cilat mund të bien dakort për ta bërë atë Zbulim Tregtar. Gjatë çdo Periudhe Pezullimi të Gazit sipas nenit 8.2, pjesa e Zonës E Kontratës me tiparet gjeologjike që përmban rezervat e Gazit të Zbulimit ("**Zonë Pezullimi Gazi**") do të përcaktohet nga Kontraktori, me miratimin e Albpetrol dhe gjatë Periudhës së Pezullimit të Gazit, Zona e Pezullimit të Gazit nuk do t'i nënshtrohet dorëheqjes së detyrueshme sipas nenit 5, as ndonjë dispozite tjetër të kësaj Kontrate, duke përfshirë pa kufizim, skadimin e Periudhës së Vlerësimit. Menjëherë sapo të fillojë Zhvillimi i Zonës Pezullim Gazi, përfundon Periudha e Pezullimit të Gazit, dhe bëhen të zbatueshme parashikimet përkatëse të nenit 6 dhe nuk do të konsiderohet e filluar Periudha e Zhvillimit dhe Prodhimit deri në fund të Periudhës së Pezullimit të Gazit në lidhje me Zbulimin e zbatueshëm. Është e kuptueshme që në rastin kur Zhvillimi i Zonës Pezullim Gazi nuk ka filluar gjatë Periudhës së Pezullimit të Gazit (siç mund të zgjatet), Kontraktori duhet të heqë dorë nga Zona e Pezullimit të Gazit.

8.3 Çdo Gaz i prodhuar nga prodhimit test është në dispozicion të Kontraktorit në kokën e pusit pa pagesë. Çdo sasi Gazi që nuk merret nga Kontraktori mund të ndizet.

8.4 Gazi i prodhuar nga Zona E Kontratës që nuk shitet ose përdoret për Operacione Hidrokarbure sipas kësaj Kontrate, mund të ndizet nëse përpunimi apo përdorimi i tij nuk është ekonomik dhe nuk është teknikisht dhe ekonomisht praktike që Gazi të ri-injektohet. Ndezja do të lejohet për aq masë sa Gazi nuk kërkohet për efekt të

rikuperimit të Naftës Bruto me anë të operacioneve dytësore të nxjerrjes, dukë përfshirë ripresimin dhe riciklimin.

8.5 Në rastin kur Kontraktori konsideron se përpunimi dhe përdorimi i Gazit nuk është ekonomik, atëherë Albpetrol mund të zgjedhë, me kusht që këto veprime të mos jenë në dëm të Operacioneve Hidrokarbure, të marrë dhe përdorë falas Gazin i cili, ndryshe do të ndizej dhe të gjitha kostot e marrjes dhe dorëzimit janë për llogari dhe në riskun e vetëm të Albpetrol-it.

9 TAKSAT SHQIPTARE

9.1 Kontraktori ka detyrimin të paguajë Rentën Minerare të përcaktuar në Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar.

9.2 Të gjitha subjektet që përbëjnë Kontraktorin sikurse mund të rezultojë gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, janë subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri, në përputhje me ligjin shqiptar.

9.3 Kontraktori do të jetë subjekt i tatimit mbi fitimin në përputhje me Ligjin nr.7811, datë 12.04.1994 "Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (Kërkimi dhe Prodhimi)", i ndryshuar ose ligjeve apo rregulloreve të tjera shqiptare.

9.4 Nëse, do të ndodhte që Renta Minerare referuar në nenin 9.1 ose norma e taksës mbi fitimin të referuar në nenin 9.2 rritet, ose ndryshon metodologjia e llogaritjes së kësaj takse, atëherë Palët do ta amendojnë këtë Kontratë dhe Albpetroli, AKBN-ja dhe MEI do të ndërmarrin menjëherë veprimet e nevojshme në mënyrë që të ruajnë ekuilibrin ekonomik të kësaj Kontrate.

9.5 Nëse gjatë zbatimit të kësaj Kontrate Kontraktori përbëhet nga më shumë se një subjekt, taksa shqiptare mbi fitimin e secilës prej njësitë përbërëse të Kontraktorit të vlerësuara përkundrejt Hidrokarburit Fitim do t'i paguhet në para autoriteteve të Qeverisë Shqiptare, siç do të kështillohet nga AKBN, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme shqiptare dhe procedurës së mëposhtme

9.6 Të paktën njëqind e njëzetë (120) Ditë përpara Datës së Fillimit të Prodhimit Tregtar, AKBN do të njoftojë Kontraktorin me shkrim nëse subjektet që përbëjnë Kontraktorin do të paguajnë tatimin mbi fitimin në natyrë apo në para për pjesën e mbetur të atij Viti Kalendarik. Më pas, AKBN do të njoftojë çdo vit Kontraktorin me shkrim, jo më vonë se 1 Tetori i çdo Viti Kalendarik nëse subjektet që përbëjnë Kontraktorin do të paguajnë taksën shqiptare mbi fitimin për Vitin Kalendarik pasues të menjëhershëm në para. Nëse AKBN nuk njofton Kontraktorin sikurse kërkohet nga dhe në përputhje me kushtet e këtij paragrafi 9.4.1, subjektet që përbëjnë Kontraktorin do të kryejnë pagesën për periudhën përkatëse në para.

9.6.1 Të gjitha subjektet që përbëjnë Kontraktorin duhet të paguajnë në para tatimin mbi fitimin për çdo Vit Kontraktor, brenda gjashtëdhjetë (60) Ditësh nga paraqitja e Deklaratës së Kostove të Rikuperueshme pranë

AKBN për atë Vit Kontraktor, siç kërkohet nga neni 3 i Procedurave të Kontabilitetit.

9.6.2 Albpetrol angazhojë AKBN dhe çdo entitet tjetër qeveritar që të sigurojë që Kontraktori apo subjektet që përbëjnë Kontraktorin të marrin menjëherë faturat zyrtare të taksës nga autoritetet përkatëse shqiptare të cilat tregojnë se tatimi mbi fitimin është paguar nga ata në kohë dhe në asnjë rast këto nuk duhet të merren më vonë se tre (3) muaj nga përfundimi i Vitit përkatës Kontraktor, dhe të sigurojë më tej se AKBN do të dëmshpërblejë dhe sigurojë Kontraktorin nga çdo dëmtim që mund të vijë si rezultat i kësaj.

9.7 Me qëllim përllogaritjen e vlerës monetare të sasisë së Hidrokarbureve që i dërgohen Qeverisë Shqiptare nga Kontraktori për pagimin e tatimit mbi fitimin dhe sasitë e pagesave të taksës mbi fitimin për çdo Vit Kalendarik, sipas rastit, vlera e Naftës Bruto do të jetë çmimi mesatar për Vitin Kalendarik në fjalë i përcaktuar në përputhje me nenin 7.9.

9.8 Kontraktori duhet të zbatojë kërkesat e legjislacionit shqiptar në lidhje me dokumentimin e rimbursimeve dhe mbajtjen për kontroll nga persona të autorizuar të librave të kontabilitetit dhe të regjistrave.

10 ZYRA DHE DHËNIA E NJOFTIMIT

10.1 Kontraktori duhet mbajë një zyrë në Shqipëri në të cilën do të jepen vlefshmërisht njoftimet. Kontraktori duhet të hapë zyrën në Shqipëri brenda gjashtëdhjetë (60) Ditësh nga Data e Hyrjes në Fuqi dhe të njoftojë AKBN për çdo ndryshim të adresës.

10.2 Të gjitha çështjet dhe njoftimet të cilat lihen me shkrim në zyrën e Palës përkatëse ose të cilat merren nga kjo Palë kur dërgohen personalisht, nëpërmjet postës së regjistruar ose me faks në zyrën kryesore të tij në Shqipëri, konsiderohen të dhëna në mënyrë të vlefshme.

11 RUAJTA E HIDROKARBUREVE PARANDALIMI I HUMBJEVE

11.1 Kontraktori duhet të marrë masa, në përputhje me Praktikën e Mirë Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure, për të parandaluar humbjet ose shpërdorimin e Hidrokarbureve mbi ose nën tokë gjatë operacioneve të shpimit, Prodhimit, grumbullimit dhe shpërndarjes apo magazinimit dhe Albpetrol njofton Kontraktorin me shkrim, në mënyrë të arsyeshme të detajuar, se Kontraktori nuk është materialisht në pajtim me këtë dispozitë, më pas Kontraktori do të ketë njëqind e tetëdhjetë (180) Ditë nga marrja e këtij njoftimi nga Albpetrol për të përmirësuar këto praktika dhe për të lehtësuar humbjet që mund të kenë ndodhur, gjithmonë me kushtin që kur Kontraktori nuk është dakort që ndonjë nga këto praktika përbën shpërdorim ose shkelje të Praktikave të Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure, mund t'i paraqesë mosmarrëveshjen arbitrazhit sipas nenit 21. Në

vijim të çdo vendimi, Kontraktori duhet të zbatojë çdo veprim korrigjues që kërkohet brenda një afati kohor të arsyeshëm te paraqitur nga Albpetrol dhe AKBN.

11.2 Pas kompletimit të një pusi prodhues, Kontraktori do të informojë Albpetrolin per kohën kur ky pus është programuar të testohet dhe normën e prodhimit, kur të përcaktohen rezultatet.

12 PËRJASHTIMET DOGANORE

12.1 Çdo njësi materiale, e cila ka qënë rekuperuar si kosto e rekuperueshme, e re apo e përdorur, në gjendje pune, material, pajisje e mallra të përdorura në operacionet e këtushme nga Kontraktori apo materiale për përdorim personal, të cilat i përkasin personelit të Kontraktorit dhe nënkontraktorëve të tij mund të shitet në Shqipëri, pas miratimit të dhënë nga AKBN; duke marrë parasysh që blerësi do të paguajë edhe detyrimet doganore, nëse ka të tilla, zyrave doganore, përveçse rasteve kur shjitja i bëhet AKBN ose enteve të tjera që gëzojnë të njëjtat përjashtime si Kontraktori.

12.2 Materialet dhe mallrat e dëmtuara ose të përdorura deri në dalje jashtë përdorimit për të cilat është rekuperuar kosto si kosto e rekuperueshme, dhe të cilat janë klasfikuar nga Kontraktori si skrap apo mbetje, mund të shiten si skrap ose mbetje pa pagesë Detyrimesh Doganore nga Kontraktori dhe nënkontraktorët e tij, pas miratimit të dhënë nga AKBN.

12.3 AKBN do të informojë Kontraktorin mbi licensat/lejet e detyrueshme në bazë të Ligjit Shqiptar për të realizuar eksportin e Hidrokarbureve nga Shqipëria. Në lidhje me eksportin e Gazit Natyror, parashikimet e ligjit nr.102/2015 datë 23.09.2015 (siç mund të ndryshojë), do të aplikohen rast pas rasti.

12.4 AKBN do të bashkëpunojë me Kontraktorin në mënyrë që të lehtësojë importimin dhe eskportimin, duke përfshirë procedurat përkatëse të zhdoganimit sipas kësaj Kontrate.

13 LIBRAT KONTABËL, KONTABILITETI DHE PAGESAT

13.1 Kontraktori duhet të mbajë në zyrat në selinë e tij në Shqipëri librat kontabël në përputhje me praktikat e kontabilitetit të kërkuara nga legjislacioni shqiptar, procedurat e kontabilitetit dhe praktikat kontabël të përdorura në përgjithësi në industrinë ndërkombëtare të hidrokarbureve, si edhe libra dhe regjistra e të dhëna të tjera, sikurse mund të jetë e nevojshme për të treguar punën e kryer sipas kësaj Kontrate, duke përfshirë sasinë e përgjithshme të të gjithë Prodhimit të Disponueshëm. Me kërkesë të Albpetrolit Kontraktori, duhet të bëjë një raportim për diferencat ne librat kontabël të mbajtur sipas praktikave kombetare dhe ato nderkombetare. Kontraktori duhet t'i mbajë librat dhe regjistrat e tij kontabël në dollarë amerikanë dhe në lekë shqiptarë.

Në rast të një procedure arbitrazhi sipas Nenit 21 të kësaj Kontrate, që përfshin librat kontabël shqiptarë të Kontraktorit, ata libra kontabël që janë mbajtur në përputhje

me ligjin shqiptar do të mbizotërojnë mbi pjesët e papajtueshme te librave kontabël mbajtura sipas praktikat ndërkombëtare të industrisë së hidrokarbureve.

13.2 Të gjitha shpenzimet në Dollarë do të regjistrohen në librat e Kontraktorit në shumën e shpenzuar. Të gjitha shpenzimet e kryera në monedhën shqiptare do të shkëmbehen në Dollarë me kursin zyrtar të këmbimit për blerjen sikurse kuotohet nga Banka e Shqipërisë në ditën kur shpenzimi përkatës është kryer. Të gjitha shpenzimet e tjera jo të kryera në Dollarë do të shkëmbehen në Dollarë me kursin për blerjen në Dollarë sikurse kuotohet nga Citibank, Londër, në mesditë në orën 12:00 në Londër, në Ditën kur është kryer shpenzimi përkatës, dhe nëse kjo nuk është Ditë bankare në Londër, në ditën e ardhshme Bankare. Do të mbahet një regjistër lidhur me kurset e këmbimit të përdorura në përkthimin e monedhës shqiptare apo shpenzimeve të tjera jo të kryera në Dollarë. Kontraktori duhet gjithashtu të lejohet të ruajë dhe të përdorë lirshëm llogari bankare në Dollarë jashtë Shqipërisë dhe në Shqipëri për qëllimet e tij operative sipas kësaj Kontrate.

13.3 Librat e sipërpërmendur kontabël si dhe librat dhe regjistrat e tjerë referuar më sipër do të jenë të disponueshëm në çdo kohë të arsyeshme për inspektim prej përfaqësuesve të autorizuar rregullisht të Albpetrolit, AKBN-së si dhe prej autoriteteve tatimore shqiptare. Pasqyrat financiare dhe librat e TVSH do të mbahen në shqip dhe në anglisht dhe në përputhje me kërkesat e ligjit përkatës shqiptar.

Gjithashtu Kontraktori do të aplikojë Standartet Nderkombëtare të Kontabilitetit dhe Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

13.4 Kontraktori do t'i dorëzojë Albpetrolit dhe AKBN-së një kopje të bilanceve të veta kontabël vjetore jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pasi e ka dorëzuar këtë bilanc tek Autoritetet Tatimore Shqiptare në përputhje me legjislacionin shqiptar.

13.5 Kontraktori do të ketë lirinë e plotë që për qëllime të kësaj Kontrate të:

13.5.1 hapë, operojë dhe të mbajë lirisht llogari bankare brenda dhe jashtë Shqipërisë

13.5.2 pranojë, të mbajë jashtë Shqipërisë dhe të përdorë lirisht monedhën e huaj të marre jashtë Shqipërisë, duke përfshirë të ardhurat nga shitjet e Hidrokarbureve këtu. Kontraktori nuk do të jetë i detyruar të sjellë në Shqipëri të ardhura, perveçse në rastet kur këto të ardhura, në gjykimin e vetë Kontraktorit, mund t'i duhen për të kryer shpenzimet në Shqipëri;

13.5.3 paguajë direkt jashtë Shqipërisë shpenzimet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure;

13.5.4 paguajë punonjësit e huaj që punojnë në Shqipëri në monedhë të huaj jashtë Shqipërisë; këta punonjës të huaj do të lejohen të sjellin monedhë të huaj në Shqipëri përpos nevojave të tyre për shpenzime personale;

13.5.5 të çojë lirisht jashtë gjithë të ardhurat e Kontraktorit nga Operacionet Hidrokarbure në Shqipëri, duke përfshirë por pa u limituar, të ardhurat nga shitja e aseteve ose Hidrokarbureve;

13.5.6 të importojë, eksportojë dhe konvertojë lirisht monedhë të huaj dhe të mbajë brenda Shqipërise llogari në monedhë të huaj.

14 PËRGJEGJËSIA PËR DËMET

14.1 Kontraktori duhet të ushtrojë aftësi të arsyeshme, mirëbesim dhe kujdes në kryerjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate, por përgjegjësia e tij ndaj Albpetrolit dhe AKBN-së që rrjedh nga veprime ose mosveprime nga ana e Kontraktorit ose çdo humbje e pësuar nga apo dëm i shkaktuar kundrejt Albpetrolit dhe AKBN-së ose çdo pale tjetër si rezultat i Operacioneve Hidrokarbure të ndërmarra në përputhje me këtë Kontratë, do të kufizohen në rastet e neglizhencës e rëndë të demonstruar apo veprimeve të qëllimshme nga ana e Kontraktorit, kjo sipas Ligjit Shqiptar.

14.2 Në rast të një dëmi për të cilën Kontraktori është përgjegjës sipas këtij Neni 14, Kontraktori do të përpiqet që menjëherë dhe me kujdes të marrë masat e nevojshme në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Praktikat e Mira Ndërkombëtare të Industrisë së Hidrokarbureve, në mënyrë që të zbusë dëmin dhe të rivendosë normalitetin e operacioneve. Kontraktori do të paguajë dëmshpërblim kompensues lidhur me dëmin për të cilin është deklaruar përfundimisht përgjegjës dhe ky dëmshpërblim do të jetë i kërkueshëm edhe pas zgjidhjes së Kontratës. Të gjitha kostot dhe shpenzimet që lindin sipas këtij neni 14.2 nuk do të klasifikohen si kosto të rekuperueshme.

14.3 Kontraktori duhet të dëmshpërblejë Albpetrolin dhe/apo AKBN-në, sipas rastit, në lidhje me pretendimet e palëve të treta për lëndime, humbje apo dëme që rezultojnë nga neglizhenca e madhe ose sjellje të qëllimshme të Kontraktorit në kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure, përveç dhe deri në masën që këto lëndime, humbje apo dëme rezultojnë nga veprimet kontribuese të një pale tjetër apo prej çdo veprimi apo mosveprimi të AKBN-së ose çdo agjencie tjetër, zyrtari, apo personi tjetër përfaqësues i Qeverisë së Shqipërisë, për të cilat Albpetrol dhe AKBN-ja do të dëmshpërblejë Kontraktorin.

14.4 Kontraktori në asnjë rast nuk do të jetë përgjegjës për dëmet të cilat nuk janë rezultat i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimeve të Kontraktorit apo dështimit të tij për të vepruar, duke përfshirë edhe humbjen e Prodhimit ose humbjen e fitimeve, dhe Kontraktori nuk do të jetë përgjegjës për dëmshpërblimet ndëshkuese ose edukuese, secila prej të cilave do të interpretohet veçmas pa aplikuar rregullin *generis ejusdem*.

14.5 Kontraktori duhet, si pjesë e Operacioneve Hidrokarbure, të jetë i siguruar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Praktikat e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure në lidhje me Operacionet Hidrokarbure të tij, por duke mos përfshirë sigurimin e pasurive pronësia e të cilave i ka kaluar AKBN-së në bazë të Nenit 23 të kësaj Kontrate. Megjithatë, Kontraktori nuk do të ketë asnjë detyrim për ta mbajtur sigurimin në lidhje me pasuritë pronësia e të cilave i ka kaluar AKBN-së në mënyrën e sipërpërmendur, kur këto pasuri nuk përdoren më prej Kontraktorit në Operacionet Hidrokarbure.

15 REGJISTRAT, RAPORTET DHE INSPEKTIMET

15.1 Kontraktori do të përgatisë dhe, në çdo kohë, ndërsa kjo Kontratë është në fuqi, do të mbajë regjistra të sakta dhe të përditësuara të Operacioneve të veta Hidrokarbure sipas kësaj Kontrate. Kontraktori do të pajisë Albpetrolin apo përfaqësuesit e tij me të gjithë të dhënat e arsyeshme në përputhje me standardet më të mira të dhënies së informacionit të industrisë dhe në përputhje me ligjin shqiptar, lidhur me Operacionet e tij Hidrokarbure në Shqipëri sipas kësaj Kontrate, me kusht që kërkesa e Albpetrolit t'i jetë njoftuar Kontraktorit të paktën 7 ditë pune më parë.

15.2 Përveçse kur është rënë dakord ndryshe nga Albpetroli, në rast eksporti të çdo mostre guri jashtë Shqipërisë për analiza të huaja, mostra ekuivalente në madhësi dhe cilësi, do të mbahen nga Kontraktori në Shqipëri.

15.3 Regjistrime të të dhënave teknike mund të eksportohen për analiza nga Kontraktori jashtë vendit; me kusht që, sidoqoftë, regjistrimet magnetike dhe çdo e dhënë tjetër që nevojitet të procesohet dhe të analizohet jashtë Shqipërisë të mund të eksportohet nëse një regjistër kontrolli apo një regjistrim i ngjashëm të mbahet në Shqipëri nga Kontraktori.

15.4 Kontraktori do të lejojë Albpetrolin që, nëpërmjet përfaqësuesve të saj të autorizuar ose të punësuarve, të kenë akses të plotë dhe tërësor në Zonën E Kontratës, në çdo kohë të arsyeshme, me të drejtën për të vëzhguar kryerjen e veprimeve dhe për të inspektuar të gjitha regjistrat dhe të dhënat e mbajtura nga Kontraktori. Përfaqësuesit e Albpetrolit në ushtrimin e kësaj të drejte sipas fjalisë së mësipërme të këtij Neni 15.4 do të kujdesen që Operacionet Hidrokarbure mos të pengohen ose vonohen. Aksesi duhet të paraprihet nga një njoftim i arsyeshëm dhe pa ndërhyrje në aktivitetin e Kontraktorit, në rrezikun e vetëm të Albpetrolit dhe objekt të sigurisë së duhur dhe përkujdesjes operative.

15.5 Kontraktori duhet të pajisë rregullisht Albpetrolin me kopje të të gjitha të dhënave dhe regjistrave teknikë (duke përfshirë, por pa u kufizuar në: kaseta sizmike në terren, raporte gjeologjike dhe gjeofizike, hyrje dhe testime të puseve, informacione dhe interpretime të tyre) të cilat janë në dispozicion të Kontraktorit, përfshirë

kampion-teste, të lidhura me Operacionet Hidrokarbure sipas kësaj Kontrate. Të gjitha këto të dhëna do të konsiderohen si ngushtësisht konfidenciale dhe nuk do të shperndahen nga Albpetrol, përveçse tek autoritete të tjera qeveritare, pa pëlqimin e Kontraktorit dhe as nga Kontraktori, përveçse tek Shoqëritë e Lidhura, këshilluesit profesionalë, bankat apo institucionet financiare prej të cilave Kontraktori apo çdo subjekt që përfshin Kontraktorin, është duke kërkuar apo duke marrë financim, si dhe palëve të treta që mund të jenë të interesuara në blerjen e një interesi në këtë Kontratë (gjithmonë me kushtin se këto Shoqëri të Lidhura, konsulentë, banka, institucione financiare dhe palë të treta kanë lidhur një marrëveshje të rreptë konfidencialiteti), ose në masën e kërkuar nga çdo bursë në të cilën aksionet e Kontraktorit ose çdo subjekti që përfshin Kontraktorin ose çdo Shoqëri e Lidhur e Kontraktorit ose çdo subjekt që përfshin Kontraktorin është kuotuar, me njoftim paraprak të Albpetrolit, për sa kohë kjo Kontratë mbetet në fuqi. Nëse kjo Kontratë zgjidhet në Fazën e Parë të Kërkimit ose në ndonjë Fazë Kërkimi vijuese, Kontraktori do të jetë i detyruar të mos bëjë të ditur, me përjashtim të Shoqërive të Lidhura, të dhënat dhe informacionet e marra nga ai dhe mos të heqë dorë nga ato në çfarëdolloj mënyre, gjatë së paku pesë (5) viteve nga Zgjidhja e kësaj Kontrate. Detyrimet e konfidencialitetit të Albpetrolit nuk përfshijnë të dhëna për zona nga të cilat është hequr dorë nga Kontraktori, të dhëna të cilat mund t'i dorëzohen palëve të treta, me kusht që përfituesit e këtyre të dhënave të bien dakord për t'i përdorur ato vetëm për të përcaktuar mundësinë e hyrjes në një kontratë me Albpetrolin për atë zonë, dhe për t'i ruajtur të dhënat konfidenciale. Pavarësisht nga sa më lart, Kontraktori do të ketë liri të plotë për t'i bërë të ditura të dhënat tek palë të treta me kusht nënshkrimin e një marrëveshjeje konfidencialiteti.

16. TË DREJTAT DHE TRAJNIMI I PERSONELIT SHQIPTAR

16.1 Palët bien dakort që Operacionet Hidrokarbure si më poshtë vijojnë të kryhen sipas praktikave tregtare dhe në mënyrë efikase; për këtë arsye është rënë dakord se:

16.1.1 Personeli i huaj administrativ, profesional dhe teknik i punësuar nga Kontraktori si edhe personeli i nënkontraktorëve të tij për kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure sipas kësaj Kontrate, duhet të pajiset me leje qëndrimi dhe leje pune në Shqipëri.

16.1.2 Personeli i huaj administrativ, profesional dhe teknik i punësuar nga Kontraktori do të paguhet për shërbimet e tyre sipas politikave të zbatueshme të Kontraktorit në lidhje me këtë personel, të cilat do të jenë në përputhje me Praktikat e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure.

16.2 Kontraktori do të jetë i lirë të zgjedhë punojësit e tij dhe të caktojë numrin e atyre që do të angazhohen në Operacionet Hidrokarbure sipas kësaj Kontrate në përputhje

me Praktikat e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure. Pa paragjykuar sa më lart, palët bien dakort që:

16.2.1 Duke marrë në konsideratë kërkesat operacionale të Kontraktorit sipas kësaj Kontrate, Kontraktori do të punësojë personel shqiptar në rast se aftësitë e tij njohuritë dhe ekperienca professionale janë të përshtatshme me kërkesat e Kontraktorit. Kontraktori do të mundësojë në mënyrë të arsyeshme që nënkontraktorët e tij të ndjekin të njëjtën procedurë. Punët që s'kërkojnë aftësi apo cilësi do t'u jepen vetëm shtetasve shqiptarë.

16.2.2 Gjatë Prodhimit, Kontraktori do të zëvëndësojë gradualisht personelin e tij jo-ekzekutiv të huaj me personeli të kualifikuar shqiptar, sipas rastit dhe sipas gjykimit diskrecionar të Kontraktorit.

16.2.3 Në rast se, sipas ligjit shqiptar, Kontraktori duhet që të zbresë taksat, kontributet për sigurimet shoqërore dhe/ose shëndëtsore nga pagat që i paguan punojësve të tij shqiptar apo nënkontraktorëve apo të kryejë pagesën e të gjithë apo një pjesë të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punojësit e tij shqiptarë, Kontraktori do të respektojë këto kërkesa dhe sipas rastit do të paguajë këto taksa e do të kryejë këto pagesa pranë autoriteteve përkatëse të Qeverisë Shqiptare.

16.3 Kontraktori do të përgatisë dhe do të organizojë programe trajnimi për punojësit e tij Shqiptarë të angazhuar në Operacionet Hidrokarbure sipas kësaj Kontrate, në përputhje me Praktikat e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure.

16.4 Kontraktori do të bashkëpunojë me programet e trajnimit të AKBN si më poshtë vijon:

16.4.1 Brenda tridhjetë (30) Ditëve nga fillimi i çdo Viti Kalendarik, gjatë Periudhës së Kërkimit apo të Vlerësimit, Kontraktori do t'i paguajë Albpetrolit shtatëdhjetë mijë Dollarë (70.000US$) në vit, që do të përdoret për:

16.4.1.1 blerjen e literaturës teknike moderne, të dhënave, softëare, hardëare dhe mjeteve shkencore të Albpetrol;

16.4.1.2 dërgimi i punojësve të Albpetrol në kurse të përzgjedhura në fushën shkencore inxhinierike dhe menaxheriale hidrokarbure; dhe

16.4.1.3 mbulimi nga Albpetrol i disa shpenzimeve administrative lidhur, por pa u kufizuar në, zbatimin e kësaj Kontrate.

Në rast se këto periudha nuk fillojnë me fillimin e, apo nuk përfundojnë në fund të, një Viti Kalendarik të plotë, kjo shumë do të ndahet në mënyrë proporcionale sipas rastit.

16.4.2 Brenda tridhjetë (30) Ditëve nga fillimi i çdo Viti Kalendarik, duke nisur nga data e Planit të parë të Zhvillimit të paraqitur sipas Nenit 6.4.1. të kësaj Kontrate, pagesa e sipërpërmendur e trajnimit do të jetë Shtatedhjetë mijë Dollarë (70.000$US) (për Vit Kalendarik) dhe do të përdoret njëiloj sipas parashikimeve të Nenit 16.4.1. Në rast se data e paraqitjes së Planit të parë të Zhvillimit nuk përkon me fillimin e një Viti të plotë Kalendarik, kjo shumë do të paguhet në mënyrë proporcionale sipas rastit.

16.5 Të gjitha kostot dhe shpenzimet e kryera nga Kontraktori lidhur me programet e trajnimit për punonjësit e Albpetrol, do të rekuperohen nga Kontraktori sipas Nenit 7 të kësaj Kontrate si Shpenzime Operative.

17. KONTRAKTORET VENDAS DHE MATERIALET E PRODHUARA NE VEND

Kontraktori dhe nënkontraktorët e tij do të:

17.1 Japin përparësi kontraktorëve vendas përsa kohë që çmimet dhe cilësia dhe gatishmëria e performancës së tyre janë të krahasueshme me çmimet dhe performancën ndërkombëtare.

17.2 Japin avantazh materialeve, pajisjeve, makinerive dhe lëndëve të konsumueshme të prodhuara në vend përsa kohë që çmimi, cilësia dhe koha e dorëzimit të tyre janë të krahasueshme me materialet, pajisjet, makineritë dhe lëndët e konsumueshme ndërkombëtare. Me qëllimin për të krahasuar çmimin, në koston e mallrave të importuar nuk llogaritet detyrimet doganore por përfshihet kosto e transportit dhe e siguracionit.

17.3 Paraqesë për tender në përputhje me polikën e Operatorit çdo kontratë, për mallra dhe /ose shërbime lokale ose të huaja, vlera e së cilës kalon treqind mijë dollarë ($300.000). Në këtë rast Albpetrol do të jetë pjesë e komisionit të ofertave nëpërmjet përfaqësuesve apo punojësve të tij të autorizuar rregullisht të cilët kanë të drejta mbikqyrjeje, por pa të drejtë vote.

18. LIGJET DHE RREGULLORET

18.1 Kjo Kontratë do të rregullohet dhe do të interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar. Veprimtaria e Kontraktorit për kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure është subjekt i të gjithë ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme në Shqipëri, siç përcaktohet në këtë Nen 18.

18.2 Të drejtat dhe detyrimet e Albpetrolit dhe Kontraktorit sipas dhe gjatë afatit ligjor të kësaj Kontrate do të rregullohen nga dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate

dhe mund të ndryshohen apo modifikohen vetëm me marrëveshje të përbashkët me shkrim të Palëve, në përputhje me ligjet në fuqi.

18.3 Nënkontraktorët e Kontraktori janë subjekt i dispozitave të kësaj Kontrate të zbatueshme ndaj tyre si edhe subjekt i ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme në vend dhe ndryshimeve të tyre.

18.4 Në rast se gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, aprovohen dispozita të reja apo ndryshime të ligjeve shqiptare apo rregulloreve që prekin ose kanë mundësinë të prekin duke përkeqësuar pozicionin ekonomik ose tregetar të Kontraktorit sipas termave të kësaj Kontrate, atëhere kjo Kontratë do të amendohet në mënyrë të tillë që të ruajë ekuilibrin ekonomik që ekzistonte në momentin e Hyrjes në Fuqi të saj. Për këtë qëllim Kontraktori do të dërgojë një shkresë formale në Albpetrol, AKBN dhe MEI, në të cilën i informon ata se si ndryshimet në legjislacion prekin pozicionin e tij ekonomik, dhe iu kërkon marrjen e masave të nevojshme për të ruajtur ekuilibrin ekonomik të kësaj Kontrate. Kontraktori do të bashkëpunojë aktivisht me Albpetrol-in, AKBN dhe MEI për të përcaktuar masat e nevojshme që mund të merren në përputhje me legjislacionin në fuqi.

18.5 Për përcaktimin e mënyrës së kompensimit të Kontraktorit që referohet më lart, Albpetroli dhe Kontraktori do të takohen brenda dyzet e pesë (45) Ditëve nga data e këtyre ndryshimeve apo modifikimeve dhe çdo përshtatje e metodës së kompensimit të Kontraktorit do të ketë efekte prapravepruese që nga data e ngjarjes që shkaktoi përshtatjen.

18.6 Parashikimet e Nenit 18.4 nuk aplikohen në rastin e shtesave, ndryshimeve apo amendimeve ligjore që bëhen në ligje apo nënligje për marrëdheniet e punës, për mbrojtjen e ambjentit, shëndetit, sigurisë në punë.

18.7 Nëse Albpetroli dhe Kontraktori nuk bien dakord me shkrim për menyrën e kompensimit të Kontraktorit referuar më sipër, brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas datës së njoftimit të Albpetrolit nga Kontraktori, çeshtja do t'i referohet një Eksperti sipas përcaktimeve të nenit 21.8 këtu. Eksperti, në këtë rast, do të ketë fuqinë të marrë një vendim për të ndryshuar termat e kësaj Kontrate, në përputhje me parimet e përcaktuara në nenet 18.4, 18.5 dhe 18.6, me synim rivendosjen e ekuilibrit ekonomik të kësaj Kontrate.

18.8 Çdo amendim i Kontrates,ne perputhje me parashikimet e ketij Neni 18, do te hyje ne fuqi pas miratimit ne Keshillin e Ministrave.

19. **TRANSFERIMI I INTERESAVE**

19.1 Kontraktori apo subjektet që përbëjnë Kontraktorin mund të shesin, cedojnë, japin me nën-qira, hipotekojnë apo të transferojnë në çfarëdo mënyre tjetër tek çdo person, shoqëri apo korporatë që nuk është Palë e kësaj Kontrate, të gjithë apo një pjesë të Interesave Pjesëmarrëse apo të drejtave të tjera, privilegjeve, përgjegjësive apo detyrimeve sipas kësaj Kontrate, me miratimin praraprak me shkrim të Albpetrolit, miratim ky që nuk do të mbahet apo vonohet pa arsye.

19.2 Çdo person, firmë apo kompani, të cilës Kontraktori ka në plan t'i transferojë Interesat e Pjesëmarrjes apo çdo të drejtë, privilegj, detyrim apo oligim tjetër sipas kësaj Kontrate, do të japë evidencë të arsyeshme mbi aftësitë financiare dhe teknike të tij.

19.3 Në lidhje më transferimin nga Kontraktori të të drejtave, privilegjeve, detyrimeve apo obligimeve, sipas kësaj Kontrate, detyrimet dhe obligimet e Kontraktorit do të përmbushen plotësisht deri në datën e miratimin me shkrim nga Albpetroli, ose Kontraktori do të garantojë në mënyrë solidare apo në mënyrë të pavarur, përmbushjen e çdo detyrimi që nuk është përmbushur deri në atë datë.

19.4 Instrumenti i transferimit duhet të përmbajë parashikime që përcaktojnë ekzaktësisht se personi, të cilit i transferohen të drejtat dhe detyrimet, është përgjegjës për përmbushjen e të gjitha detyrave dhe detyrimeve si edhe për të gjitha klauzolat e kësaj Kontrate dhe të çdo ndryshimi apo modifikimi që mund t'i jenë bërë asaj deri në atë kohë.

19.5 Pavarësisht nga sa më sipër, Kontraktori ose një entitet që përbën Kontraktorin, është i lirë të shesë, cedojë ose ndryshe të transferojë një pjesë ose gjithë interesat e tij ne këtë Kontratë tek një Filial i tij, pasi të ketë mbaruar afati gjashtëdhjetë (60) ditor i njoftimit paraprak të Albpetrolit mbi këtë transferim, nëse Kontraktori siguron një garanci të shkruar për performancë të plotë të këtij Filiali në lidhje me përmbushjen e detyrimeve dhe obligimeve sipas kësaj Kontrate të cilat do të transferohen. Në çdo moment pas këtij transferimi, ish-Kontraktori që transferoi interesat, mund t'i kërkojë Albpetrolit ta çlirojë nga garancia paraprake, kërkesë kjo që nuk do të refuzohet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme, duke treguar me fakte që Filiali tek i cili u krye transferimi, në mënyrë të pavarur posedon aftësitë teknike dhe financiare për të performuar detyrimet dhe obligimet që i janë transferuar. Çdo transferim nga Kontraktori tek një Filial, pa garancine e shkruar paraprake nga Kontraktori, do të jetë subjekt i kërkesave të neneve 19.1, 19.2, 19.3 dhe 19.4.

20. **FORCA MADHORE**

20.1 Mos përmbushja apo vonesat në përmbushje nga ana e Kontraktorit të detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate justifikohen dhe mbarimi i çdo periudhe apo afati do të shtyhet në rast se dhe në masën që kjo mos-përmbushje apo vonesë shkaktohet nga Forca madhore. Periudha e një mos-përmbushje të tillë apo vonesë, bashkë me periudhën e nevojshme për ndreqjen e dëmeve që janë shkaktuar gjatë kësaj vonese, do t`i shtohen kohës që është caktuar në këtë Kontratë për përmbushjen e këtyre detyrimeve që kushtëzohen nga kjo dhe si rrjedhojë afatit të kësaj Kontrate.

Çdonjëra nga Palët që deklaron ngjarje të Forcës Madhore sipas kësaj Kontrate, informon menjëherë Palën tjetër menjëherë dhe jep të dhëna specifike dhe të arsyeshme në lidhje me të. Qëllimi i Palëve është që termi Forcë Madhore të interpretohet sipas ligjit dhe parimeve të principeve të ligjeve ndërkombëtare.

Kur njëra nga Palët pretendon se e ka të pamundur realizimin e çdonjë prej detyrimeve të saj për shkak të një rasti të Forcës Madhore, do të njoftojë Palën tjetër sa më shpejt të jetë e mundur, duke përcaktuar motivet për përcaktimin e këtij rasti si Forcë Madhore, dhe, në marrëveshje me Palën tjetër, do të kryejë gjithe veprimet e nevojshme dhe të dobishme që do të siguronin vazhdiimin e punës për përmbushjen e detyrimit të ndërprerë nga ngjarja e Forcës Madhore, menjëherë pas përfundimit të ngjarjes së Forcës Madhore.

20.2 Detyrimet e tjera, përveç atyre që preken nga ngjarja e Forcës Madhore, do të vazhdojnë të përmbushen sipas parashikimeve të kësaj Kontrate.

20.3 Pavarësisht sa më sipër, nëse ndodh një ngjarje ose rrethanë e Forcës Madhore dhe ka gjasa te vazhdoje për një periudhë përtej tridhjetë (30) ditëve, Palët do të takohen të diskutojnë pasojat dhe planin e veprimeve që duhen ndërmarre për të zbutur efektet ose për t'u përshtatur me rrethanat.

20.4 Në rast se ngjarja e Forcës Madhore ndodh gjatë Periudhës së Kërkimit dhe vazhdon për një periudhë prej gjashtë (6) muajsh, Kontraktori ka të drejtë që me dhënien e një njoftimi paraprak me shkrim prej tridhjetë (30) ditësh tek Albpetrol dhe AKBN të zgjidh këtë Kontratë pa asnjë detyrim të asnjë lloji, por gjithsesi kjo zgjidhje nuk e shkarkon Kontraktorin nga ndonjë angazhim apo detyrim i papermbushur apo i pezulluar, që duhej realizuar përpara ngjarjes së Forcës Madhore.

20.5 Në rast se, për një periudhë të pandërprerë prej dy (2) vjetësh, si rezultat i një ngjarje të Forcës Madhore dhe jo për një shkak të një thyerje të përmbushjes së detyrimeve të kësaj Kontrate që s'kanë lidhje me ngjarjen që ka shkaktuar Forcën Madhore, njëra nga Palët e ka të pamundur të përmbushë detyrimet e veta, kjo kontratë mund të përfundohet nga secila nga Palët në ditën e përvjetorit të dytë të fillimit të ngjarjes së Forcës Madhore.

20.6 Kur njëra nga Palët hyn në një marrëveshje, sipas kësaj Kontrate, me një pale të tretë, dështimi i kësaj Pale të tretë në përmbushjen e një detyrimi sipas asaj marveshjeje, do të quhet Forcë Madhore që ndikon ate Palë, vetëm nëse përmbushja e atij detyrimi u pamundësua, pengua ose vonua nga ngjarje ose rrethana të cilat (nëse Pala e tretë ishte pjesë e kësaj kontrate në cilësinë e Palës së interesuar) do të jene Forcë Madhore (sipas përcaktimeve të këtij Neni 20).

21. **KONFLIKTET DHE ARBITRAZHI**

21.1 Çdo konflikt (përveç konflikteve që në kuptim të kësaj Kontrate duhet të referohen tek një Ekspert), mosmarrëveshje, pretendim apo opinion i ndryshëm që lind nga apo lidhet me këtë Kontratë apo shkelja, përfundimi apo vlefshmëria e saj apo që lidhet me kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure sipas kësaj Kontrate, do të zgjidhen në mënyrë përfundimtare me arbitrazh në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombetare të Tregtisë (**"Rregulla e arbitrazhit të ICC"**).

21.2 Autoriteti i arbitrazhit do të jetë Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Për cdo çështje në konflikt, numri i arbitrave do të jetë tre (3). Arbitrat do të caktohen një nga Albpetrol, një nga Kontraktori dhe këta dy arbitra do të caktojnë arbitrin e tretë, i cili do të veproj si President i trupit gjykues

21.3 Vendi i arbitrazhit do të jetë Paris, Francë. Gjuha që do të përdoret në procedurat e arbitrazhit do të jetë gjuha Angleze.

21.4 E drejta per t'iu drejtuar arbitrazhit sipas këtij Neni 21, do të vazhdoj edhe pas zgjidhjes së kësaj Kontrate për pretendime të lindura përpara kësaj zgjidhjeje.

21.5 Vendimi i arbitrazhit do të përmbajë arsyet ku bazohet vendimi dhe caktimin e kostove.

21.6 Albpetrol heq dorë shprehimisht nga pretendimi për të drejta imuniteti lidhur me proçedurat sipas këtij Neni 21, proçedurat për kërkimin e zbatimit të këtij Neni 21 apo procedurat për zbatimin e një vendimi arbitrazhi sipas kësaj Kontrate.

21.7 Secila nga Palët ka të drejtë të paraqesë përpara çdo gjykate të juridiksionit përkatës një kërkesë për njohje dhe/ose zbatim të vendimit të arbitrave. Gjykata do të lëshojë pranimin gjyqësor dhe/ose urdhër për zbatimin e vendimit të arbitrazhit, sipas rastit.

21.8 Çdo çeshtje në konflikt ndërmjet Albpetrolit dhe Kontraktorit e cila me termat e kësaj Kontrate duhet ti referohet nje Eksperti, do t'i referohet dhe do të zgjidhet sipas përcaktimit të ekspertit në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

21

21.8.1 Do të caktohet vetëm një Ekspert.

21.8.2 Eksperti do të caktohet me marrëveshje ndërmjet Albpetrolit dhe Kontraktorit. Në rast se Albpetroli dhe Kontraktori nuk caktojnë një Ekspert brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur Pala njofton Palën tjetër me shkrim lidhur me qëllimin e saj për të paraqitur çështjen objekt mosmarrëveshje përpara një Eksperti, Eksperti (me kërkesë të secilës prej apo të dyja Palëve) do të emërohet nga Qendra Ndërkombëtare për Ekspertizën në përputhje me dispozitat e caktimit të ekspertëve teknikë sipas Rregullave për Ekspertizën të Dhomës Ndërkomëbtare të Tregtisë.

21.8.3 Ekspertit do t'i jepen terma referencë që do të caktohen bashkarisht me marrëveshje të Palëve. Në rast mungese të një marrëveshje të tillë, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur Pala njofton palën tjetër me shkrim lidhur me qëllimin e saj për të paraqitur çështjen objekt të mosmarrëveshjes përpara një Eksperti, Eksperti do të vazhdojë me përcaktimin e ekspertizës pavarësisht mungesës së termave të references të rëna dakort.

21.8.4 Gjuha e procedurave për marrjen e vendimit të ekspertit do të jetë gjuha Angleze.

21.8.5 Eksperti do të veprojë si ekspert dhe jo si arbitër. Eksperti do të japë vendimin e tij në përputhje me dispozitat që përmbahen këtu në bazë të provave më të mira që ai disponon.

21.8.6 Përfaqësuesit e Albpetrol dhe Kontraktorit kanë të drejtën e konsultimit me Ekspertin dhe t`i sigurojnë atij të dhëna dhe informacion deri në masën që Eksperti, në mënyrë të arsyeshme, e kufizon këtë të drejtë. Të dhënat dhe një informacion i tillë duhet t'i paraqiten Palës tjetër në konflikt në të njëjtën kohë. Eksperti është i lirë të vlerësojë masën në të cilën këto të dhëna, informacion apo provë tjetër, janë thelbësore apo të përshtatshme.

21.8.7 Tarifat dhe shpenzimet e Ekspertit si edhe kostot e caktimit të tij, nëse ka, të kryera nga Qendra Ndërkombëtare e Ekpertizës, do të ndahen në mënyrë të barabartë nga AKBN dhe Kontraktori.

21.8.8 Vendimi i Ekspertit do të jetë me shkrim.

21.8.9 Përveç rastit të një vendimi të Ekspertit sipas Nenit 6.14.1 (ndaj të cilit, do të zbatohen dispozitat e Nenit 6.14.2):

21.8.9.1 vendimi i Ekspertit do të jetë përfundimtar dhe detyrues për Palët, përveç ndonjë gabimi të dukshëm në vendim; dhe

21.8.9.2 çdo ankim ndaj vendimit të Ekspertit (që mund të bëhet vetëm me pretendimin e një gabimi të dukshëm) do të paraqitet përpara arbitrazhit në përputhje me këtë Nen 21 brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e vendimit të Ekspertit dhe në rast se nuk ankimohet, vendimi i Ekspertit do të quhet se nuk ka asnjë gabim të dukshëm.

22 TUBACIONET DHE IMPIANTE TE TJERA

22.1 Gjatë afatit të kësaj Kontrate si edhe çdo shtyrje të saj, Kontraktori ka të drejtë të përdorë plotësisht në Zonën e Kontratës apo në çdo zonë tjetër të miratuar nga AKBN, të gjithë pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që Kontraktori ka marrë apo përftuar për Operacionet Hidrokarbure.

22.2 Gjatë afatit të kësaj Kontrate si edhe çdo shtyrje të saj, Kontraktori ka të drejtë, me qëllim transportimin e Hidrokarbureve brenda dhe jashtë Zonës se Kontratës tek pika e eksportit apo në çdo pikë tjetër lëvrimi siç është rënë dakord nga AKBN, Albpetroli dhe Kontraktori, të ndërtojë e operojë tubacione dhe impiante të tjera si edhe pajisje të tjera transporti dhe/ose impiante terminale brenda ose jashtë Zonës se Kontratës, në përputhje me Planin e miratuar të Punës dhe Buxhetin. Ndërtimi i çdo impianti jashtë Zonës se Kontratës nuk do të ndërhyjë në mënyrë të paarsyeshme në operacionet e Albpetrolit, AKBN-së apo palëve të treta si edhe nuk do të bjerë në konflikt me politikat e miratuara të zhvillimit të Qeverisë Shqiptare si edhe të autoriteteve të tjera kompetente Shqiptare.

22.3 Në rast se Kontraktori dëshiron të përdorë tubacionet, mjetet e transportit dhe impiantet terminale që janë në dispozicion të Albpetrol dhe që nuk nevojiten në këtë kohë për Operacione të tjera Hidrokarbure, Albpetroli dhe Kontraktori do të takohen dhe do të bien dakord mbi kushte të përshtatshme për përdorimin e tyre në bazë të tarifave ekonomike të arsyeshme.

22.4 Çdo pagesë që do të kryhet nga Kontraktori lidhur me përdorimin e tij të impianteve që referohen në këtë nen 22 do të rikuperohen si Shpenzime Operacionale sipas Nenit 7.

23 TITULLI MBI PASURITË DHE BRAKTISJA

23.1 Titulli mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme do të transferohet automatikisht dhe gradualisht nga Kontraktori tek AKBN dhe kosto e tyre është e rikuperueshme në përputhje me dispozitat e Nenit 7 dhe Procedurat e Kontabilitetit. Megjithatë, titulli i plotë i pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme do të transferohet automatikisht, i lirë nga taksat dhe/ose tarifat nga Kontraktori tek AKBN kur kosto e tyre totale të jetë rikuperuar nga Kontraktori në përputhje me dispozitat e Nenit 7 apo në kohën e zgjidhjes së kësaj Kontrate cilado ndodh e para.

23.2 Titulli mbi pasuritë që nuk janë objekt rikuperimi kostoje nga Kontraktori apo të importuara në Shqipëri nga personeli i huaj i Kontraktorit apo nga nënkontraktorët e Kontraktorit, nuk do të transferohet tek AKBN dhe këto artikuj sipas zgjedhjes së vetë pronarit të tyre, mund të shiten qoftë në Shqipëri sipas Nenit 12.5 apo mund të eksportohen lirisht.

23.3 Gjatë afatit të kësaj Kontrate si edhe çdo zgjatje afati të saj, Kontraktori me miratimin e AKBN ka të drejtën e përdorimit të plotë e të lirë në Shqipëri të gjithë pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme që ka blerë apo fituar nga Operacionet Hidrokarbure pavarësisht nëse kosto e tyre është rekuperuar apo jo nga Kontraktori.

23.4 Kontraktori, me kërkesë të AKBN, do të heqë të gjithë instalimet apo impiantet e ndërtuara nga Kontraktori për qëllimet e kësaj Kontrate dhe që janë braktisur apo nuk janë përdorur e që si pasojë nuk ka asnjë qëllim për përdorim të tyre në të ardhmen gjatë afatit apo me zgjidhjen e kësaj Kontrate.

23.5 Në përputhje me afatin e saj, heqja e lartpërmendur dhe detyrimet e tjera të braktisjes do të jenë objekt i dhe do të përcaktohen në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

23.5.1 Kontraktori, në këshillim me AKBN dhe Albpetrolin, do të përgatisë dhe do të paraqesë për miratim të AKBN-së brenda një kohe të arsyeshme e në përputhje me standartet e industrisë, një plan braktisje (në vijim referuar si "Plani i Braktisjes") përfshirë një përshkrim të detajuar teknik dhe inxhinierik të masave për heqjen dhe braktisjen në përputhje me

detyrimet e lartpërmendura që dëshiron të kryejë me përfundimin e testimit, Vlerësimit apo prodhimit nga Zona e Zhvillimit dhe Prodhimit.

23.5.2 Jo më vonë se njëqind e tetëdhjetë (180) ditë përpara datës që referohet në paragrafin 23.5.3 këtu më poshtë, Kontraktori do të paraqesë për miratim të Komitetit Këshillimor buxhetin e detajuar (në vijim referuar si "**Buxheti për Braktisjen**") ku të përcaktojë koston e vlerësuar për Planin e Braktisjes.

23.5.3 Dhjetë (10) vite përpara datës së parashikuar për përfundimin e operacioneve të prodhimit apo në fund të Tremujorit ku prodhimi akumulues arrin shtatëdhjetë e pesë përqind (75%) të nxjerrjeve të pritshme Hidrokarbure, cilado nga këto verifikohet e para, një shumë e barabartë me Buxhetin e Braktisjes do të derdhet në librat e llogarisë (në vijim referuar si "**Llogaria e Kostos së Braktisjes**") që do të përdoret me qëllim realizimin e kostove të braktisjes. Kjo shumë do të rekuperohet nga Kontraktori në përputhje me Nenin 7 e për këtë qëllim shuma do të ndahet në mënyrë proporcionale në bazë njësie prodhimi mbi nxjerrjet e pritshme të mbetura Hidrokarbure nga Zona e Zhvillimit dhe Prodhimit.

23.5.4 Në vitin e parë pas datës që referohet në nenin 25.5.3 më lart si edhe çdo vit më pas, Palët do të takohen për të ri-vlerësuar Buxhetin e vlerësuar të Braktisjes dhe, nëse e nevojshme, do të rishikojnë këtë Buxhet Braktisje e në këtë rast Palët do të bien dakord për përshtatjen si pasojë e kësaj që duhet t'i bëhet shumës që do të vendoset në Llogarinë e Kostos së Braktisjes.

23.5.5 Jo më vonë se një (1) Vit përpara datës së parashikuar të përfundimit të Operacioneve Hidrokarbure lidhur me të gjithë apo një pjesë të Zonës së Zhvillimit dhe Prodhimit, Kontraktori do të përgatisë dhe do të paraqesë tek AKBN dhe Albpetrol Planin Përfundimtar të Braktisjes me keto rishikime e në përputhje me detyrimet e lartpërmendura të Kontraktorit. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga miratimi i Planit të Braktisjes të lartpërmendur Kontraktori do të përgatisë dhe do të paraqesë tek AKBN dhe Albpetrol një Buxhet përfundimtar të Braktisjes. Në rast se shuma në Llogarinë e Kostos së Braktisjes (në vijim referuar si "**Shuma e Kostos**") është e pamjaftueshme për plotësimin e Buxhetit të Braktisjes, një shumë e nevojshme për plotësimin e Buxhetit të Braktisjes do të regjistrohet në Llogarinë e Kostos së Braktisjes e cila do të jetë e rikuperueshme nga Kontraktori në përputhje me Nenin 7.

23.5.6 Kontraktori do të kryejë me kujdes të gjitha operacionet e heqjes dhe braktisjes që përcaktohen në Planin e Braktisjes dhe këto shpenzime do të zvogëlojnë Llogarinë e Kostos së Braktisjes. Çdo tepricë në Llogarinë e Kostos së Braktisjes që rezulton pas përfundimit të operacioneve dhe që

është rikuperuar në përputhje me Nenin 7 do t'i paguhet AKBN-së brenda tridhjetë (30) ditëve nga përfundimi i këtyre operacioneve.

23.6 Pa paragjykuar dispozitat e Neneve 23.4 dhe 23.5, Kontraktori mund, në rast se sipas gjykimit të Kontraktorit, ekzistojnë rrethana që nuk garantojnë vazhdimësinë e Operacioneve Hidrokarbure dhe në konsultim me Albpetrolin dhe AKBN, në çdo kohë të japë njoftim me shkrim nëntëdhjetë (90) ditë përpara tek Albpetrol dhe AKBN lidhur me qëllimin e tij për heqjen dorë nga të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate, me përjashtim të drejtave dhe detyrimeve që kanë lindur në periudhën përpara kësaj heqje dorë si edhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tjera që parashikohen sipas kësaj Kontrate e të braktisë Zonën e Kontratës në përputhje me Planin e Braktisjes të miratuar nga AKBN, miratim ky që nuk do të refuzohet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme.

24 ZGJIDHJA

24.1 Kjo Kontratë mund të zgjidhet nga Kontraktori me njoftim paraprak me shkrim jo më pak se nëntëdhjetë (90) ditë drejtuar Albpetrolit, me kusht që kjo zgjidhje të mos shkarkojë Kontraktorin nga çdo angazhim i papërmbushur apo detyrim tjeter që ka lindur përpara kësaj zgjidhjeje.

24.2 Kjo Kontratë mund të zgjidhet nga Albpetroli me njoftim paraprak me shkrim Kontraktorit jo më pak se nëntëdhjetë ditë (90) ditë në rastet e mëposhtme:

24.2.1 Në rast se Kontraktori ka kryer në mënyrë të përsëritur një shkelje thelbësore të detyrave apo detyrimeve të tij themelore sipas kësaj Kontrate dhe është paralajmëruar me shkrim për këtë qëllim nga Albpetroli, atëherë Albpetroli mund të japë njoftim për zgjidhje vetëm në rast se Kontraktori nuk ka ndrequr këtë shkelje brenda tre (3) muajve nga marrja e njoftimit të Albpetrol që përcakton detajet e arsyeshme të shkeljes së pretenduar dhe veprimet e nevojshme për ndreqjen e kësaj shkelje.Në rast se çështja është paraqitur para arbitrazhit apo për vendim të Ekspertit (sipas rastit në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate), atëherë vendimi i panelit të arbitrazhit apo Ekspertit do të jetë detyrues për Palët dhe Kontraktori do të ketë një afat shtesë prej tre (3) Muajsh nga ky moment, për të marrë masa për ndreqjen e shkeljes së procedurave të kryera nga Kontraktori.

24.2.2 Në rast se Kontraktori nuk përputhet në mënyrë thelbësore me çfarëdo vendimi përfundimtar që rezulton nga një procedurë arbitrazhi sipas Nenit 21 të kësaj Kontrate brenda afatit të parashikuar në këtë Kontratë apo përndryshe brenda një kohe të arsyeshme; apo

24.2.3 Në rast se Kontraktori është shpallur në falimentim me vendim të gjykatës kompetente apo në rast se ekziston më shumë se një subjekt që përbëjnë Kontraktorin dhe njëri prej tyre është deklaruar në falimentim nga

vendimi i gjykatës kompetente e asnjë nga subjektet apo entet nuk ndërmerr veprimet e duhura për të siguruar se një falimentim i tillë nuk do të cënojë negativisht aftësinë e Kontraktorit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate.

24.2.4 Kontraktori depoziton tek Albpetrol dhe AKBN të dhëna fallso financiare, teknike apo administrative.

24.2.5 Kontraktori nuk dorëzon tek AKBN Garancinë Bankare në përputhje me Nenin 29.3, thelbësisht në formën e paraqitur në Aneksin E

24.2.6 Kontraktori nuk e njofton Albpetrolin për qëllimin e tij për të hyrë në Fazën e Dytë ose të Tretë të Kërkimit sipas neneve 4.1.2 dhe 4.1.3 të kësaj Kontrate

24.2.7 Në çdo rast tjetër që përmendet në këtë Kontratë.

24.3 Përveç zgjidhjes përpara afatit sipas Nenit 24.1 apo 24.2, kjo Kontratë do të zgjidhet automatikisht në tërësinë e saj në rast se është hequr dorë nga e gjithë Zona e Kontratës apo Periudha e Zhvillimit dhe Prodhimit apo çdo zgjatje afati tjetër ka përfunduar sipas Nenit 6.10.

25 MBROJTJA E MJEDISIT

25.1 Pavarësisht nga parashikimet e neneve 18.4 e 23.5, Kontraktori do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Kontraktori do të ndërrmarrë të gjitha masat e duhura që janë në kontrollin e tij në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me masat e pranuara ndërkombëtare për shmangien dhe minimizimin e ndotjes mjedisore me qëllim që një ndotje e tillë të shkaktojë një degradim sa më të vogël të arsyeshëm të mundur në cilësinë e jetës apo shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe bimëve.

25.2 Kontraktori është i vetmi person përgjegjës për të bërë përpjekjet për zbatimin e programeve të pranuara ndërkombëtare e të përpiqet të eliminojë apo minimizojë ndotjen e mjedisit. Në rast se Kontraktori nuk është në gjëndje të shmagë ndotjen e mjedisit ai do të jetë përgjegjës në çdo rast për dëmet e shkaktuara si edhe për kryerjen e veprimeve të arsyeshme për të rehabilituar nëpërmjet veprimeve të tij gjatë Operacioneve Hidrokarbure zonën e ndotur në kushtet në të cilat ajo gjendej në Datën e Hyrjes në Fuqi, sa më shumë të jetë e mundur, siç kërkohet nga ligjet dhe rregulloret Shqiptare në fuqi e të zbatueshme në industrinë e naftës dhe të gazit si edhe në përputhje me Praktikat e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure.

25.3 Albpetroli dhe AKBN-ja mund të inspektojnë rekordet mbi perputhshmerine me këtë nen 25, në çdo kohë të arsyeshme që nga data e Hyrjes në Fuqi dhe deri 6 muaj pas zgjidhjes.

26 GJUHA ANGLEZE DHE SHQIPTARE

Versionet në gjuhën Angleze dhe Shqip të kësaj Kontrate kanë të njëjtën vlerë ligjore për leximin dhe interpretimin e kësaj Kontrate; megjithatë, në rast konflikti që lidhet me leximin apo interpretimin, versioni në gjuhën Angleze do të mbizotërojë.

27 PAGESAT E BONUSIT

27.1 Kontraktori do t'i paguajë Albpetrolit në para e vetëm një here një bonus nënshkrimi prej Njëqind Mijë Dollarë Amerikanë (U.S. $100.000) brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas Datës së Hyrjes në Fuqi. Bonus inënshkrimit s'do të jetë kosto e rekuperueshme.

27.2 Kontraktori do t'i paguajë Albpetrolit bonuse prodhimi në para sipas planit të mëposhtëm:

-	Fillimi	100.000 US$
-	15.000 BOPD	1.500.000 US$
-	30.000 BOPD	2.500.000 US$
-	45.000 BOPD	3.000.000 US$

27.3 Secila nga këto pagesa do të kryhet brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e parë në të cilën prodhimi arrin një nga shkallët e sipërmendura të prodhimit ditor.

28 LEJET QEVERITARE, DATA E HYRJES SË FUQI

28.1 Kjo Kontratë do të jetë detyruese për Palët që nga Data e Hyrjes në Fuqi. Albpetroli do ta njoftojë dhe do t'i sigurojë Kontraktorit një kopje të dokumentit që vërteton miratimin e kësaj Kontrate nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, brenda dhjetë (10) ditësh pune nga Data e Hyrjes në Fuqi.

29 TË NDRYSHME

29.1 Përveçse kur parashikohet shprehimisht në Nenin 9, subjektet që përbëjnë Kontraktorin mbajnë përgjegjësitë dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate, individualisht e veçmas nga njëri tjetri.

29.2 Dështimi i ndonjë Pale për të ushtruar apo për të kërkuar zbatimin e ndonjë të drejte sipas kësaj Kontrate, nuk do konsiderohet si heqje dorë nga secila prej këtyre të drejtave.

29.3 Brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga Data e Hyrjes në Fuqi, Kontraktori do të mundësojë ekzekutimin dhe dorëzimin tek AKBN të një garancie bankare thelbësisht në formatin që i bashkëngjitet dhe është pjesë përbërëse e kësaj Kontrate si Aneksi "E".

Në rast se Kontraktori vendos të hyjë për Periudha pasuese Kërkimi, Kontraktori do të ekzekutojë dhe do t'I dorëzoje AKBN-së, jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë pas këtij

vendimi, një garanci bankare që mbulon të gjithë Shpenzimet e Kërkimit që aplikohen për Planin minimal të Punës lidhur me Periudhën e Kërkimit të atëhershme, thelbësisht në formën që bashkëngjitet këtu e cila është pjesë përbërëse e kësaj Kontrate si Aneksi "E".

Garancia bankare do të lëshohet nga një bankë shqiptare ose nga një prej njëzet (20) bankave më të mira ndërkombëtare, sipas klasifikimit të edicionit më të fundit të Global Finance Magazine (Çmimi i Bankave më të Mira - botimi i fundit)

29.4 Në lidhje me Garancinë Bankare që referohet në Nenin 29.3 më lart, AKBN, duke filluar nga tre (3) muaj pas Datës së Hyrjes në Fuqi dhe në një interval prej çdo tre-muajsh (3) pas kësaj, siç është rënë dakord ndërmjet Palëve, do t`i dorëzojë Kontraktorit një deklaratë me shkrim të shpenzimeve që ka përballuar Kontraktori gjatë periudhës prej tre-muajsh të mbuluar nga një deklaratë e tillë dhe të pranuar nga AKBN si e vlefshme për përmbushjen e detyrimeve të Planit të Punës nga ana e Kontraktorit për Fazën e Parë të Kërkimit dhe, sipas rastit, Fazën e Dytë të Kërkimit dhe Fazën e Tretë të Kërkimit.

29.5 Sjellja e palëve

29.5.1 Dispozitat Anti – Korrupsion

29.5.1.1 Deklaratat e Përgjithshme dhe Garancitë:

29.5.1.1.1 Asnjë nga Palët apo nënshkruesit e kësaj Kontrate nuk do të lejojnë apo mundësojnë ofrimin, premtimin, dhënien apo shkaktimin e dhënies, qoftë në mënyrë të drejpërdrejtë apo indirekt, të asnjë ryshfeti, dhurate (përveç vlerës nominale), huaje, tarife, shpërblimi apo argëtimi të një natyre dhe kosto e të cilave nuk është as e përshtatshme dhe as e arsyeshme, në favor të një prej Palëve, Zyrtarëve Publikë, çdo kontraktori apo çdo pale tjetër të tretë, lidhur me këtë Kontratë apo operacionet që lidhen me të.

29.5.1.1.2 Gjithashtu dhe pavarësisht nga sa më lart, secila Palë, në bazë të parimeve të Konventës për Luftën kundër Korrupsionit të Zyrtarëve Publikë të Huaj në Transaksionet Financiare Ndërkombëtare, nënshkruar në Paris më 17 Dhjetor 1997 e cila ka hyrë në fuqi më 15 Shkurt 1999 dhe Komentareve të Konventës (bashkarisht si **"Konventa OECD"**) deklaron dhe garanton se ajo dhe Shoqëritë e Lidhura dhe Përfaqësuesit e saj nuk kanë paguar, kryer, ofruar, dhënë, premtuar apo autorizuar si edhe nuk do të paguajnë, kryejnë, ofrojnë, japin, premtojnë apo autorizojnë lidhur me këtë Kontratë dhe çështjet objekt

i kësaj Kontrate, direkt apo indirekt, asnjë komision, para, pagesë dhuratë, premtim apo gjithçka me vlerë për apo për përdorim të apo në favor të Zyrtarëve Publikë me qëllim për të:

- Influencuar një veprim, mosveprim apo vendim të Zyrtarëve Publikë në cilësinë e tyre zyrtare.
- siguruar një përfitim të papërshtatshëm nga një Zyrtar i tillë Publik; apo
- shtyrë një Zyrtar të tillë Publik për të përdorur autoritetin e tij tek një Zyrtar tjetër Publik apo Autoritet Shtetëror me qëllim influencimin e akteve zyrtare apo vendimit lidhur me këtë Kontratë apo veprimet lidhur me të, për dhënien e biznesit tek një Person apo përfitimin dhe ruajtjen e bizensit lidhur me këtë Kontratë;

kur kjo pagesë, dhuratë, premtim apo përftim i tillë ka shkelur më parë apo do të shkelte ligjet e zbatueshme të Republikës së Shqipërisë; (bashkarisht me çdo legjislacion tjetër të zbatueshëm "Legjislacioni Antikorrupsioni") pavarësisht nëse kjo Palë, Shoqëri e Lidhur ose Përfaqësues është subjekt i një prej Legjislacioneve të sipërmendura të Antikorrupsionit apo ndryshimeve të tyre të mëvonshme.

Palët pranojnë se secila nga Palët do të bëjë të gjitha përpjekjet për shmagjen e pagesave në mbështetje të pagesave favoruese me përjashtim kur kërcënohet shëndeti, siguria apo jeta e një pronari, zyrtari, drejtori apo punëtori të Palës.

29.5.2 Kontrollet e Brendshme

Secila Palë pranon se (1) do të kryejë kontrollet e brendshme të duhura; (2) do të regjistrojë siç duhet dhe do të raportojë të gjitha transaksionet; (3) do të respektojë të gjithë ligjet e zbatueshme përkundrejt saj. Secila Palë duhet të mbështetet në sistemin e kontrolleve të brendshme të Palës tjetër si edhe në saktësinë e paraqitjes së plotë të fakteve dhe të dhënave financiare dhe të tjera lidhur me operacionet që lidhen me to apo që kryhen sipas kësaj Kontrate. Asnjëra nga Palët nuk është e autorizuar të kryejë asnjë veprim për llogari të Palës tjetër i cili mund të rezultojë në një regjistrim apo raportim të papërshtatshëm apo të pasaktë të aktivit, pasivit apo çdo transaksioni tjetër apo që do të shkaktonte që kjo Palë të

rezultojë në shkelje të detyrimeve të saj sipas Legjislacionit të Antikorrupsionit apo ligjeve të tjera të zbatueshme për operacionet sipas kësaj Kontrate.

29.5.3 Të Drejtat e Auditit:

Gjatë afatit të kësaj Kontrate dhe për një periudhë prej pesë (5) vitesh pas zgjidhjes së saj, secila nga Palët, në kohën e duhur do t'i (i) përgjigjet me detaje të arsyeshme mbi veten e saj, Shoqëritë e Lidhura dhe Përfaqësuesit, çdo njoftimi nga Pala tjetër që lidhet në mënyrë të arsyeshme me deklaratat dhe garancitë në këtë Nen 29.5; (ii) sigurojë dokumentacionin mbështetës të zbatueshëm për këtë përgjigje me kërkesë të Palës tjetër; dhe (iii) në përgjithësi, do të bashkëpunojë në mirëbesim me Palën tjetër për të përcaktuar nëse ka ndodhur një shkelje e deklaratave dhe garancive.

Kur një Palë ka dijeni apo dyshime për shkelje të deklaratave dhe garancive sipas Nenit 29.5.1, kjo Palë ka të drejtën e aksesit në librat dhe regjistrat, përfshirë por pa u kufizuar në të dhënat financiare të Palës në fjalë lidhur me çështjen objekt të kësaj Kontrate si edhe të mbajë kopje të tyre në kufijtë përkatës të këtij Neni. Ky rishikim apo auditim i librave dhe regjistrave do të kryhet në çdo kohë nga Pala që bën kërkesën apo personeli i palëve të treta të përzgjedhur nga Pala kërkuese në çdo kohë me njoftim paraprak me shkrim.

Ky akses, auditim dhe rishikim do të jetë i arsyeshëm përsa i përket qëllimit, vendit, datës dhe orës. Çdo vonesë e Palës në ushtrimin e të drejtave që përcaktohen në këtë paragraf nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga këto të drejta.

29.5.4 Vërtetimi Vjetor

Secila nga Palët do të lëshojë një vërtetim vjetor ku deklaron se kjo Palë, Shoqëritë e Lidhura apo Përfaqësuesit e saj nuk kanë shkelur kushtet e këtij Neni. Secila nga Palët do të përgatisin një vërtetim vjetor ku deklaron se kjo Palë, Shoqëritë e Lidhura apo Përfaqësuesit e saj nuk kanë shkelur kushtet e këtij Neni 29.5.1 apo nuk kanë kryer asnjë veprim të ndaluar nga Legjislacioni për Antikorrupsionin.

29.5.5 Dhënia e informacionit:

Secila Palë pranon se dhënia e informacionit të plotë për ekzistencën dhe kushtet e kësaj Kontrate si edhe çdo informacioni tjetër nga Palët në përputhje me kushtet e Nenit 29.5 mund të kryhet në çdo kohë e për çfarëdolloj arsye tek cilido nga këshilltarët e tyre përkatës të cilët përcaktojnë se ka arsye legjitime për të marrë dijeni mbi këto kushte apo

informacione, përfshirë por pa u kufizuar në Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, Mbretërinë e Bashkuar apo Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

29.6 Njoftimet sipas kësaj Kontrate do të dërgohen tek Pala e kësaj Kontrate në adresën e saj postare apo numrin e faksit apo në vëmendje të personit që përcaktohet më poshtë:

(a) **Albpetrol**

ALBPETROL SH.A
Rruga Nacionale Fier-Patos Km 7
Patos, Fier
ALBANIA

Në vëmendje të: Z. Endri Puka
Tel: +355
Fax: +355

endri.puka@albpetrol.al

(b) **Contractor**

PENNINE PETROLEUM CORPORATION
315 39th Avenue SE
Calgary, Alberta
CANADA
T2G 1X5
Tel: +1 403 277 4421
Fax: +1 403 277 4439

Në vëmendje të: Z. Desmond Smith

Des.smith@penninecorp.com
Mobile: +1 403 978 9066

29.7 Kjo Kontratë (bashkë me çdo dokument që referohet këtu) përbën të gjithë marrëveshjen dhe reflekton vullnetin midis Palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet apo kontratat e mëparshme (qoftë me shkrim apo verbale) në lidhje me çështjen objekt të saj.

29.8 Në rast të një konflikti të kësaj Kontrate me Licencë Marrëveshjen, Albpetroli dhe Kontraktori bien dakord që është kjo Kontratë ajo që prevalon dhe në rast të një konflikti të tille AKBN dhe Albpetrol do të amendojnë Licencë Marrëveshjen në menyrë që të jetë konform kësaj Kontrate.

NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, kjo Kontratë u nënshkrua rregullisht nga Palët përkatëse në datën e përcaktuar në fillim.

Albpetrol sh.a.

Nga: Endri Puka

Titulli: Administrator

Pennine Petroleum Corporation

Nga: N. DESMOND SMITH

Titulli: CHIEF EXECUTIVE OFFICER

PENNINE PETROLEUM CORPORATION CORPORATE SEAL

ANEKSI A

Përshkrimi i Zonës së Kontratës

Zona e Kontratës e mbuluar dhe e prekur nga kjo Kontratë përbëhet, në Datën e Hyrjes në Fuqi, nga Zona e kufizuar në pikat e mëposhtme, gjithashtu e treguar në hartë në ANEKSIN "B"

1.	40º 25' 00" V	19º 37' 00" L;
2.	40º 25' 00" V	19º 43' 25" L;
3.	40º 21' 00" V	19º 43' 00" L;
4.	40 º20'00"V	19 º45'00" L
5.	40º 14' 00" V	19º 58' 00" L;
6.	40º 14' 00" V	19º 37' 00" L;

ANEKSI B
Harta e Zonës së Kontratës



Figure 1 Blocks with respective co-ordinates

Figura 1 Blloqet me koordinatat respektive

ANEKSI C
Procedura e kontabilitetit

Kapitulli I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

I.1 Qëllimi dhe Përkufizime

Përkufizimet që përmbahen në Nenin 1 të Kontratës do të zbatohen edhe për këtë Procedurë Kontabiliteti dhe do të kënë të njejtin kuptim.

I.2 Dokumetacioni Kontabël

I.2.1 Kontraktori do të mbajë dokumentacionin kontabël në përputhje me Nenin 13 të Kontratës dhe me praktikat përgjithësisht të pranueshme të kontabilitetit të përdorura në industrinë ndërkombëtare të hidrokarbureve.

I.2.2 Kontraktori do të hapë dhe mbajë dokumentacion të vecantë të identifikueshëm të kontabilitetit që mund të jetë i nevojshëm për të dokumentuar, në mënyrë të plotë dhe të duhur, gjithë kostot në lidhje me Kontratën dhe gjithë kreditë e marra nga Kontraktorët në lidhje me Operacionet Hidrokarbure.

I.2.3 Librat e llogarisë do të mbahen në Dollarë Amerikane dhe në Lekë ("ALL"), në përputhje me Nenin 13.2 të Kontratës. Çdo humbje apo fitim që rezulton nga këmbimi i monedhës të kërkuar për Operacionet Hidrokarbure të Kontraktorit ose nga konvertimet përkatëse nga një monedhë në tjetrën do t'i ngarkohet apo kreditohet kostove të mbulueshme.

I.3 Deklarata e Aktiviteteve

I.3.1 Kontraktori do t'i japë Albpetrol-it dhe AKBN-së, sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se dyzetëepesë (45) Ditë nga fundi i çdo Tremujori Kalendarik, një Deklaratë të Aktivitetit të Kërkimit sipas Nenit 4.8 të Kontratës. Kjo deklaratë do të reflektojë gjithë debitimet dhe kreditimet që lidhen me Shpenzimet e Kërkimit për atë Tremujor Kalendarik të përmbledhura në klasifikimin e specifikuar në Kapitullin II të Procedurës së Kontabilitetit.

I.3.2 Kontraktori do t'i japë Albpetrol-it dhe AKBN-së, sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se dyzetëepesë (45) Ditë nga fundi i çdo Tremujori Kalendarik, një Deklaratë e Aktivitetit të Zhvillimit sipas Nenit 6.13 të Kontratës, që reflekton gjithë debitimet dhe kreditimet që lidhen me Zhvillimin dhe Prodhimin për atë Tremujor Kalendarik ("Shpenzimet e Zhvillimit dhe Shpenzimet Operative") të përmbledhura në klasifikimet e duhura që tregojnë natyrën e tyre.

I.3.3 Brenda tridhjetë (30) ditëve nga Data e Hyrjes në Fuqi Kontraktori duhet të paraqesë për miratim në Albpetrol dhe AKBN një propozim të listave të llogarive, të dhënat operative dhe raportet të cilat do të reflektojnë secilën

nga kategoritë dhe nën-kategoritë e kostove dhe shpenzimeve të përcaktuara në këtë dokument. Brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja në dorëzim e dokumentave sipërpërmendur Albpetrol në konsultim me AKBN ose do të sugjerojë miratimin e propozimit ose të kërkojë rishikime të propozimit. Brenda 90 ditëve pas Datës se Hyrjes në Fuqi Kontraktori dhe Albpetrol në konsultim me AKBN do të bien dakort në udhëzimet e listatave të llogarive, të dhënave operative dhe raporteve të cilat do të përshkruajnë bazat e sistemit dhe procedurave të kontabilitetit që do të zhvillohen dhe përdoren sipas Kontratës.

1.4. Auditimet dhe Rregullimet

I.4.1 Çdo zë i kostos në një Deklaratë të Aktivitetit të Kërkimit do të gjykohet në mënyrë përfundimtare si Kosto e Miratuar pas njëzetë (24) Muajsh në vijim të marrjes së asaj Deklarate nga Albpetrol, nëse brenda njëzetë (24) Muajve në fjalë Albpetrol nuk i përjashton nëpërmjet auditimit me shkrim të tyre në përputhje me Nenin 4.8 të Kontratës. Në këtë rast, Albpetrol dhe Kontraktori do të bisedojnë në kohë dhe do të përpiqen të arrijnë një zgjidhje brenda 2 muajsh, gjatë së cilës Palët në fjalë do të identifikojnë Kostot e Refuzuara dhe Kostot e Pezulluara që rezultojnë nga një auditim i tillë.

I.4.2 Çdo zë i kostos në një Deklaratë të Aktivitetit të Zhvillimit do të gjykohet në mënyrë përfundimtare si Kosto e Miratuar pas njëzetë e katër (24) Muajsh në vijim të marrjes së asaj Deklarate nga Albpetrol, nëse brenda njëzetë e katër (24) Muajve në fjalë Albpetrol nuk i përjashton nëpërmjet auditimit me shkrim të tyre. Në rast se Albpetrol bën përjashtime të tilla nëpërmjet auditimit me shkrim, Albpetrol dhe Kontraktori do të bisedojnë në kohë dhe do të përpiqen të arrijnë një zgjidhje, gjatë së cilës Palët në fjalë do të identifikojnë Kostot e Refuzuara dhe Kostot e Pezulluara që rezultojnë nga një auditim i tillë.

I.4.3 Albpetrol do të bëjë çdo përpjekje të arsyeshme për të kryer auditimet në një mënyrë që do të rezultojë sa më e pranueshme për Kontraktorin dhe Operacionet Hidrokarbure të Kontraktorit. Kontraktori do të bëjë çdo përpjekje të arsyeshme të bashkëpunojë me Albpetrol, dhe do të sigurojë asistencën dhe lehtësitë e arsyeshme, siç mund të jetë e përshtatshme.

I.4.4 Gjithë rregullimet që rezultojnë nga një auditim do të korrigjohen menjëherë në Deklaratën pasardhëse të Aktiviteteve nga Kontraktori dhe të raportuar tek Albpetrol. Nëse do të lindi ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me një auditim, ajo do të diskutohet nga Albpetrol dhe Kontraktori dhe nëse nuk zgjidhet, zëri apo zërat objekt mosmarrëveshjeje do të zgjidhen nëpërmjet arbitrazhit ose një eksperti siç parashikohet në Nenin 21 të Kontratës.

I.5 Nëse një Palë nuk arrin të bëjë ndonjë pagesë sipas dispozitave të kësaj Kontrate brenda kohës së specifikuar për një pagesë të tillë, nëse nuk është përcaktuar ndryshe në këtë Kontratë, atëherë ajo Palë do të shtojë interesin për pagesën e vonuar me normë vjetore dy presje pesë përqind (2.5%) më të lartë se Kursi i London Interbank Borroëing Offered ("LIBOR") për depozitat tre (3) Mujore të Dollarit Amerikan të cituar nga Zyra e Londrës e Citibank (ose ndonjë Bankë tjetër që Palët

mund të bien dakort) afërsisht në orën 11:00 paradite me orën e Londrës për ditën apo ditët që do të zbatohet përqindja.

I.6 Bazat e Përllogaritjeve

I.6.1 Të gjitha librat, llogaritë dhe regjistrat do të përgatitet në baza përllogaritjesh. Të ardhurat e Kontratës do t'i atribuohen periudhës kontabël në të cilën ato janë fituar, dhe kostot dhe shpenzimet në periudhën kontabël në të cilën ato janë kryer, pa nevojën për të veçuar nëse është marrë ose disbursuar kesh në lidhje me një transaksion të veçantë.

I.6.2 Kostot dhe shpenzimet do të konsiderohen si të ndodhura, në rastin e artikujve fizike, në periudhën kontabël, kur Kontraktor-i fiton titullin mbi ato, dhe në rastin e shërbimeve, në periudhën kontabël, kur këto shërbime janë kryer.

KAPITULLI II. KOSTOT, SHPENZIMET DHE HARXHIMET

Në varësi të dispozitave të Kontratës, Kontraktori do të mbartë dhe paguajë, vetëm dhe drejtpërdrejt apo përmes Shoqëritë te Lidhura të tyre, kostot dhe shpenzimet e mëposhtme, kosto dhe shpenzime të cilat do të trajtohen dhe mbulohen nga Kontraktori në përputhje me Nenin 7 të Kontratës me kusht që ato të mos jenë bërë para Datës se Hyrjes në Fuqi përveç atyre shpenzimeve që lidhen me një Program Pune për Periudhën e Kërkimit, siç bihet dakort nga AKBN.

II.1 Pagesat për Qeverinë

Gjithë pagesat, qiratë, tatimet, rinovimet dhe pagesat e zgjatjeve e pagesa të tjera të çdo lloji apo natyre paguar qeverisë nga Kontraktori sipas kushteve të Kontratës, përveç bonuseve të prodhimit të paguara në përputhje me Nenin 27 të Kontratës.

II.2 Kostot e Personelit

II.2.1 Pagat dhe rrogat e punonjësve të Kontraktorit të angazhuar drejtpërdrejt në Operacionet Hidrokarbure, duke përfshirë pagat apo rrogat e paguara punonjësve të huaj të Kontraktorit që caktohen përkohësisht dhe punësohen në këto operacione. Sipas këtij Nën-neni II.2.1, Kontraktori ka të drejtën të ngarkojë mbi bazë mujore koston e gjithë personelit të angazhuar në Operacionet Hidrokarbure.

II.2.2 Kostot e Kontraktorit për lejet, pushimet, dietat për jetesën dhe strehimin, udhëtimin, bonuset dhe dieta të tjera të aplikueshme ndaj pagave dhe rrogave të punonjësve të ngarkueshme sipas Nën-nenit II.2.1 dhe Nenit II.11 dhe II.12 të këtij KAPITULLI II.

II.2.3 Shpenzimet apo kontributet e bëra në përputhje me ligjin apo tatimet e vëna nga autoritetet qeveritare që zbatohen për koston e punës së Kontraktorit apo pagat e rrogat siç parashikohet në Nën-nenet II.2.1 dhe II.2.2 dhe Nenit II.11 dhe II.12 të këtij KAPITULLI II.

II.2.4 Kostoja e mirëmbajtjes së çdo zyre, nën-zyre, kampe, shtëpi banimi dhe mjedise të tjera të Kontraktorit dhe/apo Filialeve të cilat u shërbejnë direkt Operacioneve Hidrokarbure. Nëse keto mjedise u shërbejnë operacioneve përveç operacioneve Hidrokarbure, kostot do te alokohen në pronat e përdorura mbi një bazë të barabartë.

II.3 Përfitimet e Punonjësve

Kosto e Kontraktorit për planet e sigurimit të jetës në grup të punonjësve, shërbimin mjeksor, paaftësinë, shtrimin në spital, pensionin, blerjen e aksioneve, kursimet dhe përfitime të tjera të një natyre të ngjashme për punonjësit e huaj dhe punonjësit vendas, të gjitha ngarkohen sipas Nën-neneve II.2.1 dhe II.2.2 dhe Neneve II.11 dhe II.12 të këtij KAPITULLI II. Pagesa për shkurtimet nga puna do të bëhet me një përqindje fikse të zbatueshme mbi borderonë e pagave, e cila do të jetë e barabartë me një sasi ekuivalente me detyrimin për pagesat për shkurtimet nga puna, siç kërkohet nga detyrimet e Kontraktorit sipas Kodit të Punës Shqiptar.

II.4 Materialet

Materialet, paisjet dhe furnizimet e blera apo furnizuara nga Kontraktori për përdorim në Operacionet Hidrokarbure.

II.4.1 Blerja

Materialet dhe paisjet e blera do të ngarkohen me çmimin e paguar nga Kontraktori pas zbritjes së gjithë skontove të marra realisht nga Kontraktori apo Shoqëritë e Lidhura të tyre. Çmimi do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në, kosto të tilla si tarifat e prokurimit të palëve të treta, pagesat e inspektimit dhe spedicionit, pagesat e agjentëve të eksportit, pagesat e transportit, pagesat e sigurimeve, pagesat e ngarkim shkarkimit, taksat e importit dhe të licensave, dhe gjithë zërat e tjera që zakonisht shoqërohen me prokurimin e materialeve dhe paisjeve dhe taksat e aplikueshme.

II.4.2 Materialet e furnizuara nga Kontraktori

Materialet e kërkuara për Operacionet Hidrokarbure do të blihen direkt sa herë që është praktikisht e mundshme, përveç kur Kontraktori mund t'i importojë këto materiale nga materialet në magazinë të Kontraktorit apo të Shoqërive te Lidhura të Kontraktorit jashtë Shqipërisë sipas kushteve te mëposhtme:

II.4.2.1 Material i Ri (Kategoria "A")

Materiali i Ri i transferuar nga magazinat apo pronat e tjera te Shoqërive te Lidhura të Kontraktorit do të çmohet sipas kostos minus çdo skonto të bërë, me kusht që kostua e furnizimeve materiale te mos jetë më e lartë se çmimet ndërkombëtare për materiale te një cilësie të ngjashme të furnizuara me kushte të ngjashëm që mbizotërojnë në kohën kur u porositën këto materiale.

II.4.2.2 Materiale të përdorura (Kategoria "B" dhe "C") që do të përdoren me miratimin e AKBN-së.

II.4.2.2.1 Materialet që janë në gjendje të mirë dhe të përdorshëm për ripërdorim pa u riparuar do të klasifikohen si Kategoria "B" dhe çmohen me shtatëdhjetë e pesë përqind (75%) të çmimit të materialit të ri. Kjo kategori do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në, materiale që kanë kaluar në një proces riparimi dhe janë restauruar në gjendje të plotë pune.

II.4.2.2.2 Materialet që nuk mund të klasifikohen si Kategoria "B", por që janë në gjendje pune për funksionin e tyre fillestar, por jo mjaft të përshtatshme për riparim, do të klasifikohen si Kategoria "C" dhe çmohen me pesëdhjetë përqind (50%) të çmimit të materialit të ri.

II.4.4.4.3 Materialet që nuk mund të klasifikohnt si Kategori "B ose "C" do të çmohen me një vlerë proporcionale me përdorimin e tij.

II.4.3 Çmimet premium

Sa herë që materiali nuk është i gatshëm të sigurohet në pikat e zakonshme të furnizimit dhe me çmimet e specifikuara në Nën-nenet 4.1 dhe 4.2 të këtij Neni 4 për shkak të emergjencave kombëtare, grevave apo shkaqe të tjera të pazakonta, Kontraktori mund të paguajë për materialin e kërkuar mbi bazën e kostove e shpenzimeve direkte të Kontraktorit të realizuara në prokurimin e këtyre materialeve, në përshtatjen e tyre për përdorim dhe në lëvizjen e tyre në vendpërdorim.

II.4.4 Garancia e materialeve të blera apo furnizuara nga Kontraktori

Kontraktori nuk garanton materialin. Garancia e vetme për materialin e blerë apo furnizuar nga Kontraktori është garancia e furnizuesit apo prodhuesit; në rast të materialeve difektoze, kreditimi do të kalohet siç merret nga ose në përputhje me garancinë e furnizuesit apo prodhuesit, kur rregullimi, për Kontraktorin, është bërë nga nga furnizuesi apo prodhuesi.

II.5 Transporti

Transporti i punonjësve, paisjeve, materialeve dhe furnizimeve të nevojshme për kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure. Ky përfshin gjithë kostot e transportit dhe rivendosjes së punonjësve, por vetëm në atë masë që mbulohen nga politikat e miratuara të Kontraktorit, duke mos përfshirë shpenzime udhëtimi për punonjësit dhe familjet e tyre në kohën e punësimit, në kohën e ndërprerjes së marrdhënieve dhe për pushimet dhe si rezultat i transferimit nga një vend në tjetrin. Këto kosto do

të përfshijnë gjithashtu transportin e sendeve vetjake e paisjeve shtëpiake dhe gjithë kostot e tjera të rivendosjes.

Transportimin e Hidrokarbureve deri tek Pika e Levrimit përkatese, duke përfshire pa kufizim pagesat për tubacione (si fikse dhe variabel) dhe kostot e transporit me autobot.

II.6 Shërbimet

II.6.1 Kostot e konsulentëve, shërbimeve të kontraktuara dhe produkteve të prokuruara nga palët e treta.

II.6.2 Kostot e perdorimit të mjeteve dhe pajisjeve brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë për përfitim direkt te Opracioneve Hidrokarbure te furnizuara nga Kontraktori ose Kompanitë e Lidhura të tij ose palë të treta me tarifa të krahasueshme me koston e pronësisë, ose të marrjes me qera, dhe koston e operimit të saj.

II.7 Shpenzimet Administrative

Shpenzimet administrative të kompanisë mëmë të Kontraktorit jashtë Republikës së Shqiperisë të aplikueshme ndaj operacioneve sipas kesaj Kontrate do të ngarkohen çdo vit ne përputhje me tarifën e mëposhtme:

Personeli i kompanisë mëmë të Kontraktorit të cilët janë të angazhuar në administrimin e aktiviteteve te Kontraktorit ne lidhje me Operacionet Hidrokarbure do të rregjistrojnë kohen e shpenzuar në lidhje me këtë administrim. Do të kete një pagesë në Shpenzimet Hidrokarbure për kohën e shpenzuar nga sejcili nga ky personel, e llogaritur si më poshtë: koha për këtë personel e shpenzuar në çdo muaj në administrimin e Operacioneve Hidrokarbure do të ndahet me kohen totale të sejcilit person te harxhuar mbi të gjitha cështjet në atë muaj, dhe fraksioni do të shumëzohet me shumën e kostove të pagave dhe kostot e përfitimit të këtij personeli.

Në asnjë rast - shuma e ngarkuar Kostove Hidrokarbure sipas këtij Neni 6.1 nuk mund të kalojë 350,000 US$ në Vitin Kalendarik 2017, dhe në çdo Vit Kalendarik pasues, 350,000 US$ të rregulluara për inflacion duke përdorur Indeksin e Çmimit të Konsumatorëve në U.S.A.

II.8 Dëmet dhe Humbjet

Gjithë kostot dhe shpenzimet e nevojshme për të zevendësuar apo riparuar dëmet apo humbjet e pësuara nga zjarri, përmbytjet, stuhia, aksidentet apo çdo shkak tjetër që nuk rezultojnë drejtpërdrejt nga neglizhencë e rëndë e Kontraktorit ose veprim i tij i qëllimshëm. Kontraktori do t'i japë Albpetrol-it dhe AKBN-së një njoftim me shkrim të dëmeve apo humbjeve të pësuara sa më shpejt që të jetë e mundur pasi është marrë raporti për të njëjtën gjë nga Kontraktori.

II.9 Shpenzimet Ligjore

II.9.1 Gjithë kostot dhe shpenzimet e gjyqeve, apo shërbimet ligjore të nevojshme apo të përshtatshme për ruajtjen e interesit të Kontraktorit në Zonën e Kontratës ose në kuadrin dhe në përputhje me Kontratën, duke përfshirë tarifën dhe shpenzimet e avokatit siç parashikohet këtu më poshtë, së bashku me gjithë gjykimet e marra kundër Kontraktorit ose në llogari të Operacioneve Hidrokarbure dhe shpenzimet reale të kryera nga Kontraktori në sigurimin e dëshmive për qëllime të mbrojtjes kundrejt çdo veprimi apo pretendimi të paditur apo të nxitur kundrejt Operacioneve Hidrokarbure apo përmbajtjes së Kontratës, me kusht që këto shpenzime nuk lidhen me mosmarrëveshje që mbeten të pasuksesshme midis Kontraktorit me Albpetrol-in dhe/ose AKBN-në dhe/ose me palë të treta.

II.10 Taksat

Taksat, detyrimet apo pagesat të vlerësuara apo vjela mbi ose në lidhje me operacionet në kuadrin e kësaj Kontrate, përveç atyre të mbuluara nga Neni 9 i Kontratës.

II.11. Sigurimet dhe pretendimet

II.11.1 Primet e paguara për çdo detyrim publik, dëmtim prone dhe sigurime të tjera të bëra nga Kontraktori, së bashku me gjithë shpenzimet e bëra dhe paguara në zgjidhjen e çdo dhe gjithë humbjeve, pretendimeve, dëmeve, gjykimeve dhe shpenzime të tjera, të pa mbuluara nga mbajtësi i sigurimit.

II.11.2 Nëse objekti ose fenomeni nuk janë të mbuluar nga siguracioni, shpenzimet faktike të kryera dhe paguara nga Kontraktori në zgjidhjen e çdo dhe gjithë humbjeve, pretendimeve, dëmeve, gjykimeve dhe shpenzime të tjera, duke përfshirë shërbime ligjore.

II.11.3 Gjithë zgjidhjet që lindin nga pretendimet e Kontraktorit kundrejt siguruesve, për siguracionin e bërë në përfitim të Operacioneve Hidrokarbure, do t'i kreditohen kostove të mbulueshme në muajin në të cilin janë marrë.

II.12 Administrata lokale / Zyrat në vendburim

Pagat dhe shpenzimet e drejtuesve dhe punonjësve të tjerë të Kontraktorit, të vendosur në Shqipëri, që i shërbejnë Operacioneve Hidrokarbure, koha e të cilëve nuk i ngarkohet direkt Operacioneve Hidrokarbure dhe kostua e mirëmbajtjes dhe përdorimit të zyrave të Kërkimit dhe/ose Prodhimit dhe nën-zyrave të nevojshme (duke përfshirë objekte strehimi për punonjësit, nëse kërkohet) të përdorura në kryerjen e këtyre Operacioneve Hidrokarbure. Këto pagesa do të jenë në proporcion të barabartë për gjithë Zonat e Kontratave, nëse është e aplikueshme.

II.13 Pagesat për mbajtjen në magazina

Në rast se kërkohen objekte magazinimi për të kryer Operacionet Hidrokarbure, gjithë kostot që nevojiten për të ngritur dhe mirëmbajtur magazinën dhe gjithë kostot e realizuara në trajtimin e materialeve në magazinë.

II.14 Shpenzime të tjera

Çdo kosto dhe shpenzim tjetër, të duhura dhe të përshtatshme, duke përfshirë pa u kufizuar në, blerjen e të drejtave për pasuri të paluajtshme për Operacionet e Hidrokarbureve dhe shpenzimet e braktisjes, të bëra nga Kontraktori sipas Programeve të Punës dhe Buxheteve ose për të zgjidhur Situatat e Emergjencës.

II.15 Kreditimet

Përvec kreditimeve të tjera bërë llogarive në përputhje me Kontratën dhe këtë Procedurë Kontabiliteti, të ardhurat neto, kur merren, që lindin nga sa më poshtë, do t'i kreditohen kostove të mbulueshme në atë masë që kostot i debitoheshin fillimisht kostove të mbulueshme:

II.15.1 Të ardhurat e marra nga palët e treta për përdorimin e pasurive apo aseteve të Kontraktorit të përdorura ekskluzivisht në Operacionet Hidrokarbure; dhe

II.15.2 Qiratë, rimbursimet dhe kreditimet e tjera të marra nga Kontraktori, të aplikueshme ndaj çdo ngarkese që i është bërë kostove të mbulueshme.

II.15.3 Çdo rimbursim i marrë nga Kontraktori për furnizuesit/prodhuesit apo agjentët e tyre në lidhje me paisjet apo materialet difektoze kostua e të cilëve ishte ngarkuar fillimisht nga Kontraktori në llogari sipas Kontratës.

II.15.4 Kostot e mbuluara në kohë të eksportuara në përputhje me Nenin 12.1 të kësaj Kontrate.

II.15.5 Të ardhurat nga gjithë shitjet e materialeve të tepërta të ngarkuara sasisë sipas Kontratës në përputhje me Nenin 12.3.

II.15.6 Të ardhurat nga siguracionet.

II.16 Asnjë dublikim i debitimeve dhe kreditimeve

Pavarësisht nga ndonjë dispozitë në kundërshtim me këtë Procedurë Kontabiliteti, synohet që nuk do të ketë asnjë dublikim të debitimeve apo kreditimeve në llogaritë sipas kësaj Kontrate.

KAPITULLI III. MBULIMI I KOSTOS

III.1 Deklarata e mbulimit të kostos

Kontraktori do t'i japë Albpetrol-it dhe AKBN-së sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur, por jo më vonë se dyzetëepesë (45) Ditë pas çdo Tremujori Kalendarik, një Deklaratë të Mbulimit të Kostos për atë Tremujor.

Në pritje të përfundimit të çdo auditimi dhe çdo zgjidhje apo arbitrazhi në përputhje me Kontratën, Kontraktori do të përgatisë direkt nga çdo Deklaratë e Aktivitetit të Kërkimit dhe Aktivitetit të Zhvillimit, për çdo Tremujor Kalendarik, Deklaratën e Mbulimit të Kostos për atë Tremujor. Gjithë përshtatjet e nevojshme që rrjedhin nga përfundimi i auditimeve dhe zgjidhjeve (me çfarëdolloj mënyre) të përjashtimeve të auditimit do të llogariten siç lindin dhe në përputhje me Kontratën, nëpërmjet përfshirjes së tyre si debi apo kredi (siç është e përshtatshme) në Deklaratën tjetër të Mbulimit të Kostos për tu përgatitur atëherë; megjithatë, asnjë Kosto e Refuzuar nuk mund të përfshihet në një Deklaratë të tillë.

Deklarata e Mbulimit të Kostos do të tregojnë sa më poshtë, duke ju nënshtruar kostove tavan në Nenin 7.2.1

III.1.1 Seksioni 1 - Kostot Totale

III.1.1.1 Kostot totale të mbartura nga Tremujoret Kalendarik të mëparshëm.

III.1.1.2 Rishikime të reja (Kostot e Refuzuara dhe Kostot e Miratuara) të Deklaratave të mëparshme të Aktivitetit të Kërkimit dhe Zhvillimit, që do të hyjnë në fuqi në këtë Deklaratë.

III.1.1.3 Shpenzime të reja Kërkimi dhe Zhvillimi dhe Shpenzime Operative për Tremujorin Kalendarik (që i nënshtrohen auditimit) nga Deklaratat e Aktivitetit të Kërkimit dhe Zhvillimit.

III.1.1.4 Kostot totale, duke përfshirë ato që i nënshtrohen auditimit.

III.1.1.5 Një raport i shpenzimeve dhe faturave sipas Kontratës te analizuara me buxhetin duke treguar:

- Shpenzimet aktuale dhe faturat për Tremujorin Kalendarik në diskutim.
- Shpenzimet aktuale kumulative në atë datë.
- Ndryshimet ndërmjet shpenzimeve të buxhetuara dhe shpenzimeve aktuale, dhe shpjegime të tyre.

III.1.2 Seksioni 2 - Vlera e Hidrokarbureve për Mbulim Kostoje
(duke marrë në konsideratë ndonjë marrje të mëparshme të hidrokarbureve në sasi më të vogla sesa titullimi)

III.1.2.1 Vlera e Naftës Brut për Mbulim Kostoje e marrë në natyrë dhe e disponuar nga Kontraktori për Tremujorin Kalendarik.

III.1.2.2 Vlera e Gazit për Mbulim Kostoje të marrë në natyrë dhe e disponuar nga Kontraktori për Tremujorin Kalendarik.

III.1.2.3 Vlera totale e Hidrokarbureve për Mbulim Kostoje (1.2.1 plus 1.2.2).

III.1.3 Seksioni 3 - Mbulimi i Kostos

III.1.3.1 Kostot nga Seksioni 1 të mbuluara nga Vlera e Hidrokarbureve për Mbulim Kostoje.

III.1.3.2 Mbartja e kostove të pambuluara, nëse ka.

III.1.4 Seksioni 4 - Hidrokarbure Fitim

III.1.4.1 Vlera e Naftës Brut Fitim, nëse ka.

III.1.4.2 Vlera e Gazit Fitim, nëse ka.

III.1.5 Seksioni 5 - Llogaria e Kostove të Pezulluara

III.1.5.1 Kostot Totale të Pezulluara të mbartura nga Tremujoret e mëparshëm Kalendarike.

III.1.5.2 Kostot Neto të Pezulluara të zgjidhura rishtaz, ose të identifikuara rishtas nga auditi, gjatë Tremujorit Kalendarik.

III.1.5.3 Kostot Totale të Pezulluara të mbartura në Tremujorin tjetër kalendarik (1.5.1 plus 1.5.2).

Pagesat

Nëse një Deklaratë e Mbulimit të Kostos tregon një sasi të pagueshme AKBN-së, pagesa e asaj shume do të bëhet në Dollarë brenda tridhjetë (30) Ditësh pas paraqitjes së asaj Deklarate.

E Drejta e Auditimit

etrol-i do të ketë një periudhë prej njëzet e katër (24) muajsh nga marrja e secilës aratë të Mbulimit të Kostos, në të cilën të auditojë dhe të ngrejë kundërshtime për çdo aratë të tillë. Albpetrol-i dhe Kontraktor-i duhet të bien dakord për rregullimet e duhura,

si rezultat i auditimit të tillë. Dokumentet mbështetëse dhe llogaritë do të jenë në dispozicion të Albpetrol-it gjatë periudhës njëzet e katër (24) mujore në fjalë.
Për qëllime të auditimit, Albpetrol-i mund të shqyrtojë dhe verifikojë, në kohë të arsyeshme, të gjitha shpenzimet dhe kreditë në lidhje me aktivitetet e Kontraktor-it sipas Kontratës dhe të gjitha librat e kontabilitetit, hyrjet kontabël, regjistrat e materialeve dhe inventarët, kuponat, borderotë, faturat, deklaratat bankare dhe çdo dokument tjetër, korrespondenca dhe të dhënat e nevojshme për të audituar dhe verifikuar shpenzimet dhe kreditë.

Për më tej, auditorët kanë të drejtë në lidhje me këtë auditim të vizitojnë dhe inspektojnë në kohë të arsyeshme të gjitha vendndodhjet, impiantet, objektet, depot dhe zyrat e Kontraktor-it në shërbim direkt ose indirekt të aktiviteteve të tij sipas Marrëveshjes dhe të të vizitojë dhe të hetojë nga personeli lidhur me ato aktivitete.

Kur Albpetrol-i kërkon verifikimin e shpenzimeve të bëra nga një Kompani e Lidhur ai do të ketë të drejtë të marrë një çertifikatë auditimi nga një firmë e njohur e kontabilistëve publik e pranueshme nga të dy Albpetrol-i dhe Kontraktor-i.

Pa paragjykuar në lidhje me finalizimin e çështjeve siç përshkruhen në këtë Nën-nen III.3, të gjitha dokumentat e referuara në këtë nën-nen, do të mbahen nga Kontraktor-i dhe do të vihen në dispozicion për inspektim nga Albpetrol-i për të paktën pesë (5) vite kalendarike pas datës së tyre të lëshimit.

III.4 Llogaria e Kontrollit të Mbulimit të Kostos

Kontraktori do të mbajë një Llogari të Kontrollit të Mbulimit të Kostos dhe një kundër llogari shlyerje për të kontrolluar në të sasinë e kostos që mbetet për tu mbuluar, nëse ka, sasinë e kostos së mbuluar dhe Vlerën e Hidrokarbureve Fitim, nëse ka. Këto llogari do të përgatiten mbi bazën e (dhe të jenë në konsistencë me) Deklaratat e Mbulimit të Kostos të Tremujorëve Kalendarikë.

III.5 Raporti i Prodhimit

Pas fillimit te prodhimit, Kontraktori brenda tridhjete (30) ditësh pas përfundimit të secilit Tremujor Kalendarik do t'i dorëzojë Albpetrol-it një raport prodhimi ku tregohet sasia e Naftës për Zonën e Zhvillimit dhe Prodhimit, e shprehur ne ton, metër kub dhe fuçi:

III.5.1 mbajtur ne magazinë në fillim të muajit;
III.5.2 prodhuar gjate muajit;
III.5.3 marrë dhe konsumuar në Operacionet Hidrokarbure; dhe
III.5.4 mbajtur ne magazinë në fund te muajit.

KAPITULLI IV. RISHIKIME TE PROCEDURES SE KONTABILITETIT

Dispozitat e kësaj Procedure të Kontabilitetit mund të ndryshohen me marrëveshje unanime me shkrim të Palëve. Çdo Palë mund të kërkojë një rishikim të modifikimeve të mundshme. Nëse arrihet marrëveshje, një instrument amendimi, i cili do të përcaktojë datën e hyrjes ne fuqi të një amendamenti të tillë, do të përgatitet dhe nënshkruhet nga Palët.

ANEKSI D

Proçedura për të përcaktuar vlerësimin e Gazit

1. Gjithë gazi i shitur tek palët e treta përveç Kompanive te Lidhura do të vlerësohet në çmimin e shitjes së kontratës.

2. Gjithë gazi i shitur tek palët e treta që nuk janë Kompani te lidhura do të vlerësohet duke përdorur çmimin e mesatares së ponderuar për njësi të marrë nga Kontraktori nga shitja ndaj palëve të tilla të treta (duke përjashtuar, megjithatë, komisionet dhe ndërmjetësimet e paguara në lidhje me shitjet tek palë të tilla të treta) përgjatë tre (3) muajve përpara shitjes së tillë e rregulluar sipas nevojës për sasinë, specifikimet, transportin dhe përpunimin.

3. Për rastin në të cilin, gjatë një muaji, nuk ka shitje eksporti të gazit (duke përjashtuar lëngjet e gazit natyror dhe Gazit-kondensat të cilat do të vlerësohen në përputhje me paragrafin 5 më poshtë), në bazë të kontratës atëherë aktualisht në fuqi, atëherë çmimi i Gazit (në lidhje me gazin natyror vetëm në fazën e tij të gaztë) do të përdori si një referencë kontratat afat-gjatë të shitjes së gazit me tubacion të kufijve të Greqisë rregulluar sipas nevojës për cilësinë, sasinë specifikimet, transportin dhe shpenzimet e përpunimit.

4. Brenda njëzet (20) ditësh nga fundi i Tremujorit përkatës, Kontraktori duhet të përcaktojë vlerën e Gazit në përputhje me këtë Ankes D. Përveçse kur Albpetroli njofton Kontraktorin brenda njëzet (20) ditëve pas marrjes së njoftimit të tillë se ai dëshiron t'ja paraqesi përcaktimin e vlerës një Eksperti në përputhje me Nenin 21.8 dhe duke specifikuar bazat për mosmarrëveshje në detaje të arsyeshme në një njoftim të tillë, atëhere vlerësimi i gazit nga Kontraktori do të konsiderohet përfundimisht se është pranuar.

5. Në lidhje me një çmim të referencës që do të përdoret aty ku nuk ka shitje të eksportit të gazit natyror, lëngjeve apo Gazit-Kondensat në tre (3) muajt e mëparshëm (sipas rastit), Komiteti Këshillimor do të përcaktojë një çmim referencë të aplikueshëm në tregun shqiptar brenda njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve të Zbulimit Komercial dhe Palët do të ekzekutojnë një adendum të kësaj Kontrate për të marrë parasysh një çmim të tillë reference.

ANEKSI E
Forma e garancisë bankare

[LETRA ME STEMËN E BANKËS]

[SHËNIM: SUBJEKT I SHQYRTIMIT NGA BANKA E KONTRAKTORIT]

Për

Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë së Shqipërisë
Agjensinë Kombëtare të Burimeve Natyrore
Tiranë, Shqipëri

Ne jemi informuar se Pennine Petroleum Corporation ka nënshkruar një Marrëveshje me Ndarje Prodhimi për Bllokun "Velça" në tokë, në Shqipëri, me Albpetrol SH.A. një shoqëri aksionare e organizuar dhe që funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe në pronësi të Qeverisë së Shqipërisë ("Albpetrol") data e hyrjes në fuqi [•][•], 2017 (këtu e më poshtë "**PSA**") dhe kuptojmë se, në përputhje me parashikimet e PSA, kërkohet një Garanci Bankare.

Në vazhdim jemi informuar se, në përputhje me termat e PSA Pennine Petroleum Corporation ka marrë përsipër që gjatë [•] Fazës së (Parë / Dytë / Tretë) të Kërkimit të kryejë një Program Pune në Zonën e Kontratës (të gjitha siç përshkruhen në PSA) dhe në kryerjen e kësaj pune, të shpenzojë një shumë në Dollarë Amerikanë prej [•] mijë Dollarësh (US$).

Me kërkesën e Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore ("AKBN"), ne, [•] Banka, [•] (adresa) garantojmë këtu dhe marrim përsipër t'ju paguajmë çdo shumë ose shuma, që në total nuk kalojnë shumën e Dollarëve Amerikanë [•] (US$) sipas rastit, me marrjen prej nesh të kërkesës tuaj të parë të bërë në përputhje me procedurën e kërkimit të detajuar më poshtë. Kjo garanci do të jetë e lidhur me çdo Fazë Kërkimi përkatëse.

Kërkesa juaj duhet të paraqitet me letër dhe duhet të shoqërohet nga:

- Deklarata juaj ku deklarohet se principali është në mosplotësim të detyrimeve të tij sipas kësaj kontrate dhe se çfarë detyrimi principali nuk ka plotësuar;
- një kopje e njoftimit tuaj për Pennine Petroleum Corporation (me datë të paktën 30 ditë përpara datës së kërkesës suaj), që informon Pennine Petroleum Corporation për mosplotësimin e detyrimeve të Programit të tij të Punës sipas PSA, natyrën dhe masën e mosplotësimit dhe të qëllimit tuaj për të kërkuar pagesën sipas kësaj garancie në qoftë se mosplotësimi nuk riparohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga data e njoftimit tuaj;
- deklaratën tuaj të nënshkruar ku thuhet se Pennine Petroleum Corporation ka dështuar në riparimin e mosplotësimit të përcaktuar në njoftimin tuaj në datën e specifikuar.

Çdo kërkesë për këtë qëllim dhe dokumentet e specifikuara më sipër, duhet të merren nga ne në adresën e mësipërme, në përputhje me procedurën e kërkesës së mësipërme, në ose përpara datës së përfundimit të kësaj garancie sic përshkruhet më poshtë, datë pas së cilës kjo garanci nuk do të ketë më asnjë lloj efekti.

Një kërkesë e paraqitur me faks nuk do të pranohet.

Kjo garanci do të hyjë në fuqi deri në nëntëdhjetë (90) ditë pas Datës së Hyrjes në Fuqi të PSA dhe do të mbesë në fuqi për të paktën tre (3) Muajsh pas:

a) përfundimit të Fazës së [•] të Kërkimit; dhe;

b) datën kur shuma totale e kësaj garancie do të jetë tërhequr ose reduktuar siç përcaktohet në paragrafin tjetër në vazhdim.

Shuma e kësaj garancie do të reduktohet çdo muaj, siç është rënë dakord mes AKBN dhe Pennine Petroleum Corporation, gjatë Fazës së [•] të Kërkimit në një vlerë të barabartë me shumën e shpenzuar nga Pennine Petroleum Corporation si detyrim i Programit të Punës gjatë këtij muaji, reduktime që do të bëhen në përputhje me evidencat e shkruara mujore dërguar nga Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore tek Pennine Petroleum Corporation, një kopje e të cilave do të na dërgohet neve dhe ne do ta pranojmë atë si dëshmi përfundimtare per reduktimin e angazhimit tonë nën këtë garanci.

Kjo garanci është personale për ju dhe nuk është e transferueshme apo e tjetërsueshme (përveçse me miratimin tonë paraprak me shkrim i cili nuk do të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme).

Kjo garanci është subjekt i Rregullave Uniforme për Garancitë e Kërkuara, publikimi i ICC Nr. 758, dhe për sa nuk është në përputhje me këtë, do të udhëhiqet dhe interpretohet në përputhje me Ligjin Anglez, vendi i juridiksionit do të jetë Londër, Angli.

ANEKSI F
Instrumenti i Transferimit

KY INSTRUMENT I TRANSFERIMIT u nënshkrua më _____ ____, 2017

NDËRMJET:

1. **ALBPETROL SH.A. ("Albpetrol"), një kompani aksionare Shqiptare, që ka selinë e saj të regjistruar në Patos, Shqipëri;**

2. **PENNINE PETROLEUM CORPORATION ("Pennine"), një kompani e regjistruar dhe organizuar sipas ligjeve të Provincës së Alberta-s, Kanada.**

3. **AGJENSISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE TË SHQIPËRISË**

NDËRSA:

Albpetrol është një palë në Licensë Marrëveshjen e nënshkruar më _____ ____ 2017 me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, sipas së cilës Albpetrol ka të drejtën ekskluzive për të kryer Operacione Hidrokarbure në Zonën e Liçensës përshkruar në Licensë Marrëveshje;

dhe

Pennine dëshiron t'i bashkohet Albpetrol-it në kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure (siç përcaktohen për këtë), sipas termave dhe kushteve të Marrëveshjes me Ndarje Prodhimi siç përcaktohen në Liçensë Marrëveshje;

dhe

Sipas Marrëveshjes me Ndarje Prodhimi, Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore ("AKBN"), në emër dhe për llogari të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë së Shqipërisë ("ME!" ose "Ministria"), ka disa të drejta miratimi të cilat palët dëshirojnë t'i konfirmojnë.

ATËHERË, për shkak se dhe në dritën e nënshkrimit të Marrëveshjen me Ndarje Prodhimi (siç përcaktohet në Liçensë Marrëveshje) ndërmjet Pennine dhe Albpetrol:

1. **Albpetrol këtu transferon të gjitha të drejtat, privilegjet dhe detyrat që kanë të bëjnë me të drejtën për të kryer Operacionet Hidrokarbure në Zonën e Liçensës të dhëna Albpetrol-it sipas Liçensë Marrëveshjes në fjalë tek Pennine në përputhje me kushtet Marrëveshjes me Ndarje Prodhimi në fjalë.**

2. **Albpetrol dhe Pennine bien dakord përmes kësaj të jenë bashkërisht përgjegjës ndaj Ministrisë në përputhje me Liçensë Marrëveshjen në lidhje me të gjitha detyrat dhe detyrimet e të Liçensuar-it të përcaktuara në mënyrë specifike sipas Liçensë Marrëveshjes.**

3. Me ekzekutimin e këtij Instrumenti të Transferimit konsiderohet se MEI në lidhje me Marrëveshjen me Ndarje Prodhimi ka dhënë miratimin paraprak me shkrim, që Pennine ka paraqitur në AKBN (në emër të MEI) dëshmi të arsyeshme të kompetencës së saj financiare dhe teknike dhe se AKBN (në emër të MEI) nuk do të refuzojë në mënyrë të paarsyeshme dhe të padrejtë miratimin e saj final, dhe MEI pranon se Albpetrol dhe Pennine të dy do të miratojnë çdo amendament të kushteve të Licensë Marrëveshjes apo të Marrëveshjes me Ndarje Prodhimi.

4. Efektiviteti i këtij Instrumenti të Transferimit do të jetë i mundshëm pasi Albpetrol dhe Pennine të nënshkruajnë Marrëveshjen me Ndarje Prodhimi dhe Këshilli i Ministrave të miratojë këtë Marrëveshje me Ndarje Prodhimi. Vendimi i Këshillit të Ministrave nevojitet më tej të publikohet në Fletoren Zyrtare të Shqipërisë.

5. Me ekzekutimin e këtij Instrumenti të Transferimit, Pennine dhe Albpetrol që të dy bien dakort që të drejtat dhe detyrimet e tyre respektive janë ato të përcaktuara sipas Marrëveshjes me Ndarje Prodhimi dhe se AKBN (në emër të MEI) ka të drejtat e miratimit të shprehura aty, dhe MEI ratifikon dhe afirmon Marrëveshjen me Ndarje Prodhimi në fjalë që i nënshtrohet miratimit përfundimtar siç thuhet në pikën 3 më lart.

6. Albpetrol, Pennine dhe AKBN (për llogari të MEI) bien dakort që në rast të një konflikti apo mospërputhje ndërmjet Licensë Marrveshjes dhe Marrëveshjes me Ndarje Prodhimi, kjo e fundit do të mbizotërojë.

7. Klauzola 21 e PSA do të zbatohet mutatis mutandis për mosmarrëveshje që dalin në lidhje me këtë Instrumenti të Transferimit.

NË DËSHMI TË KËTIJ DOKUMENTI, palët ekzekutojnë këtë Instrument të Transferimit në ditën, muajin dhe vitin siç tregohet më lart.

EKZEKUTUAR nga
Si përfaqësues ligjor-me autorizim
Për dhe në emër të
"Albpetrol" sh.a.

EKZEKUTUAR nga
Si përfaqësues ligjor-i autorizuar
Për dhe në emër të
"Pennine Petroleum Corporation"

EKZEKUTUAR nga
Si përfaqësues ligjor-me autorizim
Për dhe në emër të
"Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore"